

Mars 2020
Numri: 144
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Nëse **BESONI**
do të jeni **MË FISNIKËT**




[revistaetika](https://www.facebook.com/revistaetika)



[progresibotime](https://www.instagram.com/progresibotime)

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Mars 2020

VITI: XIV

NUMRI: 144

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Fuqia është kusht jetik për njeriun. Edhe lindja është një fuqi. Allahu Teala me atë fuqi e bën njeriun të fillojë udhëtimin e jetës. Ne nuk kemi asnjë ndikim në atë fuqi. Siç shprehet edhe në suren Insan, na është dhënë mundësia për të lindur si njerëz edhe pse "kemi qenë diçka që nuk ia vlen të përmendet" (Shik. Insan, 1). Pas kësaj njeriu përpiqet të forcohet me elemente të ndryshme.

Të qenët i fuqishëm është një rezultat i natyrshëm i instinktit për mbrojtjen e vetes i cili përbën njërin prej ligjeve të natyrshmërisë që Allahu Teala ia ka vendosur njeriut. Për të qëndruar në jetë duhet të jeni të fuqishëm.

Fuqia në planin personal përbëhet nga fuqia fizike dhe ajo mendore. Njeriu duhet ta zhvillojë edhe trupin, edhe mendjen. Njeriu krahas këtyre përpiqet të prodhojë elemente të cilat e ndihmojnë për t'i shtuar fuqi fuqisë së tij. Kjo fuqi ndihmëse mund të përbëhet nga njerëzit, kafshët, armët, etj.

Te njerëzit ndihmës mund të hyjnë të afërmit, grupet e besimit, organizatat e profesioneve të ndryshme, fisi, populli, umeti si grupi më i madh i besimit dhe aleatët që formohen në çfarëdo lloj mënyre.

Në të gjitha përpjekjet e njeriut për t'u forcuar, fuqia mendore (mendja, zgjuarsia) ka një efekt vendimtar. Njeriu e përdor mendjen edhe për t'i futur njerëzit e tjerë në hallkën e fuqisë, edhe për të prodhuar çfarëdo lloj mjeti për mbrojtjen apo sulmin...

Kur të flasim për fuqinë duhet ta theksojmë edhe këtë se vetë fuqia është relative. Një shprehje e urtë thotë: "Ai që nuk ka parë grushtin e tjetrit, pandeh se grushti i tij është bajloz." Fuqia e vërtetë del në pah kur krahasohet me fuqitë e tjera. Rregulli i jetës është që fuqia e njeriut vazhdimisht duhet të testohet me fuqitë e tjera. Nganjëherë luftohet me një njeri tjetër apo grupe njerëzish. Nganjëherë tjetër luftohet me fenomenet që ndodhin në natyrë... Luftohet me detin, ajrin, ujin, tokën, kafshët... Njeriu vazhdimisht lufton për të qëndruar në jetë. Të njëjtën gjë bëjnë edhe shoqëritë njerëzore...

Ekzistenca e Islamit në këtë botë ndodh kur Islami takohet me njeriun. Një fe që qëndron në qiell, mbetet në qiell. Ndërsa kur feja takohet me njeriun, në këtë botë fillon rrjedha e jetës së saj. Takimi i Islamit me njeriun është takim me fuqinë. Kur Muhamedit (a.s.), i erdhi urdhri: "Lexo!", Islami u takua me njeriun dhe fuqinë. Më vonë çdo njeri me të cilin u takua Islami, u shndërrua në fuqi të Islamit. Ata që u takuan me Islamin i dhanë atij trupin, mendjen dhe çdo gjë tjetër që posedonin. Në këtë mund të përfshihet edhe pasuria materiale. Gjithashtu mund të futen vendet, shtetet dhe ushtritë.

Ne duhet ta nisim rrugën nga e vërteta themelore se njeriu nuk mund të jetojë pa Islamin. Realiteti është se njerëzit po përjetojnë depresione serioze në këtë periudhë. Për këtë arsye, duke e perceptuar të vërtetën se nevoja për Islamin është më emergjente se nevoja për ushqim, duhet ta arrijmë fuqinë që na e mundëson t'i bëjmë këto. Edhe nëse nuk arrijmë dot ta posedojmë këtë fuqi në ditët tona, të paktën të përpiqemi që brezat e ardhshëm të Islamit të pajisen me një personalitet që në të ardhmen do t'ia shfaqin Islamin në formën e tij të pastër të gjithë njerëzimit dhe ta arrijnë këtë fuqi materialo-shpirtërore.

Përmbajtja



8

Problemet në botën Islame
dhe zgjidhjet e tyre
Muhamed Ratib Nabulsi



Dhënia për hir të Allahut
është mbrojtje e pasurisë
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

20



11

34

Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash



5 Fuqia

Ahmet Tashgetiren

11 Përgjegjësia për t'u bërë besimtar i fortë për hir të Zotit (xh.xh.)

Doç. dr. Adem Ergyl

17 Historia e mollës në vazo

Ferudun Ozdemir

18 Besimi në ringjallje

Xhafer Durmush

22 Koha si mirësi

Kazim Kara

24 Edukimi shpirtëror
për zgjidhjen e problemeve

M. Ali Eshmeli

28 Vendosmëria për të përballuar pengesat

Adem Saraç

30 Lufta në rrugën e Allahut

Një Ajet



28

Sëmundja e hipokrizisë 32

Një Hadith

Frika ndaj Allahut 40

Nurten Selma Çevikollu

Dashuria ndaj Profetit (a.s.) 43

Prof. dr. Ali Kose

Zemra mirënjohëse 48

Doç. dr. Mustafa Khanllë

Detyrat tona ndaj Muhamedit (a.s.) 50

Naim Drijaj

Internet i (pa)ndërgjegjshëm 54

Fatma Allada

Cili është prioriteti juaj? 56

Seher Ajdën

46



A pastrohet lagjja pa pastruar shtëpinë?
Sami Byjkkajnak

Për një shoqëri të lumtur
duhet një familje e lumtur
B. Xhahit Ezedmir

52



ALLAHU TEALA THOTË:
“PËRGATITNI FUQI!”
ATËHERË NE JEMI TË
DETYRUAR TA GJEJMË
FUQINË KUDO QË TË
NDODHET AJO. VEPRIMI
MË PARËSOR PËR TA
ARRITUR KËTË ËSHTË
QË TA SHIKOJMË VETEN
SI NJERËZ TË CILËVE U
DREJTOHET URDHRI I
ZOTIT (XH.XH.). KJO E
BËN TË NEVOJSHME QË
TA SHOHIM SI ÇËSHTJE
PRIMARE “CILËSINË E
NJERIUT”. EDHE CILËSINË
MENDORE, EDHE CILËSINË
E TË VEPRUARIT...

FUQIA

— Ahmet Tashgetiren —

“Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t’ju shpërblehet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.” (Enfal, 60)

Fuqia është kusht jetik për njeriun. Edhe lindja është një fuqi. Allahu Teala me atë fuqi e bën njeriun të fillojë udhëtimin e jetës. Ne nuk kemi asnjë ndikim në atë fuqi. Siç shprehet edhe në suren Insan, na është dhënë mundësia për të lindur si njerëz edhe pse “kemi qenë diçka që nuk ia vlen të përmendet” (Shik. Insan, 1). Pas kësaj njeriu përpiket të forcohet me elemente të ndryshme.

Të qenët i fuqishëm është një rezultat i natyrshëm i instinktit për mbrojtjen e vetes i cili përbën njërin prej ligjeve të natyrshmërisë që Allahu Teala ia ka vendosur njeriut. Për të qëndruar në jetë duhet të jeni të fuqishëm.

Fuqia në planin personal përbëhet nga fuqia fizike dhe ajo mendore. Njeriu duhet ta zhvillojë edhe trupin, edhe mendjen. Njeriu krahas këtyre përpiket të prodhojë elemente të cilat e ndihmojnë për t’i shtuar fuqi fuqisë së tij. Kjo fuqi ndihmëse mund të përbëhet nga njerëzit, kafshët, armët, etj.

Te njerëzit ndihmës mund të hyjnë të afërmit, grupet e besimit, organizatat e profesioneve të ndryshme, fisi, populli, umeti si grupi më i madh i besimit dhe aleatët që formohen në çfarëdo lloj mënyre.

Në të gjitha përpjekjet e njeriut për t’u forcuar, fuqia mendore (mendja, zgjuarsia) ka një efekt vendimtar. Njeriu e përdor mendjen edhe për t’i futur njerëzit e tjerë në hallkën e fuqisë, edhe për të prodhuar çfarëdo lloj mjeti për mbrojtjen apo sulmin...


Ngritja e kurthit është punë e mendjes. Edhe bërja e shigjetës po ashtu... Të shumuarit e miqve është

punë e mendjes. Edhe pakësimi i armiqve po ashtu është punë e saj. Edhe të prodhuarit e fuqisë nukleare është punë e mendjes...

Kur të flasim për fuqinë duhet ta theksojmë edhe këtë se vetë fuqia është relative. Një shprehje e urtë thotë: “Ai që nuk ka parë grushtin e tjetrit, pandeh se grushti i tij është bajloz.” Fuqia e vërtetë del në pah kur krahasohet me fuqitë e tjera. Rregulli i jetës është që fuqia e njeriut vazhdimisht duhet të testohet me fuqitë e tjera. Nganjëherë luftohet me një njeri tjetër apo grupe njerëzish. Nganjëherë tjetër luftohet me fenomenet që ndodhin në natyrë... Luftohet me detin, ajrin, ujin, tokën, kafshët... Njeriu vazhdimisht lufton për të qëndruar në jetë. Të njëjtën gjë bëjnë edhe shoqëritë njerëzore...

Umeti islam dhe fuqia

Ekzistenca e Islamit në këtë botë ndodh kur Islami takohet me njeriun. Një fe që qëndron në qiell, mbetet në qiell. Ndërsa kur feja takohet me njeriun, në



NE DUHET TA NISIM RRUGËN NGA E VËRTETA THEMELORE SE NJERIU NUK MUND TË JETOJË PA ISLAMIN. REALITETI ËSHTË SE NJERËZIT PO PËRJETOJNË DEPRESIONE SERIOZE NË KËTË PERIUdhË. PËR KËTË ARSYE, DUKE E PERCEPTUAR TË VËRTETËN SE NEVOJA PËR ISLAMIN ËSHTË MË EMERGJENTE SE NEVOJA PËR USHQIM, DUHET TA ARRIJMË FUQINË QË NA E MUNDËSON T'I BËJMË KËTO.

këtë botë fillon rrjedha e jetës së saj. Takimi i Islamit me njeriun është takim me fuqinë. Kur Muhamedit (a.s.), i erdhi urdhri: “Lexo!”, Islami u takua me njeriun dhe fuqinë. Më vonë çdo njeri me të cilin u takua Islami, u shndërrua në fuqi të Islamit. Ata që u takuan me Islamin i dhanë atij trupin, mendjen dhe çdo gjë tjetër që posedonin. Në këtë mund të përfshihet edhe pasuria materiale. Gjithashtu mund të futen vendet, shtetet dhe ushtritë.

Thuhet se sot Islami posedon rreth 1 miliard e 700 milion njerëz. Këta njerëz kanë vendin, shtetin, pasurinë materiale, fuqinë e armëve... Normalisht se kur këta njerëz të krahasohen me shtatë miliard njerëz të të gjithë botës, mund të konsiderohen si një “Fuqi” e rëndësishme ngaqë përbëjnë afërsisht një të katërtën e njerëzimit. Por e vërteta që dimë është kjo: Nëse këta njerëz i mendojmë si tërësi të “umetit Islam” dhe nëse i krahasojmë me fuqitë e tjera duke marrë parasysh domosdoshmërinë e kryerjes së misionit universal të Islamit, atëherë

mund të shprehemi se këta njerëz (myslimanët) nuk e mbartin cilësinë e duhur dhe të kërkuar prej tyre. Madje të gjithë janë të detyruar ta pranojnë se “dobësia” është një gjendje e përgjithshme e tyre. Kudo që sot ka një plagë e cila pikon gjak, patjetër ka të bëjë me ekzistencën e Islamit. Këtu mund të përfshijmë vendet, faktorin njeri (mysliman), etj. Mbi të gjitha, kjo gjendje është e tillë që prej 100 vjetësh.

Para 100 vjetësh shtetet u humbën, të gjitha pasuritë mbi dhe nëntokësore u plaçkitën, sistemet ndryshuan dhe kuadrot udhëheqës u formuan me faktorë të huaj për vendet e tyre. Sot pas 100 vjetësh:

-Bota islame përsëri është një botë e madhe.

-Në botën islame gjenden 1 miliard e 700 milion myslimanë, por ja që shtetet në këto vende nuk janë të themeluara mbi parimet e Islamit. Krahas kësaj, shtetet islame nuk shfaqin një “tërësi islame” në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Që në fillim marrëdhëniet me njëri-tjetrin janë kontradiktore. Aty po përdoren fuqi që e dobësojnë fuqinë e përbashkët të Islamit duke bashkëpunuar me të huajt.

-Kapitali njeri i vendeve që ne i quajmë bota islame është problematik. Është problematik nga tri aspekte:

Një: Ai nuk ka dhënë përpjekje të mjaftueshme si kapacitet mendor. “Fusha e edukimit” e cila mund ta pajisë mjaftueshëm kapitalin njeri në aspektin mental, po përjeton probleme serioze qoftë edhe në vendin më të zhvilluar Islam. “Mungesa e dijes” është dobësia më e madhe e kapitalit njeri. Kjo e vërtetë e shndërron në “konsumatore” një masë të madhe të botës islame. Për këtë arsye, paratë e miliardave shkojnë për fushën e informacionit/teknologjisë.

Dy: Marrëdhënia prodhues-konsumator në këtë pikë, në të njëjtën kohë shndërrohet edhe në një bartëse kulture. Për shkak të kësaj, faktori njeri i Islamit me kalimin e kohës ndryshon me kulturën që i është instaluar informacionit/teknologjisë. Të qenët pala pasive në këtë çështje shkakton përgatitjen e terrenit për shkatërrimin e madh të masës njerëzore të Islamit.

Tre: Personalitetet në marrëdhënien Islam-mysliman janë kontradiktore me një ndryshim serioz perceptimi qoftë për shkak të pasivitetit që e përmendëm më sipër, qoftë për shkak të përçarjeve që po përjetohen në atmosferën socio-ekonomiko-politike. Nëse u hedhim një sy hulumtimeve që janë bërë, vendet e Islamit gjenden edhe nën vendet joislame për sa i përket çështjes së virtyteve që Islami dëshiron t'i mbartë në jetën e individit-shoqërisë. Atributet që feja jonë i cilëson si “virtyte” gjenden

më shumë në shoqëritë jomyslimane. Në të vërtetë, kjo është njëra prej çështjeve më dramatike të njerëzimit.

Qoftë largësia që është formuar ndërmjet nesh dhe Islamit, qoftë dobësia e akumulimit mental në fushën e shkencave ekzakte, po e zvarrit seriozisht në plan të pasmë botën islame për sa i përket “Fuqisë”.

-Marrëdhëniet shtet-shoqëri dhe sistem-shoqëri në vendet islame mbartin një cilësi që nuk e rrit fuqinë e shoqërive myslimane, por përkundrazi e pakëson. Qofshin sistemet apo qoftë kuadri udhëheqës në shumë vende myslimane janë caktuar nga fuqitë sunduese që para 100 vjetësh. Kjo situatë i fut popujt, shtetet dhe sistemet në marrëdhënien sundues – i sunduar. Për këtë arsye, popujt detyrohen të luftojnë për të shpëtuar nga sistemet që në një farë mënyre janë shfrytëzuese dhe shtypëse. Gjithashtu detyrohen të luftojnë, në mënyrë që të shpëtojnë nga presionet shtetërore. Ja pra, kjo ndodh edhe pse shteti është fuqia vetëmbrojtëse e një populli. Si rrjedhojë, sa më e shëndetshme të jetë marrëdhënia shtet-popull, aq më shumë akumulohet fuqi.

Fuqia ekonomike dhe ushtarake e botës islame, lëre që nuk është një fuqi e “unitetit të umetit”, por është edhe e përçarë. Madje, gjendja shkon më keq se kaq. Kjo fuqi nganjëherë përplasat me veten. Disa prej myslimanëve bëjnë aleancë me fuqi të tjera dhe luftojnë me disa myslimanë të tjerë. Në këtë mënyrë e dobësojnë, e shembin dhe e shkatërronjë njëri-tjetrin. Këtu është e pamundur të thuhet se marrëdhënien e vendeve islame e caktojnë parimet e Islamit. Ose mund të themi kështu: Në vendet tona funksionon një logjikë makiaveliste me të cilën kushdo mund të formojë “parime islame” sipas dëshirës.

Të gjitha këto janë qëndrime që e pakësojnë fuqinë e Islamit, që e çojnë dëm dhe që i bëjnë myslimanët ta përdorin këtë fuqi kundrejt njëri-tjetrit.

-Fusha e medias dhe komunikimit është një fushë në të cilën bota islame ka një dobësi shumë më të madhe. Të mos harrojmë se kjo fushë në ditët e sotme është ndikuese pothuajse sa forcat e armatosura.

Të gjitha këto i thamë për të kërkuar përgjigje për këtë pyetje jetike:

Si do të shpëtojë nga dobësia dhe si do ta arrijë fuqinë bota islame? Si mund të bëhet “besimtari i fuqishëm”, në mënyrë që nga ai të lindë “umeti i fuqishëm”. Apo thënë ndryshe: “Si mund të ngrihet umeti në këmbë?”

Para se t’i rregullojmë gjendjet që i shqyrtoam më sipër si fusha të dobësisë, është e pamundur të

bëhemi të fuqishëm. Allahu Teala thotë: “Përgatitni fuqi!” Atëherë ne jemi të detyruar ta gjejmë fuqinë kudo që të ndodhet ajo. Veprimi më parësor për ta arritur këtë është që ta shikojmë veten si njerëz të cilëve u drejtohet urdhri i Zotit (xh.xh.). Kjo e bën të nevojshme që ta shohim si çështje primare “cilësinë e njeriut”. Edhe cilësinë mendore, edhe cilësinë e të vepruarit...

Ne duhet të bëhemi besimtarë që i përvetësojnë të gjitha të dhënat në lidhje me jetën, që përpiqen për t’i marrë ato, që përpiqen t’i zbulojnë dhe që i mbartim në personalitetin tonë virtytet e Islamit. Ne jemi të detyruar të bëhemi të fuqishëm.

Iniciativën njerëzore që e përdor fuqinë me drejtësi jemi të detyruar ta formojmë si iniciativë të Islamit. Ne jemi të detyruar ta kalojmë dobësinë dhe të bëhemi shpresë për njerëzimin e shtypur. Ne jemi të detyruar që botën islame ta bëjmë prijëse në informacione dhe virtyte.

Ne duhet ta nisim rrugën nga e vërteta themelore se njeriu nuk mund të jetojë pa Islamin. Realiteti është se njerëzit po përjetojnë depresione serioze në këtë periudhë. Për këtë arsye, duke e perceptuar të vërtetën se nevoja për Islamin është më emergjente se nevoja për ushqim, duhet ta arrijmë fuqinë që na e mundëson t’i bëjmë këto. Edhe nëse nuk arrijmë dot ta posedojmë këtë fuqi në ditët tona, të paktën të përpiqemi që brezat e ardhshëm të Islamit të pajisen me një personalitet që në të ardhmen do t’ia shfaqin Islamin në formën e tij të pastër të gjithë njerëzimit dhe ta arrijnë këtë fuqi materialo-shpirtërore.

Në këtë formë do të ndërtojmë njerëz-shtete të cilët kanë në bazën e tyre virtytet e Islamit. Do të themelojmë shtete të shëndosha. Sisteme të shëndosha. Fuqi ekonomike që e nxjerrin njeriun në plan të parë. Një fuqi ushtarake e cila synon zhdukjen e padrejtësisë në sipërfaqen e tokës. Një institucion të mediave që e konsideron si mision parimor takimin e Islamit me njeriun dhe njerëzimin.

Nëse Islami është kusht jetik, atëherë këtë së pari duhet ta perceptojnë besimtarët. Përgjigjen për pyetjen: “Si do të realizohet/përgatitet kjo fuqi?”, njeriu mund ta japë duke e nxjerrë veten në pah dhe duke thënë: “Unë ekzistoj.” Besimtarët nuk duhet ta harrojnë këtë.

Fjalën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili shprehet: “*Besimtari i fuqishëm është më i mirë se besimtari i dobët.*”, nuk duhet ta konceptojmë si një krahasim që e nënçmon besimtarin e dobët ndërmjet besimtarëve të tjerë. Andaj nuk duhet ta harrojmë se kjo fjalë është thënë për ta inkurajuar çdo besimtar për t’u bërë i fuqishëm. Si rrjedhojë secili prej nesh duhet të përpiqet të prodhojë fuqi sipas kapacitetit që posedon.



Problemet në botën islame dhe zgjidhjet e tyre

— Muhamed Ratip Nabulsi —

Për fat të keq, ne si bota islame vazhdimisht flasim për problemet, gabimet dhe dobësitë tona. Realiteti është ky se, si myslimanë jemi shumë larg atyre ditëve të ndritura të së kaluarës sonë. Për fat të keq, në çdo vend ku gjenden myslimanët ka një problem. Qofshin në perëndim apo qofshin në lindje, myslimanët prapë se prapë kanë probleme të ngjashme. Madje myslimanët i marrin me vete problemet edhe kur shkojnë në vende të tjera larg vendeve të tyre. Ne i mbartim me vete edhe në vendet ku emigrojmë sëmundjet tona si hasmëritë, nacionalizmin etnik, akuzat e ndërsjella dhe fajësimet që arrijnë deri në nxjerrje nga feja.

Myslimanët sot jetojnë si perëndimorë të veshur me petkun lindor. Ata janë nga lindja, por ja që sillen sikur të jenë perëndimorë. Njerëz që u është veshur këllëf Islam, por që përvetësojnë vlerat perëndimore. Ata imitojnë traditat, zakonet dhe vlerat perëndimore. Struktura jonë e të menduarit nuk është e bazuar në tevhid. Ne e kemi humbur ndjeshmërinë e ahiretit në sjelljet dhe veprimet tona. Si rrjedhojë i japim përparësi kësaj bote. Pra, veprojmë sipas rregullave të njerëzve të pasionuar pas kësaj bote.

Me të drejtë, kjo gjendje në të cilën është bota islame mund të diskutohet.

Përse sot jemi shumë larg atyre ditëve të ndritura? Përse ata që shtypen gjithmonë janë vetëm

myslimanët? Përse nuk realizohet në asnjë lloj mënyre fitorja që u është premtuar besimtarëve? Ku po gabojmë? Çfarë duhet të bëjmë për ta rregulluar atë gabim? Mos vallë problemi gjendet në diagnostikimin apo mjekimin e sëmundjes sonë? Mos vallë problemi ndodhet te ilaçi që nuk gjendet për sëmundjen tonë? Mos vallë problemi gjendet te i sëmuri i cili insiston për të mos e përdorur ilaçin në formën e këshilluar?

* * *

Tani desha të ndaj disa të vërteta në lidhje me faktin që jemi në këtë gjendje.

-Së pari e kemi lënë urdhërimin në të mirë dhe largimin nga e keqja.

-Adhurimet tona i bëjmë formalisht. Allahu Teala thotë: **“Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epsheet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh.”** (Merjem, 59)

Komentuesit e Kuranit Fisnik shprehjen: “Pas atyre erdhën brezni që e braktisën faljen e namazit”, e kanë komentuar si falje të namazit në mënyrë formale. Domethënë se jo çdo falës i namazit fal namaz. Ka namaze që falen formalisht.

-Zemrat tona janë mbushura me urrejtje. Allahu Teala thotë: **“Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët.”** (Shuara, 88)



Një zemër e shëndoshë dhe e pastër nuk kërkon diçka me të cilën Allahu nuk është i kënaqur. Ajo nuk njeh asnjë dispozitë përveç dispozitave të Atij. Ajo nuk adhuron askënd përveç Atij. Gjithashtu nuk aprovon asnjë lajm në kundërshtim me revelatën e Atij.

-Për shkak të shkujdesjes jemi kapluar nga pandehja se jemi afër me Allahun Teala. Çifutët dhe të krishterët thanë: “Ne jemi bijtë dhe të dashurit e Allahut.” Allahu i Madhëruar u tha atyre: “Atëherë, përse ju ndëshkon si rrjedhojë e mëkateve tuaja?” Edhe myslimanët thonë: “Ne jemi umeti i Muhamedit. Ne jemi umeti i mëshiruar. Jemi umeti i revelatës hyjnore. Jemi umeti i Kuranit...” Allahu (xh. sh.), u thotë këtyre myslimanëve të shkujdesur:

“Atëherë, përse ju ndëshkon si rrjedhojë e mëkateve tuaja? Jo, ju jeni vetëm prej njerëzve që Ai ka krijuar.”

Shkurtimisht mund të themi se cilësitë që janë bërë shkak për shkatërrimin e popujve të mëparshëm për fat të keq gjenden edhe në umetin tonë. Por ja që ne nuk jemi të vetëdijshëm për këtë.

-Në botën islame padrejtësia është në maksimum dhe drejtësia nuk vendoset.

-Ne nuk e kryejmë detyrën për ta ftuar në Islam të gjithë njerëzimin. Zoti (xh.sh.), thotë në Kuranin Fisnik: **“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...”** (Bakara, 143)

A përpiqemi që t’ua predikojmë këtë fe popujve të tjerë? A dëshirojmë që kjo fe të përhapet në të gjithë botën?

-I thellojmë përçarjet dhe kontradiktat që kemi ndërmjet nesh. Allahu Teala thotë: **“Vërtet, ky është besimi juaj - besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni Mua!”** (Enbija, 92)

A mund t’i lëmë mënjanë kontradiktat dhe t’i bashkojmë rreshtat ne si umet? A i japim përparësi interesit të umetit ndaj interesit tonë? Mos vallë bëjmë llogarinë e interesave tonë të vogla edhe nëse kjo shkakton përçarjen e rreshtave të umetit?

-Fenë e kemi lënë jashtë funksioni për sa i përket zgjidhjes së problemeve tona. Allahu i Lartësuar thotë: **“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit** (ndaj Allahut).” (Hashr, 19)

Ne e harrojmë apo bëjnë sikur e harrojmë se ka një metodë hyjnore në zgjidhjen e një çështjeje e cilitdo nivel që të jetë ajo kur përpiqemi ta zgjidhim një problem.

Në shumë vende arabe kam marrë pjesë në mbledhje të panumërta që kishin të bënin me problemet familjare. Kam dëgjuar me dhjetëra predikime. Ju betohem se në shumicën e atyre predikimeve nuk kam dëgjuar fjalët “Allah, Islam dhe Kuran”. Pra, ne përpiqemi t’i zgjidhim problemet në mënyrë të shkujdesur nga revelata hyjnore dhe nga metoda e Allahut (xh.sh.).

-Kohën e harxhojmë pa kriter.

Ne nuk ia dimë vlerën kohës. Gjëja më e lirë e jetës sonë është koha. Ne flemë nën diell. Ndërsa armiqët tanë punojnë edhe natën. Ata nuk kanë revelatë hyjnore. Ndërsa ne kemi Kuranin Fisnik i cili na e ndriçon rrugën si diell. Por ja që vazhdimisht vetëm flemë. Ndërsa armiqët tanë që janë të privuar nga revelata hyjnore, punojnë natë e ditë.

Allahu Teala na urdhëron që të përgatitemi kundrejt armiqve me aq sa të kemi mundësi. Ata bëjnë përgatitje kundrejt nesh. Ndërsa ne nuk kemi asnjë përgatitje kundrejt atyre. Që prej njëqind vjetësh ata punojnë natë e ditë dhe kanë arritur fuqi të madhe. Me fuqinë që kanë arritur na imponojnë kulturat e tyre. Gjithashtu përpiqen ta manipulojnë edhe

fenë. Sa më shumë që largohemi prej Kuranit, aq më shumë dobësohemi. Ne jemi dobësuar aq shumë sa që ata kanë guxim të na ofendojnë edhe gjërat tona të shenjta. Të gjitha këto po ndodhin për shkak të dobësisë sonë.

Njeriu është pasuria më e madhe e kësaj toke. Njeriu është baza e çdo gjëje. Në synimin e të gjitha sistemeve gjendet njeriu. Ndërsa në botën islame njeriu është bërë kurban. Kur njeriu të dobësohet dhe të mos ketë vlerë, dobësohet dhe nuk ka vlerë e gjithë shoqëria. Kur forcohet njeriu, forcohet dhe fiton vlerë e gjithë shoqëria.

-Preferojmë imitimim, jo shpikjen.

Ne si myslimanë nuk përpiqemi, por imitojmë. Transportojmë, por nuk prodhojmë vetë. Mësojmë përmendësh, por nuk mendojmë. Mendimet e të tjerëve i përdorim në zgjidhjen e problemeve tona. Përfundimi natyrisht se është tragjik.

Ajeti i parë që ka zbritur është: “Lexo!” Kështu që leximi ynë duhet të jetë i mbështetur te besimi. Pra, leximi ynë duhet të ketë si synim arritjen e të vërtetës së besimit.

-Flasim shumë dhe punojmë pak.

Shumë njerëz e shohin botës islame me syrin: “Njerëz që flasin shumë dhe që punojnë pak.” Me të vërtetë, në shumicën e rasteve merremi me punë të padobishme. Bota po i kthen shkretëtirat në vende të gjelbëruara, ndërsa ne bëjmë të kundërtën. Pra, mjedisin tonë po e shndërrojmë në shkretëtirë. Kopshet po i betonizojmë dhe klimën po e prishim.

-Nuk kapemi pas shkaqeve, por fajësojmë kaderin.

Gabimet tona i lidhim me kaderin. Nxënësit tonë nuk studiojnë. Si rezultat, nuk arrijnë suksese në provime. Pastaj themi: “Allahu më mjafton. Sa mbrojtës i mirë që është Ai.” Kjo është një gjendje jashtëzakonisht komike. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë për ata që i përdorin vend e pavend vlerat fetare si kjo:

“Allahu Teala e dënon dobësinë. Ndërkohë ty të takon që të veprosh me mençuri. Nëse ndonjë gjë të mposht, atëherë thuaj: Hasbijall-llahu ve ni’ mel-vekil / Allahu më mjafton. Sa mbrojtës i mirë që është Ai.”

-Myslimanët duhet t’i kthehen metodës së Kuranit

Allahu (xh.sh.), thotë: **“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porositi Ai për t’u ruajtur nga të këqijat.”** (En’am, 153)

Në të kaluar ne si umet jemi unifikuar në të vërtetën dhe kemi qenë të bashkuar. Nëse mund ta shpreh me përngjasim, ne si myslimanë gjendemi

në një rreth në mes të së cilit ndodhet e vërteta. Sa më shumë që myslimani t’i afrohet asaj pikës së vërtetë që gjendet në qendër të rrethit, aq më shumë i shkurtohet largësia më vëllain tjetër besimtar. Kur të takohemi në qendër të rrethit, zbret në zero largësia ndërmjet vëllezërve besimtarë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), pothuajse e përshkruan gjendjen e sotme të myslimanëve. Theubani (r.a.), transmeton se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Së afërmi popujt do ta ftojnë njëri-tjetrin (për të luftuar) kundër jush siç i ftojnë ngrënësit e ushqimit (të tjerët) te çanakët (sofrat) e tyre.”* Dikush tha: “A do të ndodhë kjo për shkak se atë ditë do të jemi të pakët?” I Dërguari i Allahut (a.s.), tha: *“Jo, përkundrazi atë ditë do të jeni të shumtë (në numër), por do të jeni të dobët si mbeturinat para rrëkesë. Allahu do ta marrë nga zemrat e armiqve ndjenjën e frikës kundrejt jush. Ndërsa në zemrën tuaj do të hedhë vehnin.”* Një burrë tjetër pyeti: “Çfarë është vehni, o i Dërguari i Allahut?” Resulullahu (a.s.), tha: *“Vehn do të thotë dashuri (e tepërt) ndaj kësaj bote dhe konsiderimi i vdekjes si e keqe.”*

* * *

Si përfundim vëllezër myslimanë, të gjithë ata që mendojnë se duhet të rregullohet gjendja e umeetit, para së gjithash duhet t’ia fillojnë punën nga vetja. Ne duhet ta marrim veten në llogari para se të merremi në llogari nga Allahu (xh.xh.). Veprat duhet t’i peshojmë para se të na peshohen në jetën e përtejme. Cila është mangësia jonë në njohjen e vërtetë të Allahut Teala? Cilat janë mangësitë tona në sjellje dhe vepra? Së pari duhet t’i zbulojmë këto dhe pastaj duhet t’i përvishemi punës për t’i rregulluar. Njeriu që është i mençur së pari merr në llogari veten e vet. Njeriu që është i mençur është ai njeri që punon për pas vdekjes. Ndërsa njeriu i dobët është ai që ndjek dëshirat vetjake...

Në këtë pikë le ta theksojmë edhe këtë: Myslimani duhet të bëjë kujdes në marrëdhënien e tij me katër gjëra. Ai duhet të bëjë kujdes në marrëdhënien me Zotin (xh.xh.), në marrëdhënie me punën, në marrëdhënie me familjen dhe në marrëdhënie me shëndetin... Marrëdhënien që ka me Allahun Teala mund ta rregullojë me bindje ndaj Tij. Detyrat që ka kundrejt të tjerëve duhet t’i kryejë. Duhet të rregullojë marrëdhënien me familjen dhe duhet të bëjë kujdes ndaj shëndetit.

Përfundimisht, nëse jemi seriozë në çështjen për të ndihmuar në rregullimin e gjendjes së umeetit, para së gjithash duhet të rregullojmë marrëdhëniet me myslimanët e tjerë.

Përgjegjësia për t'u bërë besimtar i fortë

— PËR HIR TË ZOTIT (XH.XH.) —

— Doç. dr. Adem Ergyl —

Allahu Teala ka dashur që robërit e Tij të devotshëm të bëhen trashëgimtarë të kësaj bote. Gjithashtu ka dashur që ata ta mbajnë këtë amanet dhe të mos lejojnë që aty (në tokë) të ndodhin padrejtësi, shkatërrime dhe përçarje. Zoti (xh.sh.), na e ka tërhequr vëmendjen që e vërteta e drejtësia gjithmonë të mbahen lart dhe që udhëheqja të mos i mbesë shejtanit e ndihmësve të tij. Krijuesi i gjithësisë i ka përgëzuar besimtarët me të vërtetën se asnjë fuqi nuk mund t'i mposhtë asnjëherë, edhe pse mund të jenë të pakët në numër, nëse posedojnë një besim të fortë dhe i kryejnë përgjegjësitë që ua ngarkon ky besim.

Besimi aq sa është një mirësi sublime, në të njëjtën kohë është edhe një përgjegjësi e madhe. Ata që kanë besuar nuk do të lihen vetëm të thonë se kanë besuar, por absolutisht do t'u bëhet testi i besnikërisë.¹ Kjo gjendje është një ligj i pandryshueshëm i Allahut (xh.xh.).

Kjo botë është bota e shkaqeve. Zoti (xh.sh.), siç ka ajete që lexohen, për shembull ajetet e Kuranit Fisnik, ka edhe ajete që i ka vendosur në

gjithësi dhe në ngjarje. Ata që nuk i marrin në konsideratë këto ajete apo që bëjnë sikur nuk i shohin, sigurisht që do ta marrin herët apo vonë atë që kanë merituar për këtë neglizhencë. Ja pra, edhe një prej ajeteve që është vendosur në këtë botë është domosdoshmëria që besimtarët të bëhen të fortë dhe të fuqishëm, në mënyrë që t'i mposhtin armiqtë e Zotit dhe të së vërtetës. Çështja nuk është që të kenë pak apo shumë fuqi, por e rëndësishme është që besimtarët t'i përveshin krahët dhe të përpiqen në këtë rrugë në raport me mundësinë që kanë. Kjo përpjekje mbart cilësinë e një çelësi i cili bëhet shkak për ardhjen e ndihmës hyjnore dhe korrjen e fitores. Besimtarët e mbledhin fuqinë si domosdoshmëri e detyrës së tyre. Ata asnjëherë nuk ia atribuojnë fitoren vetes së tyre, por ia atribuojnë vetëm Allahut Teala. Ata i besojnë Atij dhe mbështeten vetëm te Ai. Zoti i Madhëruar thotë:

“Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh.





Cfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t'ju shpërblehet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi.” (Enfal, 60)

Atëherë ne si besimtarë kemi përgjegjësinë për të mbledhur fuqi dhe për t'u bërë të fortë. Ata që e zbatojnë dhe që nuk e zbatojnë këtë urdhër, nuk do të jenë të barabartë të Allahu i Lartësuar. Këto fjalë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), janë si një udhërrëfyes jete nga aspekti i rëndësisë së të qenët besimtarë të fuqishëm dhe nga aspekti për të treguar mënyrën e arritjes së kësaj grade:

“Besimtari i fuqishëm është edhe më i mirë edhe më i dashur te Allahu se besimtari i dobët. (Krahas kësaj) te të dy ka mirësi. Ti përpiku me të gjithë fuqinë për ta fituar atë gjë që të bën dobi dhe ji ambicioz në këtë çështje. Kërko ndihmë nga Allahu dhe asnjëherë mos shfaq dobësi. Nëse të ndodh ndonjë gjë, mos u anko duke thënë: “Po të kisha vepruar kështu, do të ndodhë kështu.” Por thuaj: “Ky është caktimi i Allahut. Ai bën çfarë të dëshirojë.” Sepse fjala “sikur të kisha vepruar kështu”, hap derën e punëve që e kënaqin shejtanin.” (Muslim, Kader, 34.)

I Dërguari i fundit i Zotit, Pejgamberi (a.s.), me këto fjalë i ka dhënë detyrën çdo individit të umetit që të bëhet besimtar i fortë. Pra, Pejgamberi (a.s.), me këto fjalë pothuajse u ka dhënë atyre një mision personal. Kjo, sepse një umet i fortë formohet nga bashkimi i individëve të fortë. Shpjeguesit e hadithit thonë se fuqia për të cilën flitet këtu së pari është fuqia e besimit. Sigurisht që kjo është e vërtetë, sepse fuqia e besimit është edhe mbledhëse e fuqive të tjera, edhe orientuese e saktë e tyre. Nëse fuqia merret për hir të Allahut, atëherë ajo është dobishme. Në të kundërt, ajo shndërrohet në një mjet që bëhet shkak për devijim, tërbim dhe padrejtësi. Përdorimi i fuqisë për hir të Allahut Teala kërkon një besim serioz dhe edukim të mirëfilltë Islam.

Arritja e fuqisë në besim mund të sigurohet me këto dy gjëra siç shprehet Kurani Fisnik. E para: Leximi i ajeteve të Allahut në Kuran e në gjithësi dhe zbatimi i tyre.² E dyta: Zbritja në zemër e prehjes hyjnore e cila i largon vesveset dhe dyshimet.³ Kjo prehje shpirtërore, siç deklaroi i Dërguari i Allahut (a.s.), zbret në kuvendet dhe shoqëritë ku përmendet Allahu dhe diskutohet rreth ajeteve hyjnore.⁴ Sigurisht se këtu mund të përmendim edhe shkaqe të tjera që e shtojnë dhe e forcojnë besimin. Për shembull, edhe veprat si sakrificat për besimin, xhahadi në rrugë të Allahut me pasurinë dhe jetën, të qëndruarit së bashku me besimtarët që kanë besim të fortë, etj. mund të konsiderohen prej gjërave që e përforcojnë besimin.

Besimtarët duhet të pajisen edhe me gjëra të tjera që i bëjnë ata akoma edhe më të fortë. Për shembull, dija është fuqi.

Ai që posedon dije shpesh herë është një hap më para. Pajisja e Ademit (a.s.), me një dije tjetër është treguar si arsye që engjëjt i bënë sexhde atij. Edhe në ditët e sotme dihet se popujt e fuqishëm janë ata popuj që kanë përparuar në dije. Individët dhe shtetet që e lexojnë në mënyrë të mirëfilltë librin e gjithësisë, përgjatë gjithë historisë janë bërë sunduesit e të tjerëve.

Pasuria është një mundësi që e shton fuqinë. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, ka thënë: *“Sa gjë e bukur që është pasuria për një burrë të devotshëm!”*⁵ Në këtë mënyrë ai i ka inkurajuar besimtarët që gjithmonë të bëhen dora që jep. Kjo, sepse njëra prej bazave absolute të udhëheqjes është të qenët i fuqishëm në aspektin ekonomik. Fakti që i pasuri i cili jep për hir të Allahut Teala tregohet si njëri prej dy personave që mund t'i kihet lakmi është jashtëzakonisht shumë domethënës.⁶ Ndikimi sidomos ndërmjet shteteve shpesh herë e shfaq veten e tij në ekonomi.

Edhe pozita në kuptimin e forcës së pushtetit është një mjet i rëndësishëm i fuqisë, sepse thuhet që njerëzit janë në fenë e udhëheqësve të tyre. Andaj kjo fuqi asnjëherë nuk duhet të neglizhohet, në mënyrë që e vërteta dhe drejtësia të udhëheqin vazhdimisht. Në edukatën islame sigurisht që nuk ka kërkim të pozitës. Njeriun duhet ta kërkojnë të tjerët për ta vendosur në një pozitë të caktuar. Këtu mund të themi se si qëllim është treguar arritja e meritës dhe aftësisë për t'u bërë një njeri i kërkuar për pozitën. Atëherë, arritja e një pjekurie që mundëson pranimin nga ndërgjegjja e të gjithëve është një shenjë e cilësisë së lartë. Shoqëritë që nuk mund të nxjerrin liderë të drejtë dhe të fuqishëm, nuk mund të shpëtojnë nga poshtërimi.

Edhe fuqia ushtarake asnjëherë nuk duhet të neglizhohet. Kjo fuqi ka shumë përparësi veçanërisht

në arritjen e respektit dhe konsideratës ndërmjet shteteve, në arritjen e nivelit të një ndikimi të lartë që mund të imitohet nga shoqëritë e tjera dhe madje në arritjen e sigurisë për t'u mbrojtur nga e keqja e armiqve.

Transmetohet se Javuz Sulltan Selimi nuk bënte shumë kujdes ndaj veshjes. Edhe pse rroba i ishte vjetërsuar, ai nuk e ndërronte me një të re. Për këtë arsye, burrat e shtetit hezitnin të dilnin në audiencën e tij me rroba të reja dhe të stolisura qoftë për shkak të respektit apo qoftë për shkak të frikës.

Rroba e padishahut vazhdimisht sa vinte dhe vjetërsohej, por prapë se prapë askush nuk guxonte dot t'ia kujtonte këtë atij. Një herë jepet lajmi se do të vinte një i dërguar jobesimtar. Sadrazami (kryeministri) e shfrytëzoi këtë rast dhe i tha sulltanit:

“I nderuar! Ky jobesimtar me mendjen e tij shterpë mund t'ju shohë me sy përçmues për shkak të pamjes suaj të jashtme. Andaj mendoj se padishahu ynë...”

Javuzi e kuptoi se ku e kishte qëllimin ai. Prandaj ia preu fjalën dhe i tha:

“Po...! Ashtu bëni! Edhe ju porosisni rroba të reja dhe të stolisura!”

Ministrat u gëzuan dhe porositën rroba të stolisura. Kur padishahu do ta pranonte të dërguarin, urdhëroi që në qoshe të fronit të vendosej një shpatë pa këllëf. Çdo gjë ishte gati. Vezirët (ministrat) me në krye sadrazamin kishin veshur rroba të mrekullueshme, ishin mbledhur rreth fronit dhe po prisnin padishahun. Papritur brenda hyri Javuzi, por me rrobën e vjetër të tij.

I dërguari merret në audiencë. Ai po qëndronte i frikësuar përpara Javuzit, i cili kishte dridhur tërë botën në periudhën e vet. Pas ceremonisë tradicionale dhe bisedimeve, i dërguari doli nga audienca e sulltanit. Pastaj Javuzi u tha vezirëve:

“Tani shkoni dhe pyeteni të dërguarin se çfarë mendimi ka për rrobën e padishahut!”

Vezirët menjëherë shkojnë te i dërguari dhe e pyesin për këtë çështje. Përgjigjja që morën ishte kjo: “Unë as që e kam parë sulltanin e madhërishtëm. Shpata pa këllëf në qoshe të fronit, mi mori sytë. Andaj kam parë vetëm shpatën.”

Kur padishahu (sulltani) u njoftua për këtë përgjigje, e drejtoi gishtin nga shpata që akoma qëndronte aty në atë gjendje dhe tha:

“Përderisa kjo të jetë e mprehtë, syri i qafirëve

verbohet dhe nuk mund të na shikojë. Për këtë arsye, nuk mund t'i shikojnë rrobat tona. Allahu Teala mos e sjellë atë ditë kur ajo të mos jetë e mprehtë. Atë ditë do të duhen rrobat e stolisura, sepse shikimi i qafirrit atë ditë do të ngrihet nga toka dhe do të ngulitet te padishahët e lartë osmanë.”⁷

Hadithi fisnik që e përmendëm më sipër siç u tregon besimtarëve që ta kenë si qëllim arritjen e fuqisë, u tregon edhe mënyrën se si mund të realizohet kjo:

“...Ti përpiku me të gjithë fuqinë për ta fituar atë gjë që të bën dobi dhe ji ambicioz në këtë çështje...” Po, ne duhet të jemi ambiciozë për t'i arritur mjetet që na e shtojnë fuqinë dhe që do të jenë të dobishme për ne qoftë në këtë botë apo qoftë në botën tjetër. Mjafton që nijetin ta kemi për Allahun (xh.xh.) dhe fuqinë që e arrijmë ta përdorim jo për veten, por për Allahun.

“...Kërko ndihmë nga Allahu dhe asnjëherë mos shfaq dobësi...” Nëse e nisim rrugën duke i besuar nefsit, do të mbesim në mes të rrugës dhe do t'u drejtohem qëllimeve të gabuara. Por nëse e nisim rrugën me emrin e Allahut dhe kërkojmë ndihmë vetëm prej Tij, atëherë le të mos kemi frikë. Pastaj asnjëherë të mos e shpërshtesë shpresën prej vetes duke thënë: “Ne nuk mund të bëjmë asgjë. Ne jemi të dobët dhe të pafuqishëm.” Sepse, nëse do të na shoqërojë ndihma dhe mbrojtja e Allahut (xh.sh.), asnjë vështirësi nuk mund të qëndrojë para nesh dhe nuk mund të na frikësojë.

Le ta pranojmë kaderin tonë me një nënshtrim të plotë ndaj Allahut Teala duke thënë: “Çdo gjë mund të mos ndodhë sikur dëshirojmë ne. Edhe neve mund të na ndodhë ndonjë fatkeqësi. Sidoqoftë nuk duhet të plogështohemi. Ky paska qenë caktimi i Allahut. Ai bën çfarëdo që të dëshirojë.” Po, le të mundohemi sikur çdo gjë është në dorën tonë, por le ta dimë mirë se çdo gjë është vetëm në dorën e Zotit (xh.xh.). Një besim i tillë do të na mësojë të mos plogështohemi dhe të mos dorëzohemi kundrejt çdo lloj vështirësie dhe fatkeqësie. Madje, nëse arrijmë t'i shohim gjërat me urtësi, kjo situatë mund të bëhet shkak që të na hapen shumë dyer të reja.

Ja pra, kjo është harta e rrugës që e ka përpiluar i Dërguari i Allahut (a.s.), për t'u bërë besimtar i fuqishëm.

Dhimbjet që po i përjetojmë dhe panorama e sotme e popujve myslimanë e shfaqin në formën më të qartë e të dhimbshme domosdoshmërinë e të qenët përsëri një umet i fuqishëm.

■ **REFERENCAT:** 1) Shik. Surja Ankebut, 2-3. 2) Shik. Surja Enfal, 2. 3) Shik. Surja Fet'h, 4. 4) Shik. Muslim, Dhikr, 38. Veçanërisht shik. Ibn Maxhe, Mukaddime, 17. 5) Ibn Hanbel, Musned, IV, 197. 6) Shik. Buhari, Ilm, 15; Zekat, 5. 7) Mustafa Armagan, Historia e Fshehtë e Osmanëve, fq. 69-70.

FALËNDERIM NË MIRËQENIE DURIM NË VËSHTIRËSI

— Ali Riza Temel —

Në fakt, megjithëse falënderimi dhe durimi janë bazë në çdo çështje, falënderimi në mirëqenie dhe durimi në vështirësi janë më të nevojshëm dhe më të vlefshëm. Kjo sepse në përgjithësi kur njerëzit posedojnë mirësi dhe kanë mirëqenie, e harrojnë dhuruesin e atyre mirësive, por kur bien në vështirësi ankohen dhe ligështohen: **“Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm. Kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort, por, kur i bie e mira, ai bëhet koprrac (nuk i jep të varfrit).”** (Mearixh, 19-21)

Kur bëhen të fuqishëm dhe të pasur ata që nuk i besojnë Allahut dhe botës së përtejme në kuptimin

e vërtetë të fjalës, bëhen si të tërbuar, e harrojnë dhuruesin e mirësive dhe adhurojnë mirësitë. **“Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.”** (Alak, 6-7)

Ndërsa ata që besojnë se çdo gjë vjen prej Allahut (xh.sh.) dhe se mirëqenia e vështirësia janë shkaqe për sprovën, nuk heqin dorë asnjëherë prej falënderimit dhe durimit. Vetëm se të tillët janë shumë të pakët: **“...O familje e Daudit! Bëni falënderim (për Allahun)!” Megjithatë, pak nga robërit e Mi, janë falënderues.**” (Sebe, 13)

Falënderim do të thotë që të ndjesh mirënjohje kundrejt mirësisë dhe t’ia shprehësh me fjalë e vepra këtë gjë atij që ta ka bërë të mirën. Ky quhet falënderim për mirësinë. E kundërta është mosmirënjohje ndaj mirësisë.

Shembulli më interesant i atyre që nuk e lënë shukrin/falënderimin ndaj Zotit edhe kur janë të fuqishëm e të pushtetshëm është Sulejmani (a.s.). Ky pejgamber i Zotit i cili kishte nën urdhra erën,

xhindët, kafshët dhe posedonte një pasuri të paparë, kuptonte edhe gjuhën e zogjve dhe të milingonave. Krahas këtyre, ai asnjëherë nuk devijoi nga rruga e drejtë dhe nuk e harroi se ishte një rob i Zotit (xh.sh.).

“...O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!” Ai vuri buzën në gaz, duke qeshur me fjalët e saj dhe tha: “O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!” (Neml, 18-19)

Nemrudi dha Faraoni devijuan për shkak të fuqisë dhe pushtetit që posedonin. Karuni harroi se pasuria që e kishite ishte një mirësi e Allahut (xh.sh.). Ai pohoi se e kishte fituar atë me dijen dhe aftësinë e vet. Këto qëndrime që mbështeten te mosmirënjohja nuk i bënë dobi as Nemrudit, as Faraonit, as Karunit. Që të gjithë u shkatërruan. Të njëjtin fund e kanë pasur edhe popujt që kanë devijuar për shkak të mirësive dhe pasurisë.

Jusufi (a.s.), pikërisht si Sulejmani (a.s.), nuk devijoi prej pushtetit që posedonte. Ai e falënderoi Zotin (xh.sh.), duke e ditur se çdo gjë është mirësi e Tij. Kur doli nga burgu, në të cilin pati rënë për shkak të shpifjes, dhe u bë mbreti i Egjiptit, u takua me nënën, babanë dhe vëllezërit të cilët e patën hedhur në pus. Kur u takua me ata, iu drejtua Zotit (xh.sh.), duke iu lutur: **“O Zoti im! Ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar shpjegimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)!”** (Jusuf, 101)

Edhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), duroi në formën më ideale kundrejt vështirësive dhe e falënderoi Zotin (xh.sh.), për mirësitë që i kishte dhuruar. Kur hyri si një komandant i triumfuar në Mekë, nga e cila e patën dëbuar, për asnjë moment nuk shfaqti ndonjë shenjë të mendjemadhësisë. Ai hyri aty si një rob modest dhe tha: **“Atë që shfaq modesti për hir të Allahut, Allahu e lartëson. Ndërsa mendjemadhin e poshtëron.”** Pejgamberi (a.s.), falte

namaz derisa i ënjteshin këmbët. Atyre që i thanë: **“Përse e mundon kaq shumë veten ndërkohë që të janë falur gjynahet e kaluara dhe të ardhme?”**, ai iu përgjigj: **“A të mos jem një rob falënderues?”** Përveç të tjerash, lutej në këtë mënyrë: **“O Allah! Më ndihmo të të përkujtoj, të të falënderoj dhe të të adhuroj në formën më të mirë!”** (Nesai, Sehv, 60.)

Falënderimi e shton mirësinë, ndërsa mosmirënjohja tërheq ndëshkimin. **“...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia; por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i rëndë.”** (Ibrahim, 7)

Mirësitë e Zotit (xh.sh.), janë aq të shumta sa që nuk mund të numërohen. Për çdo mirësi duhet një falënderim. Meqë edhe marrja dhe dhënia e frymës është një mirësi e madhe, atëherë është e pamundur ta falënderojmë Zotin siç e meriton. Por sidoqoftë le ta falënderojmë të paktën sa të kemi mundësi. Në fakt, edhe Allahu Teala këtë kërkon.

Për sa i përket durimit në vështirësi, në fakt durimi është i nevojshëm në momente të vështira dhe problematike. Në kohë mirëqenieje dhe rehatie nuk ka nevojë për durim. Durimi është fuqia për të rezistuar dhe qëndruar fuqishëm kundrejt vështirësive. Në këtë botë, në të cilën kemi ardhur për t’u sprovuar, absolutisht do të gjendemi ballë për ballë me shumë probleme si domosdoshmëri e kësaj sprove. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: **“Në këtë botë nuk ka rehati absolute.”** Identiteti dhe personaliteti ynë, shkalla e devotshmërisë sonë, sinqeriteti dhe besnikëria jonë dalin në pah me

veprimet tona kundrejt vështirësive. Allahu i Lartësuar thotë: **“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!”** (Bakara, 155-156)

Fitorja arrihet me durim. Edhe vështirësitë kalojnë me durim. Ka tre lloj durimi. 1- Durim kundrejt fatkeqësive, 2- durim kundrejt adhurimeve dhe 3- durim për të rezistuar kundrejt haramëve. Floriri i pastër dallohet qartë kur të shkrihet në zjarr. Edhe cilësia e njeriut del në pah me rezistencën që shfaq kundrejt vështirësive. Rezistencën më të

NË FAKT, MEGJITHËSE
FALËNDERIMI DHE DURIMI
JANË BAZË NË ÇDO
ÇËSHTJE, FALËNDERIMI NË
MIRËQENIE DHE DURIMI
NË VËSHTIRËSI JANË MË
TË NEVOJSHËM DHE MË
TË VLEFSHËM. KJO SEPSE
NË PËRGJITHËSI KUR
NJERËZIT POSEDOJNË
MIRËSI DHE KANË
MIRËQENIE, E HARROJNË
DHURUESIN E ATYRE
MIRËSIVE, POR KUR BIEN
NË VËSHTIRËSI ANKOHEN
DHE LIGËSHTOEN

madhe kundrejt vështirësive e kanë shfaqur pejgamberët. Ata ishin njerëzit që kanë pasur sprovat më të vështira.

Siç thuhet në një hadith fisnik që transmetohet nga Sa'd ibn Ebi Vakkasi (r.a.), Sa'di shprehet: E pyeta Resulullahun: "O i Dërguari i Allahut! Kush janë ata që kanë fatkeqësitë më të mëdha?" Ai më tha: "Janë pejgamberët. Pastaj ata që vijnë pas tyre sipas gradave që kanë. Njeriu sprovohet sipas gradës që ka në fe. Nëse është i qëndrueshëm në fe, sprovat e tij është e rëndë. Nëse është i dobët në fe, sprovohet sipas gradës që ka. Përderisa besimtari të jetojë në këtë botë aq sa të mos i mbetet asnjë gabim, fatkeqësia do ta ndjekë nga pas." (Ibn Maxhe, Hadithi nr: 4023.)

Nuhu (a.s.), e ftoi popullin e tij 950 vjet në tevhid pa u plogështuar. Ibrahim (a.s.), u përpoq shumë me babanë dhe popullin e vet edhe pse i dolën kundër. Atë e hodhën në zjarr. Jusufi (a.s.), u tradhtua nga vëllezërit dhe bashkëshortja e ministrit të Egjiptit i kurdisi kurth. Por në sajë të besimit dhe durimit u bë mbreti i Egjiptit. Kur është pyetur se si e ka arritur këtë pozitë, transmetohet se është shprehur: "(Këtë pozitë) e kam arritur në sajë të durimit që shfaqta në pus, që shfaqta kundrejt vështirësisë së burgut, që shfaqta kundrejt ndarjes nga miqtë dhe qëndrimit larg nga vendlindja."

Sa shumë vuajtje kanë hequr Musai (a.s.) dhe Haruni (a.s.), prej padrejtësive të Faraonit dhe burrave të tij? Por ata arritën fitoren në sajë të durimit të tyre. Si luftoi Isai (a.s.), kundrejt atyre që i thanë "biri i Zotit" dhe atyre që shpifën kundrejt nënës së tij? Pejgamberi Jahja ra dëshmor për shkak se i ftoi çifutët në tevhid. Ndërsa babai i tij, Zekerija (a.s.), u pre me sharrë.

Muhamedi, (a.s.), është shembull më vete për durimin. Politeistët u tallën me të dhe i hodhën papastërti mbi kokë. Elita e Taifit urdhëroi fëmijët që t'i gjuanin me gurë. Ata i gjuajtën me gurë dhe i nxorën gjak nga këmbët e bekuara. Krahas të gjitha këtyre, ai nuk i mallkoi ata, por vetëm u lut: "O Allah! Udhëzoje popullin tim! Ata nuk e dinë të vërtetën."

Vuajtjet që kanë hequr edhe sahabët e nderuar nuk ishin të pakta. Torturat që iu bënë Bilalit, Ammarit ibn Jasirit, Sumejes dhe Habbabit ishin deri në atë gradë sa që ndërgjegjja njerëzore nuk mund t'u

"SA INTERESANTE QË ËSHTË GJENDJA E NJERIUT BESIMTAR! SEPSE ÇDO VEPËR ËSHTË NË TË MIRËN E TIJ. KJO GJENDJE I PËRKET VETËM BESIMTARIT. KUR I VJEN DIÇKA ME TË CILËN GËZOHET, E FALËNDERON (ZOTIN). KY ËSHTË NJË FITIM. NËSE PËRBALLET ME NJË SITUATË PREJ TË CILËS MËRZITET, BËN DURIM. EDHE KY ËSHTË NJË FITIM."

(Muslim, Zuhd, 64.)

rezistonte. Embargoja që iu bë myslimanëve të parë, lënia e tyre në uri, detyrimi i atyre për të ngrënë gjethë pemësh, dëgjimi që nga larg i klithmave të fëmijëve dhe rezistenca e fortë që shfaqën ata krahas të gjithë këtyre janë prej shembujve legjendarë të durimit dhe rezistencës për hir të fesë.

Durimi dhe qëndresa që u shfaqën kundrejt vështirësive dhe vuajtjeve që u përjetuan përgjatë emigrimit në Abisini, marrëveshjeve të Akabesë, luftës së Bedrit, Uhudit dhe Hendekut, i dhanë frytet e tyre. Ata përgatitën terrenin për formimin e Civilizimit Islam i cili ishte civilizimi më i ndritur që kishte parë historia.

Durimi dhe falënderimi janë dy cilësitë më të dallueshme të besimtarëve dhe dy rrugët e fitimit më të madh. Përderisa besimtari të jetë durimtar dhe falënderues ndaj Zotit (xh.sh.), gjithmonë është në fitim. Këtë të vërtetë le ta dëgjojmë nga gjuha e monumentit të durimit, i Dërguari i Allahut (a.s.): "Sa interesante që është gjendja e njeriut besimtar! Sepse çdo vepër është në të mirën e tij. Kjo gjendje i përket vetëm besimtarit. Kur i vjen diçka me të cilën gëzohet, e falënderon (Zotin). Ky është një fitim. Nëse përballlet me një situatë prej të cilës mërzitet, bën durim. Edhe ky është një fitim." (Muslim, Zuhd, 64.)

Zoti (xh.sh.), na bëftë prej atyre që e falënderojnë dhe durojnë në çdo situatë! Gjithashtu na bëftë prej atyre që fitojnë në çdo lloj gjendjeje! Amin!



Historia e mollës në vazo

— Ferudun Ozdemir —

Tregohet se një njeri i ditur u paraqit në klasë me një vazo të gjatë dhe me grykë të ngushtë për t'i dhënë një mesazh nxënësve të tij. E ngriti vazon lart në mënyrë që të shikohej nga të gjithë nxënësit që ndodheshin pranë. Ndërsa në dorën tjetër mbante një mollë. Pasi e vendosi mollën brenda në vazo e lëshoi në tokë dhe tha: "Kush mund ta nxjerrë mollën nga vazoja do jetë e tija!"

Menjëherë u ngrit një prej nxënësve dhe e futi dorën përmes grykës së ngushtë të vazos.

Ai me të vërtetë e kapi mollën, por sa herë mundohet ta nxirrte dorën mbetej e bllokuar në atë grykë të hollë dhe të ngushtë të vazos. Më në fund thirri:

"Dora, dora! Nuk arrij ta nxjerr dot!"

Njeriu i urtë buzëqeshi dhe tha:

"Nëse nuk heq dorë së shtërnguari aq fort mollën, nuk do arrish ta nxjerrësh dorën që aty."

Nxënësi u përpoq përsëri, por pa dobi. Në fund u detyrua ta lëshonte mollën dhe kështu e nxori dorën me lehtësi. Më pas e pyeti mësuesin:

"- A ka ndonjë mënyrë për ta nxjerrë mollën nga vazoja?"

Mësuesi e solli mbrapsht vazon, kështu molla u rrokullis natyrshëm përjashta...

Nxënësit filluan të qeshnin ngaqë zgjidhja ishte kaq e thjeshtë, ndërsa mësuesi i urtë foli:

"-Nuk është aq e thjeshtë sa duket, ndonjëherë më e vështirë është të heqim dorë.

Kur doni të arrini dicka, nëse ju shfaqet një pengesë, më mirë është të tërhiqeni për pak, dhe të vëzhgoni me durim. Mbase ajo për të cilën mundohen aq shumë, mund t'ju jepet natyrshëm..."

Gjatë rrjedhës së jetës, ka gjëra që medoemos doni ti keni, por nuk e kuptoni se shpesh ato arrihen ju duke rendur pas tyre, por duke i lënë natyrshëm të vinë tek ju. Nganjëherë është më mirë të mos ndërhyni aspak. Për sa kohë ndryshoni këndvështrimin tuaj, do të shihni se nuk ka vetëm një mundësi zgjidhjeje, por shumë mundësi zgjedhjeje...

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI



NËN DRITËN E PYETJES SË IBRAHIMIT (A.S.)

BESIMI NË RINGJALLJE

— Xhafer Durmush —

Në suren Bakara thuhet: “...Ibrahimi tha: “O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!” – Zoti i tha: “A nuk beson?” - “Besoj” - iu përgjigj Ibrahim, “por dëshiroj të më qetësohet zemra.” Allahu i tha: “Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërnda në çdo kodër nga një copë prej tyre pastaj thirri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (Bekare, 260)

Historitë në lidhje me Ibrahimin (a.s.), kanë një peshë serioze ndërmjet historive të Kuranit Fisnik që na e ndriçojnë rrugën, sepse në sajë të ngjarjeve që kanë ndodhur për shkak të fjalëve dhe veprave të tij, janë sjellë përgjigje që nuk vjetërsohen asnjëherë për problemet themelore të njerëzimit. Këtu së pari duhet të theksojmë këtë në lidhje me

ajetin fisnik: Pyetja e Ibrahimit (a.s.), nuk ishte një shprehi e dyshimit për ringjalljen. Përkundrazi ai ka dëshiruar që t’i shtohet bindja në zemër dhe si rrjedhojë, përgjigja që iu dha atij të bëhej shembull për njerëzimin. Për këtë qëllim kërkoi që t’i tregohej se si ringjallet një gjallesë që kishte vdekur/ngordhur. Sikundër kësaj Allahu Teala iu përgjigj atij me një shembull fizik, por prapë se prapë nuk ia shpjegoi natyrën e ringjalljes. Kjo sepse mendja e njeriut nuk është e aftë ta perceptojë fenomenin e ringjalljes. Këtu e rëndësishme është që në mendje të gdhendet besimi se Allahu (xh.xh.), do t’i ringjallë të gjitha gjallesat e veçanërisht njerëzit dhe pastaj këta të fundit absolutisht do të merren në llogari. Pas besimit në ekzistencën dhe njësimin e Allahut, principi më i rëndësishëm i imanit është besimi në botën e përtejme. Kjo shtyllë e besimit duhet të jetë e saktë dhe e palëkundshme. Kjo është shtylla e besimit që do të na shpëtojë nga devijimet në këtë botë dhe që do të na japë lumturinë në botën tjetër.

Për fat të keq po dëshmojmë se ka prej atyre që përpiqen të mbjellin farërat e dyshimit nëpër mendjet e njerëzve duke u shprehur se në ajetin fisnik që përbën temën tonë nuk flitet për “therjen dhe copëtimin e zogjve”. Para së gjithash, e kemi të vështirë ta besojmë se një kundërshtim i tillë i pabazë është bërë me nijet të mirë. Ndërkohë që nuk mund të mendohet se një pohim të tillë mund ta bëjnë qoftë edhe ata të cilët e njohin gramatikën në nivelin e fillores, atëherë cili mund të jetë qëllimi i atyre njerëzve që flasim me insistim për këtë përveçse për ta dëmtuar besimin në ahiret?

Siç shihet edhe në ajetin fisnik, Allahu Teala i ka kërkuar Ibrahimit (a.s.), që t’i ushtrojë/mësojë zogjtë me të. Pastaj e ka urdhëruar që nga një pjesë prej tyre (xhuz’en minhunne) t’i lërë nëpër kodra. Lënia nëpër kodra e nga një cope prej zogjve nuk




mund të bëhet pa i therë dhe copëtuar ata. Po ashtu, fluturimi dhe shkuarja e zogjve te personi me të cilin ishin mësuar pa u therë dhe copëtuar, nuk mund të përbëjë argument për ringjalljen. Në Kuranin Fisnik ka disa shprehje që janë pjesë e një tërësie. Për këtë arsye, aty synohet jo vetëm ajo shprehje, por edhe tërësia në të cilën gjendet edhe ajo pjesë. Këtë na jep ta kuptojmë rregulli i belegatit/retorikës në të cilin thuhet “dhikru’l-xhuz, iradetu’l-kul / përmendja e një pjese duke synuar tërësinë”. Nganjëherë mund të flitet për një pjesë të ngjarjes dhe mund të synohet e gjitha. Nganjëherë tjetër mund të flitet për të gjithë ngjarjen dhe të synohet një pjesë e saj. Retorika e shprehjes duhet të merret parasysh edhe në situata kur fjala shprehet në mënyrë të qartë në Kuranin Fisnik. Bazuar në këtë, përgjigjen “që të më qetësohet zemra” e cila iu dha pyetjes “a nuk beson”, mund ta vlerësojmë si një farë qetësie e hedhur në zemrën e njerëzimit.

Për sa i përket hadithit në të cilin i Dërguari i Allahut, (a.s.), është shprehur: “*Ne kemi më të drejtë se Ibrahim (a.s.), në çështjen e dyshimit.*”¹, Pejgamberi (a.s.) këtu ka dashur të thotë: “Meqë unë nuk dyshoj në lidhje me ringjalljen që Allahu u bën të vdekurve, edhe Ibrahim (a.s.), nuk ka dyshuar më parë.” Kur u shpall ajeti fisnik që përbën temën tonë, disa myslimanë thanë: “Ibrahim ka rënë në dyshim. Ndërsa Pejgamberi ynë nuk ka rënë në dyshim.” Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), e dëgjoji këtë, u shpreh: “*Unë jam më poshtë se ai. Si mund të ketë dyshuar Ibrahim ndërkohë që nuk dyshoj unë?*”³ Këtë e bëri për të shfaqur modesti dhe për t’i dhënë përparësi Ibrahimit (a.s.).⁴

Mbajtja gjallë e ndjenjës së njeriu një ditë do të ringjallet dhe do të japë llogari për ato që ka bërë është e rëndësishme, në

mënyrë që njeriu t’i bëjë zgjedhjet në jetën e përditshme brenda kornizës së urdhrave dhe ndalesave të Allahut Teala. Kjo është e rëndësishme për faktin se fitohet disiplina për të jetuar me vetëdijen se në botën e përtejme çdo gjë që bën njeriu e ka një shpërblim apo ndëshkim. Ndërkohë mund të themi se kjo mund të ndikojë edhe për formimin në personalitet të virtyteve islame si bujaria dhe dhënia për hir të Allahut Teala. Në versetin vijues pas ajetit që përbën temën tonë thuhet: “*Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëlajnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kall ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) dhe më tepër kujt të dëshirojë...*”⁵

■ **REFERENCAT:** 1) Buhari, Tefsir, 42; Muslim, Iman, 238. 2) Shpjegimi i Neveviut, II/183; Begavi, I/323. 3) Shpjegimi i Neveviut, II/283; Begavi, I/323. 4) Abdurrahman Atesh, Ibrahimiu tregua nëpërmjet zogjve se si ringjalljen të vdekurit, Revista e Fakultetit të Teologjisë së Universitetit të Stambollit, Pranverë 2016/7 (1) 9-34. 5) Bakara, 261. 6) Bakara, 261.



NDARJA E TË MIRËS NGA E KEQJA

Në suren Enfal thuhet: “*O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t’ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe.*” (Enfal, 29)

Këtu tregohet mënyra për ta rifituar “aftësinë e ndarjes së të mirës nga e keqja” të cilën e kanë humbur njerëzit. Kjo mënyrë është devotshmëria. Pra, është të qëndruarit larg të dyshimtave duke u shqetësuar se mos bie në haram dhe të qenët i kujdesshëm e selektues në zgjedhje siç e mbledh fundin e robës ai që ecën në një vend me ferra.

Siç dihet, e mira në të njëjtën kohë është edhe e drejtë dhe e bukur. Ndërsa të gabuarat dhe të keqijat në të njëjtën kohë janë të shëmtuara. Një njeri që i vlerëson ngjarjet natyrshëm, e ka të lehtë për t’i ndarë këto. Kushti për ta ruajtur këtë lehtësi është marrja për bazë jo e përkufizimeve dhe orientimeve që bëjnë të tjerët në lidhje me të keqen, por marrja për bazë e rregullave që ka sjellë feja. Nisur nga ky kontekst në suren Bakara thuhet “se të devotshmëve do t’u mësohen (nga Allahu) ato që nuk i dinë”.¹

Brezat e sotshëm të cilëve u është pushtuar mendja dhe bota shpirtërore me bombardimet e vazhdueshme të komunikimit, kanë nevojë më shumë se çdo herë tjetër për ta mbrojtur vetëdijen e ndarjes së të mirës nga e keqja. Atëherë lutja e sotshme duhet të jetë ky përgjërimit: “O Allah! Na trego të vërtetën e gjërave!”² Na e trego të vërtetën, në mënyrë që të mos e çojmë dëm kohën tonë të çmuar me vepra të padobishme. Në të vërtetë ne nuk duhet t’ua zgjasim dorën gjërave që janë si zjarr duke u mashtruar nga pamja e tyre ndriçuese.

1. Shik. Bakara, 282.

2. Alijju’l-Kari, Mirkat, 8, 3453.

Dhënia për hir të Allahut është mbrojtje e pasurisë

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Brezat e ditëve të sotme të umetit të Muhamedit (a.s.), vështirësitë universale në të cilat gjenden që prej një periudhe të gjatë myslimanët dhe vendet islame, varfëria, uria, shpërnguljet, emigrantët, mbytjet në det dhe vrasjet në tokë, janë në rendin tonë si një e vërtetë e hidhur e çdo dite.

Padrejtësia që po i bëhet umetit shihet qartazi se nuk është e atij lloji që mund të kalohet duke i protestuar dhe ofenduar armiqtë e jashtëm. Situatat që e forcojnë dorën e fuqive të jashtme, ndarjet, fraksionet, indiferentizmi, qëndrimet dhe veprimet në kundërshtim me cilësitë e vëllazërisë në fe që kemi në strukturën tonë të brendshme, padyshim që po e bëjnë umetin “kafshatë të lehtë”. Dihet se asnjë njeri të mençur nuk mund ta frikësojë fotografia e luanit e printuar në një letër. Fotografia dhe emri nuk shprehin ndonjë kuptim. Kuptimi shprehet vetëm kur të dalë në pah e vërteta e gjallë. Kjo do të arrihet kur umeti t'i zgjidhë vetë problemet e

brendshme dhe ta bëjë vetë mjekimin e sëmundjeve të tij.

Sigurisht që është e domosdoshme të flasim për punët që do të kryhen me afat të gjatë dhe për marrjen e masave të duhura. Por më parë duhet të futen menjëherë në funksion zgjidhjet reale të vështirësive që janë përjetuar. Ata që kanë mundësi, duhet t'i ndajnë mundësitë e tyre në mënyrë bujare me njerëzit nevojtarë dhe të uritur të umetit. Ata duhet të gjejnë mënyrat e solidarizimit brenda umetit duke i formuar institucionet e tyre në shkallë universale. Kjo nevojë ka arritur deri në atë gradë sa që mund të quhet borxh i besimit. Qoftë në planin individual apo qoftë në atë shoqëror, kur bëhet fjalë për infakun (dhënien për hir të Allahut) njerëzit mendojnë se do të mbarojnë ato që posedojnë. Në këtë mënyrë, nuk i vjen radha të menduarit për zhvillimet e reja që do të arrihen nëpërmjet infakut.

Brenda kornizës së këtyre të vërtetave dhe vlerësimeve aktuale, dëshiroj të shtjellojmë një transmetim që do të ndikojë në mënyrë themelore te ndërgjegjësimi për infakun dhe të vepruarit me të. Andaj mendoj se do të ishte veprim i duhur nëse e shqyrtojmë dhe e ndajmë orientimin e të shprehurit dhe të të vepruarit të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

Aishja (r.anha), transmeton se familja



e Resulullahut (a.s.), kishte therë një dele. Pas pak kohe Pejgamberi (a.s.), kishte pyetur: “Çfarë ka mbetur nga kafsha që therëm?” Aishja (r.anha), i kishte dhënë këtë përgjigje: “Prej saj nuk ka mbetur asgjë, përveç një kocke të shpatullës. Të gjithën e kemi shpërndarë.” Nisur nga kjo përgjigje, i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, tha: “Thuaj se na paska mbetur e gjitha përveç një kocke shpatulle!” (Tirmidhi, Sifetu’l-Kijame, 35, Babu fadllu’t-tasadduk, Rijazu’s-Salihin, hadithi nr: 559.)

Në shumë hadithe fisnike shihet qartazi se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka pas dashur shumë të bënte infak e mirësi dhe se vepronte kundrejt njerëzve me një bujari të jashtëzakonshme. Në këtë ngjarje Resulullahu (a.s.), bëhet kureshtar për ta ditur se çfarë kishte mbetur pa u shpërndarë dhe se çfarë ishte shpërndarë nga delja që kishin prerë për hir të Allahut Teala. Për këtë arsye, e pyet Aishen (r.anha), në lidhje me këtë çështje. Pasi nëna jonë, Aishja (r.anha), e njoftoi se e kishin shpërndarë të gjithë mishin e deles përveç një kocke shpatulle, i Dërguari i Allahut (a.s.), bën një shpjegim jashtëzakonisht konciz, të përmbledhur, të bukur, domethënës dhe kuptimplotë duke u shprehur: “Thuaj se na paska mbetur e gjitha përveç një kocke shpatulle!”

Shpjeguesi i Tirmidhiut, Mubarekfuri (v. 1353), thotë: I Dërguari i Allahut (a.s.), me këtë dëshiron t’i kujtojë Aishes (r.anha), ajetin fisnik në të cilin thuhet: “**Gjithçka që keni ju, është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu, është e përhershme...**” (Nahl, 96) Pra, ai po i thotë: “Ato që ke dhënë, do të jenë të përhershme. Ndërsa ato që ke mbajtur, janë kalimtare.” (Shik. Tuhetu’l-Ahvazi, VI, 262.)

Resulullahu (a.s.), na njofton se asnjë gjë që u jepet njerëzve si infak, domethënë si mirësi, nuk humbet por përkundrazi, regjistrohet në emrin e atij që e ka dhënë dhe faktin që gjëja që nuk bëhet infak në të vërtetë duhet të konsiderohet si e humbur e nxjerr në pah me një shprehje shumë domethënëse dhe kuptimplotë duke thënë: “Thuaj se na paska mbetur e gjitha përveç një kocke shpatulle!”

Allahu (xh.sh.), thotë në Kuranin Fisnik: “**...Çfarëdo të mire që të jepni, është në dobinë juaj, nëse ju këtë e bëni vetëm për hir të Allahut! Çfarëdo që të jepni nga të mirat, do t’ju rikthehet e plotë dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.**” (Bekare, 272) “**... Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju...**” (Sebe’, 39)

“**Kush bën një të mirë, do të ketë shpërblim më të mirë se ajo...**” (Kasas, 84) “**Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish...**” (En’am, 160) Ndërsa për t’i shprehur këto të gjitha njëherësh, na njofton për këtë të vërtetë absolute: “**...Çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.**” (Bekare, 173)

I Dërguari i Allahut (a.s.), në një kontekst bën komentimin më të bukur të këtyre ajeteve fisnike. Rezultati është absolut: Infaku sikundër asaj që shihet, nuk e pakëson pasurinë, por e mbron. Madje e shton atë. Edhe ky transmetim që ka lidhje me temën është mjaft interesant:

Në shtëpinë e Ummu Selemesë (r.anha), ishte therë një dele. Kur iu rrjep lëkura, erdhi një i varfër që tha se ishte i uritur. Pejgamberi ynë i nderuar u ngrit vetë, preu një copë mishi nga delja, e ziu dhe ia dha atij burrit për ta ngrënë. Burri i varfër u ngrit dhe u largua. Ai njoftoi një të varfër tjetër për këtë. Edhe ai shkoi aty. I Dërguari i Allahut (a.s.), preu një copë tjetër dhe ia dha edhe atij për ta ngrënë. Në këtë mënyrë, të varfrit që u njoftuan, erdhën aty. Edhe Resulullahu (a.s.), u dha mish atyre për të ngrënë derisa mbaroi mishi i deles së therë. Nisur nga kjo, Ummu Seleme (r.anha), tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ah sikur të kishit ndarë një pjesë për ne nga delja, në mënyrë që të hanim edhe ne.” Pejgamberi (a.s.), i dha këtë përgjigje:

“**Betohem në Allahun se delja që kemi therë tashmë është krejt e jona.**” (Begavi, Sherhu’s-Sunneh, VI, 135-136.)

Të dyja transmetimet tregojnë se çdo mirësi që bëhet për Allahun nuk humbet. Çfarëdo që të jetë ajo gjë që bëhet infak, ajo në të vërtetë mbetet në llogari të atij që e ka dhënë. Edhe fjala e urtë: “Çfarë të japësh me dorën tënde, ajo vjen me ty.”, është një mënyrë e të shprehurit të kësaj të vërtete me gjuhën popullore. Atëherë, ai i cili dëshiron që pasuria e tij të mbetet në llogarinë/librin e sevapeve të veta, duhet ta bëjë infak atë te njerëzit në nevojë qofshin ata prej të afërmve apo njerëzve të tjerë. Prej këtu duhet të fillohet me formimin e garancisë së mirësisë kundrejt shoqërisë dhe umetit.

Bazuar në atë që mësojmë nga hadithi, infak do të thotë vendosje e pasurisë nën mbrojtjen/garancinë hyjnore. Si rrjedhojë, nuk na mbetet asnjë hezitim për të dhënë, për të bërë infak dhe për të qenë altruistë.

AI I CILI DËSHIRON QË PASURIA E TIJ TË MBETET NË LLOGARINË/LIBRIN E SEVAPEVE TË VETA, DUHET TA BËJË INFAK ATË TE NJERËZIT NË NEVOJË QOFSHIN ATA PREJ TË AFËRMVE APO NJERËZVE TË TJERË.



KOHA SI MIRËSI

— Kazim Kara —

Allahu (xh.xh.), e ka sistemuar kohën në atë mënyrë saqë ajo ka aspektin e jashtëm dhe aspektin shpirtëror të saj.

Aspekti i jashtëm i kohës:

Dita del në pah pasi toka rrotullohet rreth boshtit të saj në një formë të përshtatshme me masën e vet. Fenomeni të cilin e quajmë ditë përbëhet nga një natë e një ditë i një rrotullimi të plotë të tokës rreth vetes. Në lidhje me këtë, Allahu i Lartësuar shprehet në Kuran: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët.”** (Al Imran, 190)

Ndryshimet e temperaturës dhe të dritës që ndodhin sipas mënyrës së reflektimit të rrezeve të diellit në tokë përgjatë ditës, i bëjnë ditët shumë të vlefshme. Në të njëjtën kohë edhe netëve u japin një vlerë të veçantë. Në të vërtetë përgjatë natës natyra gjen mundësinë për të pushuar. Në lidhje me këtë Allahu Teala thotë: **“Vallë, a nuk shohin ata, që Ne e kemi bërë natën për pushim, ndërsa ditën për të parë?! Njëmend, këto janë shenja për besimtarët.”** (Neml, 86)

Ndërkohë që toka rrotullohet rreth vetes, rrotullohet edhe rreth diellit në orbitën e saj formë elipsi. Në

këtë mënyrë formohen stinët me nga tre muaj. Toka rrotullohet rreth diellit në këtë orbitë përgjatë një viti. Largësia e tokës nga dielli vazhdimisht ndryshon sipas formës së orbitës. Për shkak të animit shumë të përpiktë të tokës në boshtin e saj, largësia e çdo vendi në sipërfaqen e tokës nga dielli ndryshon përgjatë orbitës duke filluar që nga hemisfera veriore dhe ajo jugore. Stinët të cilat krijohen në sajë të këtyre ndryshimeve të caktuara në një formë të përsosur, kanë ndryshim edhe ndërmjet tyre. Për shembull, në çdo fazë të gjallërimit i cili ndodh në pranverë për shkak të ngrohjes së pari të ajrit dhe pastaj të ujit e tokës kur dilet nga stina e dimrit, formohen bukuri dhe mirësi të jashtëzakonshme.

Ky gjallërim i pafund që ndodh në pranverë bëhet shkak që në stinës e verës bimët të japin prodhimet e pashoqe të tyre. Këto prodhime mjaft të ndryshme nga njëra-tjetra piqen përgjatë periudhës së verës. Secili lloj i këtyre prodhimeve ka kohë të ndryshme për t'u pjekur. Të gjitha këto mundësojnë që në stinës e verës të ketë mirësi të bollshme dhe të llojllojshme.

Ndërsa në vjeshtë fillon të pakësohet gjallërimi në natyrë sikundër pranverës. Për këtë arsye, ndodhin

ndryshime në ngjyra. Mirësitë specifike të kësaj stine i japin natyrës një pamje të ndryshme.

Natyrë kalon në fazën e pushimit përgjatë stinës së dimrit. Shumë vende të botës mbulohen me një petk krejt të bardhë për shkak të ndryshimit në klimë dhe ndryshimeve të ndjeshme që ndodhin te reshjet. Ky fenomen shumë i rëndësishëm edhe nga aspekti i ruajtjes së ekuilibrit të ujit në sipërfaqen e tokës, i jep një vlerë tjetër krejt të veçantë natyrës.

Aspekti shpirtëror i kohës:

Çdo vit, stinë, muaj, ditë dhe moment që kalon është i ndryshëm. Edhe mirësitë që na janë dhënë, janë mjaft të mëdha dhe të shumëllojshme. Ndërkohë që këto ia shtojnë rëndësinë kohës, mund të bëhen shkak që njeriu ta kalojë atë pa ia ditur mjaftueshëm vlerën. Kështu, kur njeriu jep përpjekjet e veta në rrugën për t'i arritur mundësitë dhe mirësitë në këtë botë, në pah mund të dalë një rezultat i cili quhet mangësi në perceptimin e vlerës së kohës. Krahas të gjithave, këtu shumë e rëndësishme është që të mos largohemi nga drejtësia ndërkohë që përpiqemi t'i përvetësojmë mundësitë dhe mirësitë e kësaj bote.

Nisur nga aspekti i vlerësimit të kohës që është dhuruar për njeriun, i cili është shkaku i krijimit të gjithësisë, një njeri që punon me qëllimin të paktën për të siguruar rrëskun e vet dhe të familjes së tij, konsiderohet sikur e ka vlerësuar kohën që i është dhuruar. Në të vërtetë Allahu Teala ka dërguar peygamberë dhe ka zbritur libra si udhëzues për ta vlerësuar kohën në mënyrën më efikase. Andaj ne duhet ta pasojmë Kuranin Fisnik i cili është udhëzuesi më i mirë dhe të Dërguarin e Allahut (a.s.), i cili është shembulli më i bukur. Një njeri që përpiqet të jetojë duke pasuar Kuranin dhe Sunetin, edhe kohën e vlerëson në mënyrën më të përshtatshme. Në të vërtetë adhurimet janë shumë të rëndësishme nga aspekti i vlerësimit më efikas të kohës. Krahas pesë vakteve të namazit, edhe zekati, agjërimi, Xhumaja, netët e mira dhe adhurimet nafile janë jashtëzakonisht të rëndësishme nga aspekti i vlerësimit të kohës. Nga ana tjetër, edhe meditimi mbart një rëndësi të madhe nga aspekti i të kuptuarit të vlerës së kohës.

Një njeri që jeton me përpikmëri ndaj adhurimeve dhe veprave të mira, e falënderon Zotin (xh.xh.), për mirësitë që ia ka dhuruar. Nëse ai nuk bën ndonjë vepër të keqe, Allahu Teala do ta ndihmojë atë. Gjithashtu atë do ta ndihmojnë edhe krijesa të tjera shpirtërore me lejen e Allahut. Si rezultat, ai do ta perceptojë në formën më të mirë mirësinë e kohës.

Jeta e kësaj bote është shumë e shkurtër për njeriun i cili është një qenie fizike dhe shpirtërore. Për këtë arsye, koha mbart një rëndësi të veçantë në jetën tonë. Ndërsa jeta e botës së përtejme është e pafundme për njeriun. Andaj koha aty do të jetë shumë më e ndryshme nga koha në jetën e kësaj bote. Për shkak se në xhenetin e përhershëm mirësitë janë të jashtëzakonshme dhe të pakufishme, koha aty mbart një rëndësi shumë të madhe. Koha në jetën e xhenetit fiton një vlerë jashtëzakonisht shumë të madhe me mundësitë e shpeshta për të parë të Dashurin tonë, pra, Allahun Teala. Kjo sepse mundësitë e të gjithëve për ta parë Allahun (xh.sh.), në xhenet nuk do të jenë të njëjta.

Koha mbart një rëndësi të madhe edhe në jetën e xhehenemit. Qëndrimet që nuk janë të njëjta për ata që do të rrinë një kohë të caktuar aty, e bëjnë të rëndësishme kohën në jetën e xhehenemit. Për ata që do të qëndrojnë gjithmonë aty, Allahu na ruajt, koha është një ndëshkim që nuk mbaron asnjëherë.

Edhe jeta e varrit shfaq një situatë të ngjashme me xhenetin dhe xhehenemin sipas gjendjeve të njerëzve. Aty funksionimi i kohës sipas kësaj bote nuk ka ndonjë vlerë.





Edukimi shpirtëror

PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE

— M. Ali Eshmeli —

Kurdo që njerëzimi është bërë pre e interesave dhe e dëshirave të nefsit, atëherë është bërë edhe agresive dhe barbare. Ajo kështu ka ndarë të njëjtin rol me shejtanin e mallkuar. Madje, e ka tepruar edhe më shumë. Si rezultat, doli Nemrudi dhe tha: “... (Edhe unë jam zot.) **Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje...**” (Bakara, 258) Doli Faraoni dhe i: “**Tuboi njerëzit e u deklaroi: “Unë jam zoti juaj më i lartë!”** (Naziat, 23-24) Doli Karuni dhe tha: “**...Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime...**” (Kasas, 78)

Çfarë nuk kanë bërë dhe çfarë nuk kanë thënë. Edhe pse një fjalë e urtë thotë: “Ha kafshatë të madhe, por mos fol me fjalë të mëdha!” – ata që nuk dëgjojnë dhe nuk marrin mësim nga e kaluara, vazhduan të bëheshin hallka të reja të të njëjtit gabim. Ata formuan rrugë të ndryshme dhe guxuan të bënin punë çnjerëzore për t’i arritur qëllimet e tyre. Ata u bënë mosmirënjohës e mashtrues dhe u zhytën në ligësi. U bënë dinakë dhe e shndërruan në profesion dinakërinë e mashtrimin. Gjithmonë shkaktuan luftëra, i vranë dhe i prenë njerëzit vetëm e vetëm për të qëndruar në pushtet. Ata dhanë çdo gjë të tyre për këtë. Pastaj e tepruan aq shumë sa që deklaruan se ishin zota. Gjithashtu pohuan se ishin edhe pejgamberë. Kur nuk i arritën dot ato që dëshironin, u tërbuan. Pastaj u mburrën, u hoqën si të mëdhenj dhe krenarë me ato që bënë. Ata bënë çdo lloj agresiviteti dhe barbarizmi në këtë rrugë. Allahu Teala thotë për këta në Kuranin Fisnik:

“Pikërisht këta janë ata që kanë këmbyer udhëzimin me humbjen, kështu që tregtia atyre nuk u solli kurrfarë dobie dhe as nuk ishin të udhëzuar në rrugën e drejtë.” (Bakara, 16)

Sytë e tyre u verbëruan kundrejt dritës që do t’ju bënte dobi. Ndërsa veshët iu shurdhuan kundrejt fjalës hyjnore. Secili prej tyre u bë prej të poshtëruarve. Të gjithë u rrëzuan dhe u kapluan nga dobësia më e madhe. Njëri prej tyre u mposht nga një mushkonjë topalle, dikush u përpi nga dheu dhe dikush tjetër u mbyt në ujë.

Ata jetuan larg dhe të shkujdesur ndaj Zotit dhe përshpirtjes. Kjo u bë shkak për shkatërrimin e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër. Ata që ia vunë veshin thirrjes hyjnore, morën mësim. Ndërsa ata që i mbyllën sytë ndaj mesazhit hyjnor dhe e lanë në harresë, përsëritën të njëjtat gabime. Tani edhe bota që po globalizohet po shfaq përsëri të njëjtat gabime dhe injorancë. Siç kanë qenë të djeshmit fatzinj, ashtu janë edhe të sotmit. Ata qëndruan larg Rrahmanit dhe afër shejtanit. Qëndruan larg drejtësisë e mëshirës dhe pranë zullumit e poshtërsisë. Qëndruan larg përshpirtjes e njerëzillëkut dhe ia dedikuan jetën e tyre adhurimit të interesave dhe barbarizmit. Qëndruan larg shpëtimit e prehjes shpirtërore dhe merituan humbjen e ndëshkimin.

Kur njeriu privohet nga cilësitë e virtytshme dhe edukimi shpirtëror, për fat të keq, kërkon vetëm shkatërrimin e vet. Vetëm për shkak të kësaj gjith-

monë ka ngjarje tragjike dhe të tmerrshme ndërmjet individëve, familjeve, shoqërive dhe popujve. Në dorën e kujtdo që të jetë fuqia, klithmat dhe britmat që i shkakton mendimi se i forti është në të drejtë po dëgjohen në çdo vend të botës. Çfarë nuk shkatërrojnë sulmet, urrejtjet e pafundme, barbarizmat dhe padrejtësitë e atyre që janë tepër të pasur dhe që janë të privuar nga aspekti shpirtëror? Ja pra, u bënë dy shekuj që në gjeografinë islame po shkatërrohet historia, civilizimi, bibliotekat, po shemben monumentet, po vriten foshnjat, po vriten nënat, po prishen vatrat dhe po shkatërrohet çdo gjë prej qafirëve dhe një dore shkatërrimtare. Të gjithë njerëzit po përfuturojnë tmerr. E gjitha kjo sepse njeriu ka nevojë për edukim.

Njeriu ka nevojë për edukim shpirtëror, jo për edukim djallëzor. Ai ka nevojë për një edukim shpirtëror që do ta bëjë të jetojë sipas rregullave në dobi të njerëzimit. Ky edukim është disiplina, mësimi dhe kalitja shpirtërore. Pra, është edukimi mistik Islam, sepse ky lloj edukimi i ka gjuhëzuar në derën e të vërtetës edhe mbretërit më të fuqishëm të botës dhe i ka bërë ata jo tiranë kundrejt popujve të tyre, por monumente mëshire dhe veçanërisht personalitete të larta. Në sajë të këtyre, bota dëshmoi për shekuj me radhë mëshirë, drejtësi dhe prehe shpirtërore. Ligësitë u mposhtën. Për këtë arsye, ato nuk mundën t'i shkatërrojnë muret e mirësisë dhe mëshirës. Por siç e sulmojnë shëndetin mikrobet sapo të gjejnë mjedisin e përshtatshëm, edhe ata që përbëjnë palën negative, si domosdoshmëri e sprovës hyjnore mbi sipërfaqen e tokës, gjithmonë janë përpjekur ta prishin njerëzimin sapo u është dhënë shansi i parë. Format më të tmerrshme të këtyre aksioneve me mikrobe janë qasjet që shfaqen sikur të jenë me të vërtetën, por që në realitet përpiqen t'ia shkatërrojnë aspektin shpirtëror njeriut dhe ta shndërrojnë atë plotësisht në një krijesë materialiste.

Veçanërisht këtu dëshirojmë të theksojmë edhe armiqësinë ndaj përshtatshëm. Kur këtë e bëjnë jobesimtarët, është normale, por kur të diturit e shkujdesur zënë vend në të njëjtin rresht me jobesimtarët kundër përshtatshëm, atëherë kjo është një humbje e madhe dhe e dhimbshme. Edhe përdorimi i materialeve fetare për t'ia tharë dhe shkatërruar njeriut aspektin shpirtëror, është diçka mjaft e çuditshme. Pra, është diçka dredharake sikur dëshiron ta bësh njeriun ateist duke i thënë: Ky është besimi më i drejtë! Prandaj duhet të pyesim:

Përpjekja për ta shkatërruar devotshmërinë, edukatën, urtësinë dhe përshtatshëm që Islami dëshiron t'i ndërtojë te njeriu, mos vallë është një miqësi me zemër të hapur apo një armiqësi e fshehtë me zemërngurtësi? Mos vallë është një punim akademik i pranueshëm apo aktivitet i një injorance dinake

dhe disfatizëm? Mos vallë është edukim shkatërrim i ndërtesës së paqëndrueshme të besimit të nxënësve me dinamitin e dyshimit krejt pa vend dhe pa e ndjerë ata? Mos vallë nxjerrja e të vërtetës në pah, njohja e së drejtës dhe përfaqësimi i saj është veprimtaria për ta këputur si me sëpatë këtë lidhje të dobët të brezit të sotshëm që ka me Allahun dhe Pejgamberin për shkak të atyre që kanë bërë jobesimtarët? Çfarë shpreh mendimi për ta thyer timonin për shkak të shoferit të dobët, apo mendimi për t'i shkatërruar mihrabet për shkak të një imami që gabon, apo mendimi për t'i thyer lapsat dhe grisur letrat për shkak të një pikturë të shëmtuar? Qëllimi nga kjo është mjaft i qartë. Për këtë arsye, sot ndjehet nevoja për përshtatshëm më shumë se kurrë. Veçanërisht devotshmëria, siç ka qenë gjithmonë, edhe në ditët e sotme është shumë e domosdoshme. Mbi të gjitha është e domosdoshme për botën e dijes/shkencës. Përndryshe njeriu largohet nga Allahu Teala. Ai largohet nga Zoti (xh.xh.), sado i ditur që të jetë. Pra, largohet nga Allahu i Lartësuar siç është larguar shejtani i mallkuar. Ndërsa shkaku i vetëm i këtij largimi është egoizmi... Pra, kanceri shpirtëror që është kusht për t'u hequr nga njeriu. Për këtë arsye, kjo çështje në mistikën islame është njëra prej temave bazë të edukimit të njeriut, sepse egoizmi është një çengel i shejtanit që e pengon robin për t'iu afruar Allahut Teala. Ja pra, edhe shejtanin, krahas gjithë asaj dijeje që kishte, mikrobi i egoizmit e shkatërroi. Për këtë arsye, edukimi shpirtëror është një urdhër hyjnor i ardhur pikërisht nga Allahu, xhel-le xhelaluhu, për të nxjerrë nga zemra dhe jeta çdo lloj të egoizmit negativ dhe të gjitha ndikimet e tij.

Praktika më e qartë e kësaj është kurban, sepse kurban nuk është vetëm çështje e therjes së kafshës. Kurban, para therjes së kafshës, ka anën e edukimit hyjnor që përjetohet nga besimtari. Ky edukim formohet në formën: Flijim i egoizmit, nefsi, pasuria, shpirti dhe fëmijët të mos zënë vendin e Zotit (xh.sh.), në zemër dhe të gjitha këto t'i bëhen kurban/t'i dorëzohen Allahut Teala. Ato duhet të bëhen kurban për Allahun Teala në thellësitë e zemrës dhe asnjëherë nuk duhet të shndërrohen në idhuj. Ky rregull është i vlefshëm për dijen, për fëmijët, për pasurinë, për jetën etj. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e ka hedhur edhe në praktikë amanetin që në të vërtetë duhet të bëhet kurban shpirtërisht, në mënyrë që ta kuptojë e gjithë njerëzimi.

A e urdhëron Allahu njeriun që të therë fëmijën e tij? A mund ta zbatojë njeriu këtë urdhër? Nëse Allahu është Ai që e urdhëron këtë, sigurisht që mund ta zbatojë, sepse Allahu Teala urdhrin e Tij në fakt e bën që të zbatohet, por rezultatit e realizon sipas vullnetit të tij të lartë dhe jo siç shikohet dhe

pritet nga njerëzit. Ja pra, me këtë vetëdije Ibrahim, (a.s.), e çoi birin e tij, Ismailin në vendin ku do ta bënte kurban. Sipas transmetimeve Ismaili (a.s.), më së shumti ishte trembëdhjetë vjeç. Babai i tij e shtriu atë përtokë me dhembshuri, ia vuri thikën në fyt dhe e tërhoqi, por në ato momente Allahu Teala e urdhëroi thikën të mos priste. Për këtë arsye, ajo nuk e preu Ismailin (a.s.). Domethënë, Allahu i Madhëruar e urdhëroi Ibrahimin (a.s.): “There birin tënd për ta bërë kurban për Mua!” Ndërsa thikën e urdhëroi: “Ndërsa ti mos e prit!” Në këtë mënyrë, vepra e therjes u realizua vetëm në botën e brendshme të Ibrahimit (a.s.) dhe të Ismailit (a.s.).

Ndërsa baba e bir ishin të habitur nga kjo që ndodhi, në ato momente erdhi Xhebraili (a.s.). Pranë kishte një dash që e kishte sjellë nga Xheneti. Ai u dha s'hariq atyre për mirësinë e Allahut Teala. Ata thanë tek bira dhe e therën dashin. Allahu i Madhëruar ka thënë kështu për Ibrahimin, (a.s.), në Kuranin Fisnik:

“Ibrahimi, i cili ishte shumë besnik...” (Nexhm, 37) Krahas lavdërimit që i bëri, i dha edhe vlerësimin hyjnor duke u shprehur: **“Ne e zëvendësua atë (Ismailin) me një kurban të madh dhe i lamë atij (Ibrahimit) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. “Paqja qoftë mbi Ibrahimin!” Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirët. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë.”** (Saffat, 107-111)

Domethënë se qëllimi i Allahut Teala kur e urdhëroi Ibrahimin për ta therë birin e tij, Ismailin, (a.s.), nuk ishte që ta bënte një baba të therte birin e tij, por ishte që ta bënte një baba t’i ekzekutonte të gjitha dashuritë e përkohshme përveç dashurisë së Allahut në zemrën e vet. Pra, edhe nëse bëhet fjalë për dashurinë ndaj fëmijës. Ndërsa qëllimi që e urdhëroi Ismailin ta pranonte këtë flijim, nuk ishte për ta therë atë në qafë, por për ta bërë atë ta kuptonte se diçka që i përket Allahut nuk mund të bëhet e askujt. Madje, këtë ia aprovoi me babain e tij.

E gjithë çështja është që të mos biem në një gjendje që nuk dëshirojmë t’i kthejmë pas amanetet që ka dhënë Allahu Teala dhe të mos i shndërrojmë ato në idhuj. Pra, të mos e shndërrojmë në idhull as shpirtin, as pasurinë dhe as fëmijët dhe të përjetojmë besnikërinë e dashurinë për t’ia dhënë çdo amanet Poseduesit të vërtetë.

Allahu i Lartësuar kërkon vetëm këtë gjendje dashurie. Përndryshe, qëllimi i Tij nuk është që ta bëjë

robin të therë birin e tij. Siç ka thënë edhe Mevlana, Xhelaledin Rumi: “Nëse dikush e zgjat qafën dhe përgatitet për t’u bërë kurban për Allahun si Ismaili, Allahu nuk lejon që t’i pritët qafa.”

Siç është kusht të jesh mysliman për të therë kurban, po ashtu, edhe për t’u bërë kurban është kusht një nënshtrim në shkallën e dashurisë. Gjithashtu, siç është kusht që të jesh i lirë për të therë kurban, edhe për t’u bërë kurban është kusht një vullnet dhe dëshirë që buron nga brenda dhe pa pasur asnjë lloj imponimi. Siç është kusht për të qenë një njeri i mençur që e ka arritur pubertetin për të bërë kurban, edhe për t’u bërë kurban është kusht që të jesh një njeri me mendje të shëndosh dhe i pjekur shpirtërisht. Siç është kusht pasuria për të therë kurban, është kusht është për t’u bërë kurban. Në çfarëdo çështjeje që do të bëhemi kurban, mendja dhe zemra duhet të jenë të pasura në lidhje me

atë çështje. Nëse do të bëhemi kurban për besimin, patjetër duhet të jemi të pasur në besim. Në të njëjtën mënyrë, duhet të jemi të pasur në dashuri, në dije etj., sepse dikush që është i varfër në dashuri, nuk mund të bëhet kurban. Ai që është i varfër në besim, nuk mund të bëhet kurban. Të bërë kurban është shenjë e pasurisë. Gjithashtu është edhe shenjë e besnikërisë dhe lidhjes së fortë shpirtërore. Nisur nga kuptimi dhe natyra sublime e kurbanit, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

“Namazi është kurban i çdo njeriu të devotshëm.” (Kuzai, Musned, I, 181.)

Nisur nga ky aspekt, e vërteta më e qartë e kurbanit është që ai të bëhet për hir të Allahut Teala. Thuhet se në umetet e kaluara kishin qenë dy besimtarë. Në vendin ku jetonin, politeistët i kishin imponuar për të therë kurban për një idhull që e kishin bërë vetë. Ata të dy rezistuan dhe e refuzuan këtë duke thënë: “Kurbani theret vetëm për Allahun.” Këtë herë politeistët i kërcënuan duke u thënë: “Atëherë përgatituni për vdekje! Ose do të therni kurban për idhullin tonë, ose do t’ju vrasim!” Por politeistët nuk e arritën dot atë që dëshironin. Për këtë arsye, atyre zullumqarëve dhe fatzinjve iu shtuan edhe më shumë zemërimi e hidhërimi. Më pas, këtë çështje e kthyen në çështje inati. Ata patjetër dëshironin t’ua bënin atë që u thoshin. Por sidoqoftë, gjoja e lehtësuan pak propozimin duke u thënë: “Të paktën therni një mizë dhe shpëtoni nga vdekja!”

“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar. Dhe, jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve!”

(Haxh, 37)

Njëri prej këtyre dy besimtarëve e pa të zakonshëm dhe jo të dëmshëm me një shikim sipërfaqësor këtë propozim. Pastaj bëri një vlerësim të verbër dhe mendoi: “Ajo është thjeshtë një mizë! Çfarë të keqeje ka nëse e ther atë? Në vend se të vdes, më e logjikshme do të ishte që ta therja këtë mizë...” Nisur nga ky mendim, ai e pranoi këtë propozim të politeistëve. Menjëherë pasi e pranoi, bëri kurban një mizë për idhullin që i treguan ata. Pastaj politeistët e lanë të lirë atë. Po kështu edhe besimtarit tjetër thanë:

“Hajt, there edhe ti një mizë!” Por besimtari tjetër nuk e pranoi këtë propozim. Përsëri ua ktheu: “Sido që të jetë, kurban i theret vetëm për Allahun!” Nisur nga ky refuzim, politeistët u zemëruan shumë dhe e martirizuan këtë besimtar të begatë duke i thënë: “Sa njeri i pamend paske qenë!” Në këtë mënyrë, ky besimtar e dha shpirtin, por nuk e dha besimin. Për këtë arsye, u bë prej banorëve të Xhenetit. Ndërsa besimtari që bëri kurban një mizë për idhullin e politeistëve dhe që mendoi se shpëtoi, ndërroi jetë pa e shpëtuar dot besimin e tij kur i erdhi exheli. Për shkak të kësaj, ra në humbjen e përhershme.

Ja dy pikëkthesa/qëndrime për shkak të kurbanit! Që të dyja janë jetike. Që të dyja janë shumë të rëndësishme nisur nga destinacionet. Që të dyja shumë të rralla nisur nga mësimi që japin. Mesazhi që jepet është mjaft i qartë: Dashuria, besimi dhe afrimiteti ynë është vetëm sa sakrifikojmë, sepse jeta është e ndërtuar mbi themelin e sakrificës. Edhe feja është sakrificë, edhe dashuria...

Ibrahimi (a.s.) u hodh në zjarr me katapultë nga ana e Nemrudit dhe e fitoi sprovën e sakrificës me jetën e tij. Zjarri jo që nuk e dogji Ibrahimin, (a.s.), por u shndërrua edhe në kopsht trëndafilash për të. Pejgamberi i begatë në këtë mënyrë fitoi cilësinë “el-Halil / mik i Zotit”.

Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka shfaqur të njëjtën sakrificë. Madje, ai arriti pikën kulmore në shfaqjen e sakrificave. Në këtë mënyrë, fitoi cilësinë “el-Habib / i dashuri i Zotit”. Edhe sakrifikesit në kohën e tij që i thanë me gjithë zemër: “Të qofshin falë dhe tu bëfshin kurban nëna, babai dhe pasuria ime, o i Dërguari i Allahut!” – në audiencën e tij për çdo urdhër, dëshirë, shenjë, frymë, hap, fjalë dhe të vërtete që shprehte, arritën nderin për t’u bërë sahabë të tij. Ndërsa ata që u bënë shembuj të kësaj sakrificë pa e parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), fituan pozitën për t’u bërë vëllezërit e Pejgamberit (a.s.). Ai që e sakrifikoi veten për një përgëzim të tillë, u bë Fatih dhe Akshemseddin. Ata që shfaqën sakrificë të panumërta, gjithmonë u lartësuan dhe u bënë Mevlana, Junus, Edebal, Nakshibend dhe Hydaji. Të gjithë këta arritën gjendje sublime.

Në të vërtetë, a nuk është sakrificë e fshehta e festave të vërteta? Sigurisht! Ai që e bën veten kurban, ka festë. Ai që e bën pasurinë kurban, ka festë. Ata që ia dorëzojnë në kohë fëmijët Zotit (xh. xh.), kanë festë, sepse Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik:

“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar. Dhe, jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve!” (Haxh, 37) Domethënë, qëllimi nga kurban i është që ta mbrujmë gjendjen tonë shpirtërore me devotshmëri. Domethënë, afrim te Allahu Teala. Pra, afrim me sinqeritet ndaj Tij. Afrim me gjithë shpirt dhe nën orientimin e Islamit. Afrim me dashuri. Afrim në një mënyrë shumë të pastër. Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se kurban i gjithmonë e afron njeriun te ai për të cilin e ka therë kurbanin. Nëse njeriu ther kurban për një gur, atëherë edhe njeriu ngurtësohet. Nëse ther kurban për dhe e pluhur, atëherë edhe shpirti zhytet në baltë. Nëse njeriu ther kurban për Allahun e Lartësuar, atëherë zemrat bëhen udhëtare të miraxhit.

Për këdo që të bëhet therja e kurbanit, andej anon edhe qendra e besimit. Pastaj fillon një lidhje e fortë ndërmjet atij për të cilin është therë kurban i dhe atij që e ka therë kurbanin. Për këtë arsye, personin prej atyre dy besimtarëve që folëm më sipër në të vërtetë nuk e shkatërroi therja e kurbanit, por afrimi me idhujt për shkak të nijetit për kurbanin. Sikundër kësaj, besimtari tjetër u lartësua dhe e arriti lumturinë e përhershme me nënshttrimin dhe kurbanin që bëri për Allahun e Madhëruar, sepse me kurbanin, i cili është afrim i zemrës me atë për të cilin bëhet kurban i, qoftë pozitiv apo qoftë negativ, përjetohen ndryshime dhe transformime të mëdha. Prandaj, edukimi i njeriut në lidhje me kurbanin mbart një rëndësi shumë të veçantë, sepse, nisur nga natyrshmëria e tij, nëse njeriu jepet pas krijësive të përkohshme, domethënë, nëse kaplohet nga paraja, objektet e çdo gjë tjetër, duke u bërë kurban për to, atëherë largimi prej tyre bëhet i vështirë e në disa raste edhe i pamundur. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për të kundërtën e kësaj gjendjeje. Kushdo që e flijon veten e tij për dashurinë sublime dhe Krijuesin e Lartë, do të thotë se zemra e tij tashmë është e lidhur me lidhje të pakëputshme. Në të vërtetë, e gjitha që synohet nga këto që thamë është arritja e kësaj pjekurie në rrugën e nënshttrimit ndaj Allahut (xh.sh.).

VENDOSMËRIA PËR TË PËRBALLUAR PENGESAT

— Adem Saraç —

I Dërguari i Allahut (a.s.), bashkë me sahabët e nderuar që mblidheshin përreth tij, e vazhdonte predikimin me hallkën që zgjerohej çdo ditë që kalonte. Çdo ditë kishte njerëz të rinj që i shtoheshin kësaj hallke. Islami vazhdonte të ndriçonte me të gjithë forcën e tij. Çdo sahab që ndriçohej me dritën e Kuranit Fisnik, menjëherë përqij për të gjetur rrugët e arritjes të dikush tjetër. Në këtë proces të ndriçimit, Meka dhe rrethinat e saj filluan të ndriçoheshin në një formë të dukshme. Por politeistët me shpirt të zymtë, që shqetësoheshin nga kjo gjendje, merrnin vendime të errëta nëpër vende po kaq të errëta dhe kërkonin mënyrat për t'i thënë "Stop!" kësaj ecurie. Ata filluan të mendonin seriozisht për sa i përket çështjes se çfarë mund të bënin për ta ndaluar kauzën e tevhidit. Më së fundi, vendosën të talleshin me myslimanët duke filluar që nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të.

Ata do t'ua prishnin moralin atyre duke u tallur me myslimanët, duke i lënduar sahabët e nderuar bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.) dhe duke i vënë ata në pozitë të vështirë.

Domethënë, ata po u hapnin myslimanëve luftë psikologjike. Kur e shikonin të Dërguarin e Allahut (a.s.), menjëherë fillonin ta tallnin dhe t'i thoshin fjalë të shëmtuara duke u mbledhur përreth tij:

-Ja, ky është ai që i kanë bërë magji!

-Ky është poeti i kapluar nga xhindet!

-Ky është magjistari që është kapluar nga shejtani!

-Mashtroes, magjistar, shpifës!¹

Pra, ata e tepruan deri aty sa që thoshin të tilla fjalësh për Diellin e të dyja botëve, i cili u dërgua si mëshirë për botët! Sikur të mos mjaftonte me kaq, kurdo që e shikonin atë duke ardhur apo duke shkuar, tërboheshin nga zemërimi dhe nuk hezitnin t'i thoshin çdo gjë që u vinte për gojë!² Allahu Teala e përshkruan kështu këtë gjendje të atyre politeistëve të mjerë:

"Kur dëgjojnë Kuranin, mohuesit sa nuk të hanë me shikimet e tyre dhe thonë: 'Ai është vërtet i marrë!' Por Kurani është vetëm këshillë për botët." (Kalem, 51-52)

Në vend që mushrikët të mendonin rreth këtyre dhe ta mblidhnin veten duke marrë mësim kur iu predikuan këto ajete fisnike, ata e tepronin edhe më shumë në tërbimin e tyre. Në çdo vend ku e shikonin të Dërguarin e Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e ofendonin dhe i thoshin çdo gjë që u vinte në gojë për ta përçmuar:

-Shikoni, po kalon i shastisuri që e ka humbur rrugën!

-A ky është ai që flet keq për idhujt tanë?

1. Ibn Hisham, es-Siretu'n-Nebevijje, vëll. 2, fq. 50-51.

2. Ibn Is'hak, Kitabu'l-Mubteda ve'l-Meb'as, fq. 359.



-Ja, ky është ai që e kanë goditur idhujt tanë!³

Të gjitha këto nuk i bëheshin vetëm të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Edhe sahabët e nderuar ishin në të njëjtat vështirësi. Kur politeistët shikonin ndonjërin prej sahabëve, menjëherë i hidhnin fjalë pa hezituat aspak:

-Shikoni kush po vjen!

-Shikoni, po vijnë mbretërit!

-Po vijnë mbretërit, po vijnë mbretërit!

-A këta janë njerëzit që Allahu u ka dhënë mirësi ndërmjet nesh?

-Këta janë më të mençurit prej nesh!

-Shikojini edhe këta!

-Ha, ha, ha!⁴

Allahu Teala i përshkruan në këtë mënyrë edhe këto gjendje të tyre:

“Vërtet, keqbërësit qeshnin me ata që besonin, duke ia shkelur syrin njëri-tjetrit, sa herë që ata kalonin pranë tyre. Kur ktheheshin te njerëzit e vet, ata talleshin (me besimtarët) dhe, kur i shihnin ata, thoshin: “Këta janë të humbur”, ndonëse nuk qenë dërguar për kujdestarë të tyre. Por sot, ata që kanë besuar, do t’i përqeshin jobesimtarët, e nga divanet e ngritura do t’i shikojnë. A janë shpërblyer meritueshëm mohuesit për atë që kanë bërë?!” (Mutaffifin, 29-36)

Politeistët e poshtër e shtuan çdo ditë dozën e talljeve të tyre. Madje e tepruan aq shumë, saqë jo vetëm sahabëve, por edhe të Dërguarit të Allahut (a.s.), iu ngushtua kraharori. Ai hoqi vuajtje shumë të mëdha. Sado që përpiquej të duronte, prapë se prapë fjalët që përdoreshin për tallje ishin të padurueshme. Padyshim se Allahu Teala e shikonte, e dëgjonte dhe e dinte çdo gjë. Sigurisht që të Dërguarin e Tij (a.s.), nuk do ta linte pa mbrojtje. I Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe sahabët e tij të nderuar që nxirrnin trëndafila prej ferrave, e dinin se sa e vështirë është kjo punë. Ndërkohë me shpalljen që vinte po hapej një horizont i ri:

“Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që të tallin, e të cilët, përveç Allahut, adhurojnë edhe zot tjetër. Do ta marrin vesh mirë ata! Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre, andaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur! Dhe

3. Ebu Nuajm el-Isfahani, Delailu'n-Nubuvve, vëll. 1, s. 268.

4. Ibn Sejjidu'n-Nas, Ujunu'l-Eser fi Fununi'l-Megazi ve's-Sijer, vëll. 1, fq. 113.

adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Hixhr, 95-99)

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe sahabët e nderuar merrnin frymë dhe e rinovonin veten me këto ajete të reja që vinin, qetësoheshin shumë edhe me përgëzimet që vinin në lidhje me të ardhmen. Ndër të tjera, shpallja vinte edhe në lidhje me profetët e kaluar:

“Me të vërtetë, janë përqeshur shumë të dërguar para teje, por ata që përqeshnin i përfshiu ajo me të cilën ata talleshin.” (En'am, 10) Po, ky ishte caktimi i Allahut të Madhëruar. Kauzën e madhe e marrin përsipër burra të mëdhenj. I Dërguari i Allahut (a.s.) dhe sahabët e nderuar që i pati edukuar ai, ishin prijësit e kësaj kauze të madhe. Edhe pejgamberët që kanë qenë dërguar më përpara, kështu kanë qenë. Por kjo nuk ishte e lehtë, sigurisht. Pra, ishte një punë mjaft e vështirë. Prandaj, malet e vështira i kalojnë vetëm trimat! Zoti ynë këtë kërkonte. Për këtë arsye, përparimi në këtë rrugë do të vazhdonte çfarëdo që të thoshin politeistët e mjerë. Udhëtarët do ta vazhdonin udhën, sepse i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ishte shembulli më i bukur.

Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem...

E TEPRUAN AQ SHUMË, SAQË JO VETËM SAHABËVE, POR EDHE TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.), IU NGUSHTUA KRAHARORI. AI HOQI VUAJTE SHUMË TË MËDHA. SADO QË PËRPIQJË TË DURONTE, PRAPË SE PRAPË FJALËT QË PËRDORESHIN PËR TALLJE ISHIN TË PADURUESHME...





“Luftoni në rrugën e Allahut,
ashtu si duhet luftuar!..”

(Haxhxh, 78)

LUFTA NË RRUGËN E ALLAHUT

Xhihadi është një nga konceptet më të rëndësishëm të Kuranit dhe Sunetit, i cili vitet e fundit është kthyer në një nga termat më të debatueshme dhe më ogurzeza. Kjo gjendje nuk buron nga fakti se kjo temë është e pakuptueshme, e ndërlikuar, apo e paqartë. Përkundrazi, ky term trajton një nga çështjet më të qarta të Kuranit. Por sot edhe myslimanët bëjnë kujdes në përdorimin e këtij termi, sepse përreth këtij termi është krijuar një botëkuptim negativ. Tashmë, fjala “xhihad”, të sjell në mendje bombat, kufomat dhe masakrimin e njerëzve të pafajshëm. Për fat të keq, sot po përballemi me një gjendje të tillë, ku ana e ndritshme e fjalës xhihad, që shpreh sakrificën në rrugën e Allahut, po njolloset vazhdimisht. Bota e shëmtuar e injorancës, egoizmit, fanatizmit dhe dhunës janë përzierë keq me këtë fjalë. Me këtë fjalë po shprehet edhe lufta me armë e myslimanëve kundër njëri-tjetrit. Dhe kjo tregon një devijim total të këtij termi nga përdorimi i vërtetë në literaturën islame. Për fat të keq, edhe kjo fjalë është prekur shumë nga dhuna midis myslimanëve.

Perëndimi gjithmonë e ka treguar Islamit si “feja e shpatës” dhe prej shekujsh vazhdon ta përpunojë këtë temë. Ndërsa sot, si vazhdim i saj, po përdoret islamofobia. Po ashtu, edhe disa organizata dhe grupe janë duke i mbështetur këto me anë të qëndrimeve të tyre të pabesueshme. Mirëpo Allahu i madhëruar që ka dërguar këtë fe, na e prezanton veten si Mëshirues të pakufishëm. Po ashtu, edhe cilësia më e spikatur e Fjalës së Tij, Kuranit, është mëshira dhe shërimi. Në mënyrë të natyrshme, edhe i Dërguari i Tij nuk mund të jetë i privuar nga këto cilësi. Për rrjedhojë, Ai na bën të ditur se si Profeti i Tij është dërguar si mëshirë për botët. Prandaj, përmendja e Islamit bashkë me “frikën”, “dhunën” dhe “terrorin”, është shpifja më e madhe që mund


t’i bëhet kësaj feje.

Çfarë lidhjeje mund të ketë me xhihadin hedhja e bombave mbi njerëzit e pafajshëm dhe masakrimi i tyre në mënyrë çnjerëzore? Në fakt, a nuk është xhihad shkaku i prezantimit të njerëzve me mëshirën dhe bukurinë e Islamit? Mirëpo, këto ndodhi të dhimbshme që po përjetohen, jo vetëm që nuk bëhen shkaku që njerëzit të njihen me Islamit, por ata i largojnë ata prej tij.

Xhihad është mënyra e ndërtimit të urave midis Islamit dhe njerëzve. Mirëpo, ndodhitë që të copëtojnë zemrën, u vënë zjarrin dhe i shkatërrojnë këto ura. Xhihad është mënyra e hapjes së zemrave të etura për të vërtetën ndaj fesë së mëshirës. Gjithashtu, xhihad është ngritje e emrit Allah dhe të fesë së Tij. Mirëpo këto zhvillime negative po bëhen shkaku që Islami të humbasë reputacionin në syrin e njerëzimit.

Xhihad është si lokomotiva e Islamit, sepse kjo fe në sajë të xhihadit ka arritur përtej shekujve dhe kontinenteve. Për këtë arsye, edhe marshimi i saj drejt së ardhmes do të jetë e mundur me xhihadin. Nëse do të kemi ndonjë gjë për t’u thënë brezave të ardhshëm, kjo do të jetë e mundur në sajë të xhihadit. Për rrjedhojë, lënia mënjanë e xhihadit, do të thotë t’i krasitësh krahët Islamit. Gjithashtu, kjo do të thotë që myslimanët të presin degën mbi të cilën qëndrojnë dhe të shkatërrojnë shpirtin dhe dinamizmin që i bën të ekzistojnë.

Sahabët fisnikë, për shkak se e kuptuan drejt shpirtin e xhihadit, u derdhën udhëve dhe shëtitën vend më vend, e kontinent më kontinent. Edhe myslimanët e mëvonshëm shkuan gjurmëve të tyre. Dhe si rezultat, Islami arriti në Azi, Afrikë, Lindjen e Largët dhe zona të tjera. Me miliona njerëz u udhëzuan dhe përvetësuan rrugën e virtytshme të



Islamit. Teuhidi u bë feja kryesore e vendeve Islame për shekuj me radhë. Në to nuk u adhuruan as idhujt dhe as njerëzit. Njerëzit shpëtuan prej nënshtrimit ndaj tiranëve dhe zullumqarëve. Ndërsa të vërtetën, drejtësinë dhe virtytin i konsideruan si synimet e jetës së tyre. Ja pra, të gjitha këto ndodhën në sajë të xhihadit, synimi i të cilit është mbajtja lart e së vërtetës dhe përpjekja për ta bërë atë mbizotëruese. Për këtë ka mënyra të ndryshme. Por, pikësëpari duhet theksuar se xhihadi nuk përbëhet vetëm nga lufta.

Nëse trajtohet bashkë me ajetet dhe hadithet përkatëse, shihet qartë se ky term ka një përmbajtje të gjerë, si luftën me veten, adhurimin e Allahut, predikimin e Islamit dhe përpjekjen për zbatimin e tij. E thënë ndryshe, ky term shpreh përpjekjen në rrugën e Allahut me çdo mjet që nxjerr në pah aktiviteti njerëzor si zemra, gjuha dhe dora.

Islami dëshiron që kauzën e së vërtetës ta realizojë me rrugën e paqes. Prandaj ai nuk u hap luftë kombeve të tjera për shkak të dallimeve fetare. Mirëpo, edhe lufta nuk ka munguar asnjëherë mbi faqen e tokës. Po ashtu edhe armiqtë e luftës për të vërtetën dhe të drejtën kanë ekzistuar gjithmonë. Për rrjedhojë, Islami e ka konsideruar luftën si një gjendje të përkohshme. Nëse myslimanët sulmohen atëherë mund të bëhet fjalë për luftë. Madje në këtë rast, për ta është e detyruar të mbrojnë veten, fenë dhe atdheun e tyre.

Synimi i xhihadit është përcimi i Islamit tek popujt që nuk janë njohur ende me Islamin. Mirëpo, këtu nuk bëhet fjalë për presion. Kështu e kanë kuptuar dhe zbatuar fenë myslimanët gjatë gjithë historisë, sepse feja mund të pranohet vetëm me dëshirën dhe vullnetin personal të njeriut. Ndërsa pranimi i fesë nën presion, lind vetëm hipokrizi dhe nuk e bën njeriun besimtar.

Në lidhje me luftën, Islami ka vendosur rregulla

të rëndësishme, të cilat quhen morali i luftës. Për rrjedhojë, kuptimi i luftës në Islam, nuk është lejimi i gjithçkaje në lidhje me armikun, vrasja, djegia dhe shkatërrimi i çdo gjëje që të zë syri. Në luftë nuk lejohet teprimi. Ajo nuk vazhdohet nëse pala tjetër e lë atë. Po ashtu nuk lejohet as prishja e marrëveshjeve që bëhen me armiqtë.

Në shekujt e shkuar, fuqia ekonomike në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe triumfi në luftë, kanë qenë arsye epërsie. Mirëpo në ditët tona, përveç fuqisë ekonomike ka marrë një rëndësi të madhe edhe fuqia në fushën kulturore. Shoqëritë që përparojnë në fushat e shkencës, kulturës, artit, arsimit dhe medias, sigurojnë një epërsi të rëndësishme.

Shoqëritë po godasin njëra-tjetrën me anë të mediave dhe në këtë mënyrë po shkatërrojnë strukturat kulturore dhe dinamikat e tyre shpirtërore. Për rrjedhojë, xhihadi i ditëve tona, duhet të marrë përparësi në fushat shkencore dhe kulturore.

Shekullin e shkuar myslimanët kanë luftuar me vetëmohim për të pastruar tokat e tyre prej armiqve, duke përjetuar një nga periudhat më të dhimbshme dhe të vuajtura të historisë së tyre. Si përfundim, myslimanët arritën t'i shpëtonin tokat e tyre prej armiqve, por e njëjta gjë nuk mund të thuhet edhe për pushtimin kulturor që pësuan më pas. Për myslimanët, pushtimi kulturor është po aq i rrezikshëm sa edhe pushtimi i tokave të tyre. Për rrjedhojë, sot për sot detyra më e rëndësishme e myslimanëve është ruajtja e brezave nga zhytja në batakun e gjynaheve. Pra, në këtë aspekt duhet vlerësuar edhe xhihadi që duhet të bëjnë myslimanët në këtë periudhë.



Xhundub bin Abdullahu (r.a.), transmeton se Profeti (a.s.), ka thënë::

“Kush bën një mirësi që të dëgjohej,
Allahu bën që të dëgjohej (qëllimi i tij). Kush bën mirësi për t’u dukur,
edhe Allahu e bën të duket (hipokrizinë e tij).”

(Muslim, Zuhd, 48)

SËMUNDJA E HIPOKRIZISË

Të pëlqehesh, të admirohesh, të lavdërohesh, të tregohesh me gisht, të dukesh, e të njihesh...

Pak a shumë, si njerëz që jemi, të gjithë kemi ndjenja të tilla në një qoshe të zemrës. Dikush shfaq sjellje që me të vërtetë janë për t’u admiruar dhe, edhe pse nuk dëshiron të dalë në plan të parë në këtë aspekt, veprat e tij e bëjnë atë të dukshëm. E megjithatë, ai nuk e braktis modestinë. Por ka edhe nga ata që megjithëse nuk e kanë zakon, shfaqin sjellje që priten me admirim në sytë e të tjerëve vetëm e vetëm për të kënaqur dëshirën e tij për t’u pëlqyer nga të tjerët. Kur e kupton se duket, njihet dhe flitet mes njerëzve, ai ndjen një kënaqësi të madhe prej kësaj. Duke menduar se i mahnit të gjithë me bindjen e tij, ai mrekullohet edhe më tepër me veten. Ai vazhdon të mashtrorë njerëzit përreth pa e menduar aspak se mund të vijë një ditë kur e vërteta të dalë në shesh dhe ai do të ndihet shumë i penduar për këtë. Mirëpo, ai është një njeri i mjerë që nuk e kupton se sado që ai të vazhdojë të luajë rolin e tij duke menduar se i ka mashtruar të tjerët, në fakt ai që prej fillimit është duke mashtruar vetëm veten e tij.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush bën një mirësi që të dëgjohej, Allahu bën që të dëgjohej (qëllimi i tij). Kush bën mirësi për t’u dukur, edhe Allahu e bën të duket (hipokrizia e tij)”

Ky është një hadith që na paralajmëron të gjithëve ndaj sëmundjes tinëzare të hipokrizisë që e bren njeriun nga brenda. Një njeri me sëmundje të tillë, dëshiron që të tjerët të mos e mashtrorë, ndërkohë që ai vet pandeh se u ka hedhur hi syve të tyre. Mirëpo, herët a vonë, në këtë botë ose në botën tjetër, Allahu i Madhëruar, i Cili e di mirë çfarë ndodhet

në zemra, do ta nxjerrë në shesh qëllimin e vërtetë të hipokritit. Veprat që nuk synojnë kënaqësinë e Allahut e që bëhen pa sinjeritet, nuk do të kenë asnjë vlerë tek Allahu. Në Ditën e Gjykimit, ku do të jepen shpërblimet për veprat, Allahu do t’i drejtohet hipokritit me këto fjalë: “Shkoni tek ata, para të cilëve dëshironit të dukeshit në dynja! Të shohim a do të keni ndonjë dobi prej tyre?” (Ibn Hanbel, V, 429.)

Ndërsa në një hadith tjetër ku tregohet shembulli i tre robërve që do të gjykohen në Ditën e Kiametit, Profeti ynë (a.s.), na bën të ditur në mënyrë konkrete dështimin që do të pësojnë ata njerëz kur t’u dalin në shesh qëllimet e vërteta të veprave të tyre: Në fillim, para Zotit sillet një person që mendohet të ketë rënë dëshmor në rrugë të Tij. Aty i numërohen të gjitha mirësitë që i janë dhënë dhe ai i kujton. Më pas, Allahu e pyet se çfarë ka bërë në këmbim të këtyre mirësive? Ndërsa ai përgjigjet duke thënë, “kam luftuar në rrugën Tënde derisa kam rënë dëshmor”. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, i Cili i e njeh mirë qëllimin e tij të vërtetë, thotë: “Ti gënjen! Ti ke luftuar që të tjerët të thonë «sa trim është». E në fakt, kjo është thënë”. Pas kësaj, ky njeri tërhiqet zvarrë dhe hidhet në Xhehenem.

I dyti sillet një person që ka marrë e ka dhënë shumë dije dhe ka lexuar shumë bukur Kuran. Ai pyetet se çfarë ka bërë në këmbim të mirësive që i janë dhënë. Ai thotë se u ka dhënë të tjerëve prej dijes që ka marrë dhe ka lexuar Kuran për hir të Allahut. Mirëpo, Allahu i thotë se po gënjen dhe se të gjitha këto i ka bërë që t’i thonë “dijetar” dhe “lexues i mirë i Kuranit”. Pastaj duke ia përplasur të gjitha në fytyrë, e hedh edhe këtë në Xhehenem. Në fund, para Allahut sillet një person që ka qenë i pasur dhe ka dhënë me bollëk prej çdo malli që



i ka dhënë Allahu. Kur pyetet se çfarë ka bërë në këmbim të të gjitha këtyre mirësive, ai thotë, “unë e kam shpenzuar pasurinë time në rrugën Tënde, ashtu siç ke dëshiruar Ti”. Mirëpo, Allahu, i Cili e di mirë edhe qëllimin e këtij, i thotë, “ti po gënjen, sepse të gjitha këto i ke bërë që të thonë se je «bujar». E në fakt ia ke arritur qëllimit”. Edhe ky njeri kapet e hidhet zvarrë në Xhehenem. (shih. Muslim, Imare, 152.)

Krijuesi i Madhëruar, e ka bërë njeriun krijesën më të çmuar, ka vënë në shërbim të tij çdo gjë në tokë e në qiell dhe e ka vendosur atë halife/mëkëmbësin e vet në tokë. Dhe në këmbim të të gjitha këtyre mirësive, Ai ka kërkuar vetëm një gjë prej tij: “Të adhurojë Atë (Allahun), duke ia kushtuar fenë vetëm Atij”. E në këtë çështje, Ai nuk toleron asnjë grimcë që t’i bëhet shirk/shok.

Nëse qasja ndaj fenomenit të hipokrizisë bëhet në këtë pikëpamje, nuk është e vështirë të kuptohet se në çfarë rreziku të madh ndodhet njeriu. Për rrjedhojë, njeriu hipokrit që mendon të fitojë pëlqimin e njerëzve, në vend që të fitojë kënaqësinë e Allahut për çdo adhurim apo mirësi që bën, pa e kuptuar fare përzihet në shirk. Për këtë arsye, Profeti ynë (a.s.), duke dhënë shembull njeriun i cili e zbukuron namazin që ta shikojnë të tjerët, hipokrizinë dhe syfaqësinë e ka cilësuar “shirk të fshehtë”.

Mirëpo, qëndrimi i Allahut ndaj robit që bën shirk, është shumë i qartë: “Unë jam larg (më i Larti) prej çdo gjëje që më bëhet shirk (më shoqërohet). Kushdo që bën një vepër dhe bashkë me Mua bën ortak dikë tjetër në atë (vepër), unë do ta lë vetëm për vetëm me shirkun e tij.” (Muslim, Zuhd, 46.)

Hipokrizia është një sjellje që nuk mund të përputhet kurrë me besimin. Njeriu që beson, duhet të jetë i sinqertë dhe i drejtë si në marrëdhëniet me Allahun, ashtu edhe në marrëdhëniet me njerëzit. Përndryshe, ai përballet me rrezikun e ngjasimit me hipokritët. Në Kuranin Fisnik, hipokritët qortohen në mënyrë serioze për shkak se ata i kryejnë vetëm për t’u dukur adhurimet si namazin, zekatin dhe sadakanë. Për shkak se e shpenzojnë pasurinë e tyre larg sinqeritetit dhe vetëm sa për t’u dukur, ata krahasohen me një shkëmb mbi të cilin ndodhet pak dhe, por që mbetet i zhveshur menjëherë pas një shiu të madh.

Me qëllim që të mos i ngjajmë hipokritëve që e kanë ndërtuar pothuajse të gjithë jetën e tyre mbi dyfytirësinë dhe syfaqësinë dhe të mos biem në kurthin e shirkut, ne duhet të kërkojmë vetëm kënaqësinë e Allahut në çdo punë që bëjmë. Bërja e punëve vetëm për hir të Allahut, e ruan zemrën nga ndjenja e mashtrimit dhe hiles. Gjithmonë duhet vepruar me ndjenjën e mirësisë dhe nuk duhet harruar se Allahu i Madhëruar na sheh dhe është në çdo moment bashkë me ne.

Në fakt, kë mashtrojmë duke treguar hipokrizi? Këtë pyetje duhet ta mendojmë vazhdimisht dhe, për t’u ruajtur nga kjo sëmundje që e kaplon tinëzisht zemrën duhet të strehohemi tek Zoti ynë i Madhëruar me këtë dua të Profetit tonë të dashur (a.s.): “O Allah! Strehohem tek Ty prej varfërisë, mohimit, shirkut, dyfytirësisë dhe prej veprës që bëhet për sy e faqe!” (Ibn, Hibban, Sahih, III, 300.)



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A X V I -

SHFAQJA E ALLAHUT TË MADHËRUAR

Pas zbritjes së banorëve të qiellit në tokë, do të shfaqet edhe Allahu i Madhëruar. Në atë moment, të gjithë popujt dhe melekët do të jenë të rreshtuar radhë-radhë. Në Kuranin fisnik lajmëron:

“E ç’presin tjetër ata, që t’u vijë Allahu përmes hijeve të reve bashkë me melekët?! Atëherë merr fund puna! Tek Allahu kthehen të gjitha punët.” (Bekare, 210.)

“Dhe Toka do të shndrisë me dritën e Zotit të vet dhe do të vendoset Libri (i veprave). Pastaj do të sillen profetët dhe dëshmitarët, e ata do të gjykojnë me drejtësi, e nuk do t’u bëhet asnjë padrejtësi.” (Zumer, 69.)

Ndërsa në një ajet tjetër fisnik, na përshkruhet një skenë prej asaj dite të vështirë e të tmerrshme - ditës së Kiametit:

“Por ani! Kur Toka të bëhet copë e thërrime, kur të vijë Zoti yt (për të ndarë gjykimin) me melekët të rreshtuar radhë-radhë.” (Fexhr, 21-22.)

Nga një hadith fisnik, bëhet e ditur se kur të shfaqet Allahu i Madhëruar, njerëzit nuk do ta përballojnë dot madhësitinë dhe fuqinë e Tij dhe do t’u bjerë të fikët. I pari që do të vijë në vete, është Profeti ynë (a.s.).²

Abdullah ibn Omer (r.a.), tregon:

“Një ditë, e pashë të Dërguarin e Allahut, (a.s.) në minber tek thoshte:

«Allahu -Azze ue Xhelle- do t’i palosë e do t’i mbledhë qiejt dhe tokat, do t’i marrë në dy duart e Tij dhe do të urdhërojë:

“Unë jam Allahu! Unë jam Sunduesi! Ku janë sunduesit e tokës? Ku janë të fuqishmit (tiranët), ku janë mendjemëdhenjtë?!”»

1. Në këtë ajet aludohet në ardhjen e Allahut të Madhëruar në vendin e Mahsherit në një mënyrë të panjohur për ne, ku do të shfaqet ashtu si dëshiron Ai dhe do të fillojë të marrë në llogari robërit e Tij. Ndërsa disa dijetarë, mendojnë se ky ajet duhet të kuptohet si “ardhje e urdhrit të Allahut dhe dënimit të Tij”.

2. shih. Buhari, Husumat, 1.

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut thoshte këto fjale, mbledhte dhe hapte gishtat e tij të bekuar. Atë moment vura re se minberi po lëkundej me themel. Aq, sa fillova të shqetësohem duke menduar, «se mos përmbysset minberi dhe rrëzon Profetin (a.s.)?!» (shih. Muslim, Munafikin, 23-26.)

Në një ajet fisnik, sqarohet se atë ditë njerëzit do të dalin në audiencën hyjnore duke u vendosur në rreshta:

“Ata do të sillen të radhitur para Zotit tënd (e do t’u thuhet):

«Tashmë Na erdhët, ashtu siç ju krijuam herën e parë, ndonëse ju (o jobesimtarë) pretendonit se nuk do t’ju caktonim një takim (ringjalljen).» (Kehf, 48.)

Në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar shpreh edhe indiferencën e madhe të robërve në jetën e kësaj bote, në lidhje me faktin se një ditë do të kthehen e do të dalin përsëri para Tij. Mirëpo, për shkak se çdo gjë atëherë do të ketë mbaruar, pendimi i tyre në atë vend nuk do t’u bëjë asnjë dobi.

ATA QË DO TË HYJNË NË XHENET PA DHËNË LLOGARI

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në një hadith fisnik na ka lajmëruar se disa njerëz do të hyjnë në Xhenet pa përjetuar vuajtjet e llogarisë:

“Zoti im më ka premtuar se do të vendosë në Xhenet shtatëdhjetëmijë persona nga ummeti im, pa i llogaritur dhe pa i dënuar. Në të njëjtën kohë, Ai më ka premtuar se për çdo njëmijë persona, do të hyjnë në Xhenet shtatëdhjetëmijë të tjerë dhe tre grushte të mbushur plot prej grushteve të Zotit tim³.” (Tirmidhi, Kiamet, 12/2437; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 34; Ahmed, V, 250.)

Ndërsa në një hadith tjetër, i dërguari i Allahut, (a.s.), na bën të ditur shpërblimin e madh që ka detyra e ruajtjes së kufirit në mbrojtje të atdheut

3. Kjo shprehje, -Allahu e di më mirë- mund të jetë përdorur në mënyrë metaforike për të shprehur një sasi të madhe.



dhe mirësitë që do të arrijë ai person që bie dëshmor në krye të kësaj detyre:

“Të bësh roje në kufi një ditë e një natë, është më e dobishme se një muaj i kaluar ditën me agjërim dhe natën me adhurim. Nëse personi vdes gjatë shërbitit të rojës, sevapi dhe shpërblimi i punës që ishte duke bërë, vazhdon gjer në Kiamet. Po ashtu, atij i vazhdon edhe furnizimi si dëshmor (në Xhenet), ndërsa në varr është i sigurt nga pyetjet e melekëve që kërkojnë llogari!” (Muslim, Imare, 163.)⁴

Njëherë, një sahab i nderuar pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Përse besimtarët sprovohen me pyetjet e melekëve në varr, ndërkohë për dëshmorin/shehidin bëhet përjashtim?”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), iu përgjigj kështu:

“Sepse atij i mjafton si sprovë shkëlqimi i shpatës mbi kokë!” (Nesai, Xhenaitz, 112/2051.)

Kjo do të thotë se qëndrimi i tij përballë shpatave dhe mos hezitimi i tij në sakrifikimin e jetës në rrugë të Allahut, mjafton si provë e besimit të tij dhe nuk ka më nevojë për ndonjë sprovë apo llogari tjetër. Ndërsa besimtarët që nuk vdesin si dëshmorë, duhet të kalojnë nëpërmjet një sprove besimi.

Përveç kësaj, kushti më i rëndësishëm i statusit të dëshmorit tek Allahu i Madhëruar, është “sinqeriteti”. Pra, statusi i dëshmorit bëhet vizë e hyrjes në Xhenet pa u marrë në llogari, vetëm nëse ai bëhet posaçërisht për hir të Allahut dhe pa prituri shpërblim nga askush tjetër. Nisur nga kjo, dëshmorë mund të quhen vetëm ata që përpiqen për një qëllim të lartë, siç është përhapja e fesë së Allahut dhe mos përdhosja e saj dhe simboleve të saj nën këmbët e armiqve, në tokën e atdheut ku feja e Allahut jetohet e lirë. Përndryshe, ata që vdesin duke u përpjekur për përfitime të kësaj

bote si pasuri, pronë, famë apo nder, nuk mund të quhen dëshmorë.⁵

Domethënë, dëshmorët që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari, janë besimtarët e sinqertë që presin shpërblimet e tyre vetëm prej Allahut të Madhëruar, e jo ata që presin lavdërime dhe përfitime prej njerëzve në këtë botë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka lajmëruar:

“Kur njerëzit do të qëndrojnë për të dhënë llogari, do të vërehet një grup me shpata të vendosura në qafë dhe me plagë që u rrjedhin gjak, të cilët do të jenë të mblidhur para derës së Xhenetit. Do të pyetet:

«Kush janë këta?»

Do t’u thuhet:

«Këta janë dëshmorë. Në fakt ata nuk kishin vdekur, ishin të gjallë dhe furnizohehin nga Allahu!»

Më pas, një thirrës do të lajmërojë:

«Ata, shpërblimi i të cilëve i takon Allahut, të ngrihen e të futen në Xhenet!»

Ai do ta përsërisë këtë për herë të dytë:

«Ata, shpërblimi i të cilëve i takon Allahut, të ngrihen e të futen në Xhenet!»

Njerëzit do të pyesin:

«Kush janë ata, shpërblimi i të cilëve i takon Allahut?» Do t’u thuhet:

«Ata që i falnin njerëzit!»


Më pas, thirrësi do lajmërojë për herë të tretë:

«Ata, shpërblimi i të cilëve i takon Allahut, të ngrihen e të futen në Xhenet!»

Pas kësaj, do të ngrihen kaq mijë vetë dhe do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari.” (Taberani, Eusat, II, 285; Hejthemi, X, 411.)

Ndërsa Allahu i Madhëruar, lidhur me këta njerëz, shprehet kështu në Kuranin Fisnik:

“Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi



**“Zoti im më ka
premtuar se do të vendosë
në Xhenet shtatëdhjetë mijë
persona nga ummeti im, pa
i llogaritur dhe pa i dënuar.
Në të njëjtën kohë, Ai më
ka premtuar se për çdo
një mijë persona, do të hyjnë
në Xhenet shtatëdhjetë mijë
të tjerë dhe tre grushte të
mbushur plot prej grushteve
të Zotit tim.”**

4. shih. Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 2; Nesai, Xhihad, 39; Ibn-i Maxhe, Xhihad, 7.

5. shih. Muslim, Imare, 152.

i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët.
(Shura, 40.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Mua m’u treguan të gjithë popujt. Një profet filloi të kalonte pranë meje dhe kishte me vete një popull. Kaloi një profet tjetër që kishte vetëm një grup. Kaloi një profet që kishte vetëm dhjetë veta. Kaloi një profet tjetër që kishte pesë veta. Kaloi edhe një profet tjetër, por i vetmuar. Më pas, vura re një turmë të madhe... dhe pyeta:

«O Xhibril! Ky është ummeti im?»

Ai tha:

«Jo, por shiko horizontin!»

Kur pashë atje, vura re një turmë shumë të madhe. Më pas, Xhibrili (a.s.) tha:

«Ja, ai është ummeti yt! Ndërsa për ata shtatëdhjetë mijë persona që ndodhen në krye të tyre, nuk do të ketë as llogari, e as dënim!»

«Përse?» -pyeta unë. Xhibrili (a.s.), u përgjigj:

«Sepse ata;

- Nuk janë përpjekur të kurohen duke u damkosur me zjarr,

- Nuk kanë kërkuar prej askujt që t’u bëjë rukje (për t’i shëruar),⁶

- Ata mbështeten vetëm tek Zoti i tyre!»

Kur Profeti ynë (a.s.) tha këto fjalë, Ukkashe ibn Mih-san (r.a.) u ngrit menjëherë në këmbë dhe tha:

“ (O i Dërguar i Allahut) Lutju Allahut që të më bëjë prej tyre!” I Dërguari i Allahut (a.s.) u lut duke thënë:

“O Allah! Bëje këtë person prej tyre!” Më pas, një

6. Rukja, pra, kërkimi prej Allahut të Madhëruar që t’i japë shërim të sëmurit me anë të disa shprehjeve që gjenden në Kuran dhe në hadithe, është e lejuar. Lidhur me këtë, ekzistojnë edhe transmetime që tregojnë se Profeti (a.s.), e ka praktikuar personalisht. Ndërsa dënosa që bëhet në këtë hadith ndaj atyre që kërkojnë t’u bëhet rukje, është për shkak se ata e bëjnë këtë punë duke mos e pritur shërimin dhe dobinë prej Allahut, por prej krijesave, gjë e cila është në kundërshtim me parimin e mbështetjes vetëm në Allahun e Madhëruar. Njësoj si ai që e konsideron shërimin prej ilaçit dhe doktorit, e jo prej Allahut. E në fakt, njeriu kurohet në saje të mundësive që i ka dhënë Allahu. Prandaj, ai nuk duhet t’ia atribuojë kurrë shërimin krijesave të përkohshme, por Allahut të Madhëruar. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik, Ibrahim (a.s.) thotë: **“(Ai) i Cili, kur sëmurem, më shëron.”** (Shu’ara, 80.)

Domethënë, edhe nëse njeriu kapet pas shkaqeve, ai duhet të besojë me gjithë zemër se shërimi në kuptimin e vërtetë vjen vetëm prej Allahut të Madhëruar, se vetëm Atij duhet t’i besojë, se duhet të jetë i kënaqur me caktimin e Tij dhe se duhet të bëjë durim përndajdo gjëje që e godet.

sahab tjetër u ngrit dhe tha:

“Lutju Allahut të më bëjë edhe mua prej tyre!” Kësaj here, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Ukkashe ta kaloi në këtë çështje!” (Buhari, Rikak, 50; Muslim, Iman, 367-374.)

Ndërsa në një transmetim tjetër përdoret shprehja, *“ata nuk bënë dhe nuk lejonin të bëhej magji”.*⁷

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka lajmëruar edhe për besimtarët e tjerë që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari:

“Ditën e Kiametit, njerëzit do të mbledhen në një vend të sheshtë. Nëse u hedh shikimin, është e mundur t’i shohësh të gjithë, e nëse dikush thërret, mund t’ia dëgjojnë zërin të gjithë. Atë ditë, një thirrës do të thërrasë tre herë:

«Sot, të gjithë do ta marrin vesh se kush janë në të vërtetë njerëzit më të çmuar!»

Pastaj do të thotë:

«Ku janë ata që ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne?»⁸

Ku janë ata të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin e japin zekatin?»⁹

Më vonë, një thirrës do të lajmërojë përsëri:

«Sot, të gjithë do ta mësojnë se kush janë në të vërtetë njerëzit më të çmuar!»

Pastaj do të thotë:

«Ku janë Hammadun-ët, të cilët e falënderojnë shumë Zotin e tyre?» (Hakim, Mustedrek, II, 433/3508; Bejhaki, Shuab, IV, 539.)

Shkurtimisht, nën dritën e ajeteve dhe haditheve të mësipërme, mund të themi se njerëzit më fatlumë, të cilët do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari, janë besimtarët që:

- Mbështeten plotësisht tek Allahut i Madhëruar
- Nuk besojnë në ogurin e zi
- Nuk bëjnë dhe nuk lejojnë të bëhet magji
- Nuk damkosin me zjarr
- Bien dëshmorë

7. shih. Muslim, Iman, 374.

8. shih. Sexhde, 16.

9. shih. Nur, 37.

- Falin njerëzit
- Ngrihen në namazin e natës ¹⁰
- Dhurojnë me sinqeritet për hir të Allahut
- Përmendin shumë Allahun, e falenderojnë vazhdimisht Atë dhe për këtë arsye shpërblimi i tyre i takon Allahut.

ATA QË DO TË HYJNË NË XHEHENEM PA DHËNË LLOGARI

Përveç atyre që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari, si manifestim i faljes dhe mëshirës hyjnore të Allahut të Madhëruar, do të ketë edhe prej atyre që do të hidhen në Xhehenem pa pasur fare nevojë të merren në llogari. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është shprehur:

“Ditën e Kiametit, prej Xhehenemit do të dalë një qafë (copë zjarri), e cila do të ketë dy sy që shohin, dy veshë që dëgjojnë dhe një gjuhë që flet. Ajo do të thotë:

«Unë jam caktuar si kujdestare për tre persona (tre kategori njerëzish që do t'i djegë në zjarr):

Të gjithë zullumçarët inatçi e mizorë, ata që adhurojnë dikë tjetër së bashku me Allahun dhe ata që bëjnë portrete (pikturë/skulpturë).”¹¹ (Timidhi, Xhehenem, 1/2574; Ahmed, II, 336; Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 51/34141.)

Pasi thotë këto fjalë, copa e zjarrit që del prej Xhehenemit në formë qafe, i merr një nga një nga radhët, ashtu siç mbledh zogu kokrrat e susamit nga

10. Allahu i Madhëruar e urdhëron Profetin tonë (a.s.) të vazhdojë të ngrihet në namazet e natës dhe e përgëzon me lajmin se do ta ngrejë në pozitën e lartë të “Makam-i Mahmud”. (shih. Isra, 79.) Nisur nga kjo, mund të themi se nëse edhe besimtarët vazhdojnë të kryejnë namazet e natës, ata mund të arrijnë grada të larta shpirtërore. Për shkak se Zoti ynë dëshiron që robërit e Tij të përfitojnë sa më shumë prej kësaj mirësie, në shumë ajete fisnike, Ai nxit me këmbëngulje namazin e natës:

“...që kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit.” (Al-i Imran, 17.)

“Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).” (Dharijat, 17-18.)

“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?!..” (Zumer, 9.)

“Dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë” (Furkan, 64.)

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.” (Sexhde, 16.)

11. Juristët dhe mufesirët Islam janë të mendimit se “pikturimi i krij - save jo të gjalla dhe bimëve si peizazhet, malet, pemët, pyjet, etj., janë të lejuara në Islam”. Në disa hadithe fisnike, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka bërë të ndaluar pikturimin e gjërave të gjalla, sepse respekti i tepruar që tregohet ndaj pikturave dhe skulpturave, i ka çuar njerëzit në idhujtari. Ajo që konsiderohet e ndaluar në këtë hadith, është piktura, skulptura dhe basorelievi i krijesave të gjalla, të cilat bëhen me dorë, sepse kjo shpreh tentativën për të ngjarë me artin e krijimit të Allahut të Madhëruar. Ndërsa fotografia, përbën përjashtim, për shkak se ajo është vetëm pasqyrimi i diçkaje që ekziston. Po ashtu, edhe veshja apo zbukurimi i mureve me copa të pikturuara në këtë mënyrë, është i ndaluar. Hanefitë nuk e kanë konsideruar si mekruh (të papëlqyeshme) shtrimin e copave të pikturuara, në tokë apo në vende që përdoren për t'u ulur. Kjo, sepse e rëndësishme në këtë pikë, është fakti i respektimit apo jo i pikturës. Ndërsa pikturat dhe skulpturat e gjallesave që varen në mur, ose mbahen në vende të larta, i kanë konsideruar mekruh në mënyrë unanime.

toka, dhe i hedh në Xhehenem. (Ibnu'l-Mubarek, ez-Zuhd, II, 101.)

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Veçohuni sot ju, o kriminelë!” (JaSin, 59.)

Fjala “muxhrimun” që përdoret në këtë ajet, përmbledh mendjemëdhenjtë, mohuesit e Allahut, hipokritët dhe idhujtarët. Dhe pikërisht këto katër kategori, janë ata që do të hidhen në Xhehenem, pa pasur nevojë të merren në llogari.

Lidhur me këtë ajet fisnik, Ismail Hakki Bursevi, jep këtë shpjegim:

“Allahu i Madhëruar bën të ditur se Ai patjetër që do t'i ndajë besimtarët nga mohuesit, duke i ringjallur besimtarët me fytyrë të ndritur, ndërsa mohuesit me fytyrë të nxirë; duke ua dhënë besimtarëve librin e punës nga e djathta, ndërsa mohuesve nga e majta; duke e rënduar peshoren e sevapeve të besimtarit, ndërkohë që do ta lehtësojë atë të mohuesit; duke e zhytur besimtarin në dritë, ndërsa mohuesin në errësirë; duke ia forcuar besimtarit këmbët në Urën e Sirati, ndërkohë që do t'ia rrëshqasë këmbët mohuesit; dhe shumë çështje tjera.” (Ruhu'l-Beyan, c. 16, sf. 383.)

Kjo e vërtetë, në një ajet tjetër shprehet kështu:

“E, atë ditë kur të arrijë Ora, ata (besimtarët dhe jobesimtarët) do të ndahen.” (Rum, 14.)

Ndërsa Hasan Basriu -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, (besimtarët dhe mohuesit) do të ndahen, edhe sikur të kenë qenë bashkë në dynja. Besimtarët do të jenë në “a'la-ji il-ljijn” (në lartësitë më të mëdha), ndërsa mohuesit do të jenë në “esfel-i safilin” (në vendin më të ulët). Një do të jetë në gradën e takimit, ndërsa tjetri në pikën e ndarjes. Ai që gjendet në gradën e takimit, do të qëndrojë në fronin e dashurisë, ndërsa ai që gjendet në pikën e ndarjes, do të qëndrojë në hasrën e hidhërimit dhe vuajtjes. Një popull do të jetë në lumturi e mirësi, ndërsa një popull tjetër do të tretet në zjarrin e ndarjes.” (Ruhu'l-Beyan, c. 15, sf. 35.)

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), na bën të ditur numrin e atyre që do të hidhen në Xhehenem:

“Njeriu i parë që do të thirret ditën e Kiametit, është Ademi (a.s.). Atij do t'i shfaqen pasardhësit dhe do të shohin njëri-tjetrin. Atyre do t'u thuhet:

«Ky është babai juaj Ademi!»

Ditën kur të thirret, Ademi (a.s.), do të thotë:

«Urdhëro, jam në urdhrat Tuaja! Të bindem me gjithë dëshirë o Zoti im!» Allahu i Madhëruar e urdhëron:

«Nxirr prej pasardhësve të tu, ata që do të shkojnë në Xhehenem!»

«O Zot! Sa do të nxjerr?» -thotë Ademi (a.s.). E, Allahu i Madhëruar përgjigjet:

«Nxirr nëntëdhjetë e nëntë për çdo njëqind vetë!» Sahabët të frikësuar jashtë mase, pyesin:

“O i Dërguari i Allahut! Nëse merren nëntëdhjetë e nëntë për çdo njëqind prej nesh, çfarë do të mbetet pas?!” Profeti ynë (a.s.), përgjigjet:

“Ummeti im do të jetë qimja e bardhë mbi kaun e zi, ndër të gjithë ummetet e tjera!” (Buhari, Rikak, 45.)

Po ashtu, në një hadith të ngjashëm, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u ka thënë kështu sahabëve:

“Allahu i Madhëruar do të thotë (Ditën e Kiametit):

«O Adem!» Ademi do të përgjigjet:

«Lebjeje ue Saadeje (Ja ku jam, të përgjigjem! E gjithë mirësia është në Dorën Tëndë!)» Allahu do t'i thotë:

«Nxirri mënjane njerëzit që do të hyjnë në Zjarr!» Ademi do të thotë:

«O Allah! Sa do të jenë njerëzit e Zjarrit?» Allahu do t'i thotë:

«Në çdo njëmijë vetë nxirr nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë (për t'i futur në Zjarr)!»

Atë moment fëmijët do të thinjen, çdo grua shtatzënë do ta dështojë barrën dhe do t'i shohësh njerëzit si të dehur, ndërkohë që nuk do të jenë të pirë, por, në të vërtetë, ndëshkimi i Allahut do të jetë i rreptë.”

Sahabët e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut, kush do të jetë ai «njëri» prej nesh (që do të shpëtojë nga Zjarri)?” Profeti (a.s.) iu tha:

“Gëzohuni për sihariqin! Një do të jetë prej jush dhe njëmijë do të jenë nga Je'xhuxh- Me'xhuxhët.”

Pastaj i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“(Betohem) për Atë, në Duart e të Cilit është jeta ime! Shpresoj shumë që ju të jeni çereku i banorëve të Xhenetit!”

Për këtë arsye, sahabët falënderuan Allahun dhe bënë tekbirë (Allahu Ekber). Më pas Profeti (a.s.) shtoi:

“Shpresoj shumë që ju të jeni gjysma e banorëve të Xhenetit.” Sahabët thirrën përsëri: «Allahu Ekber»

Pastaj Profeti (a.s.) tha:

“Ju (muslimanët në krahasim me popujt e tjerë) jeni si një qime e bardhë në lëkurën e një kau të zi...” (Buhari, Rikak, 46.)

HAPJA E LIBRIT TË VEPRAVE

Ditën e Kiametit do të hapen librat ku janë shkruar të gjitha veprat, të këqija apo të mira, që njerëzit kanë bërë në jetën e dynjasë dhe të gjithë do t'i

shikojnë qartë veprat e tyre. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Ditën, kur Ne do t'i thërrasim të gjithë popujt me prijësin (të dërguarin) e vet, ata, që do t'u jepet libri në anën e djathtë, do ta lexojnë librin e vet dhe nuk do të pësojnë as padrejtësinë më të vogël.” (Isra, 71.)

“Atëherë të gjithë popujt do t'i shohësh të gju-njësuar. Çdo popull do të thirret në Librin e vet (e do t'i thuhet): «Sot do të shpërbleheni për atë që keni bërë!»” (Xhathije, 28.)

“Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t'ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur. (Pastaj do t'u themi):” (Isra, 13.)

“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!” (Isra, 14.)

“Dhe Toka do të shndrisë me dritën e Zotit të vet dhe do të vendoset Libri (i veprave). Pastaj do të sillen profetët dhe dëshmitarët e ata do të gjykojnë me drejtësi, e nuk do t'u bëhet asnjë padrejtësi.” (Zumer, 69.)

Vetëm Allahu i Madhëruar e di natyrën e librit të veprave. Mirëpo, sipas asaj që na është bërë e ditur, ai është libri ku do të shënohet çdo gjë e madhe apo e vogël që ka vepruar njeriu, pa u anashkaluar qoftë edhe vepra më e imët. Lidhur me këtë, në Kuran sqarohet:

“Dhe Libri (i veprave të tyre) do t'u vihet përpara, e do t'i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë:

«Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë?»

Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.” (Kehf, 49.)

Siç vihet re në këtë ajet, njerëzit do të ankohen për shkak se do të shohin të shënuara edhe gjynahet që ata kanë menduar se kanë qenë të vogla.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili e ka ditur më së miri këtë të vërtetë, na ka paralajmëruar neve, si ummetin e tij, duke iu drejtuar nënës sonë Aisha (r.a.) :

“O Aishe! Ruhu prej veprave që nënvleftësohen (edhe prej gjynaheve më të vogla që nuk u jepet rëndësi)! Sepse tek Allahu është një (melek) që i vëzhgon dhe i shënon ato.” (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 29; Darimi, Rikak, 17; Ahmed, VI, 70, 151.)

Ndërsa në një hadith tjetër shprehet:

“Ruhuni prej gjynaheve që duken të vogla, sepse

ato mblidhen tek dikush dhe në fund e shkatërrojnë atë!” Pastaj, në lidhje me gjynahet e vogla ka dhënë një shembull:

Një grup njerëzish qëndrojnë për të pushuar në shkretëtirë. Në kohën e ushqimit, njëri shkon e sjell një degë të vogël peme, e një tjetër shkon e sjell një degë tjetër dhe kështu mbledhin një pirg të madh. Më pas i ndezin dhe gatujnë ushqimin.¹²

Domethënë, gjynahet që konsiderohen të vogla dhe nuk evitohen, me kalimin e kohës mblidhen dhe i dalin para njeriut si një dënim i madh. Për rrjedhojë, ajo që duhet të bëjë njeriu, është të ruhet me kujdes prej të gjitha gjynaheve, pa bërë dallim në madhësinë e tyre. Por, nëse nuk arrijmë të ruhem dhe biem në ndonjë gjynah, pa humbur kohë duhet të pendohemi tek Allahu i Madhëruar dhe t'i kërkojmë falje me lot në sy.

Ditën e Kiametit, ata, të cilëve u jepet libri i veprave nga e djathta, arrijnë lumturinë e përjetshme me një gëzim të papërshkrueshëm, ndërsa ata, të cilëve u jepet libri nga e majta apo nga mbrapa, do të ndjehen deri në palcë dhimbjen që u shkakton humbja e përjetshme. Në Kuranin Fisnik, gjendja e tyre përshkruhet në këtë mënyrë:

“Ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t'u thotë (njerëzve të tij): «Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i ibndur se do të jepja llogari.»

Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur, në një kopsht të lartë, frutat e të cilit do t'i kapë lehtë. (Njerëzve të tillë u thuhet:)

«Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara!»

Por ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë:

«Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time!» (Hakka, 19-26.)

“Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij. Kurse ai, të cilit do t'i jepet libri i tij pas shpinës, do të lutet për të

vdekur dhe në zjarr do të digjet, sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari).” (Inshikak, 7-14.)

Shkurtimisht, ata që mashtrohen prej tundimit të egos dhe shejtanit në këtë botë të përkohshme dhe lodrojnë në indiferencën e kënaqësive të ulëta, duke e pandehur mjerimin si lumturi, në Ahiret do të përpëliten mes frikës së tmerrshme dhe hidhërimi me të pafundme.

Përkundër kësaj, besimtarët që përpiqen të bëjnë një jetë të devotshme në këtë botë, pa ndaluar adhurimet gjatë gjithë jetës, ashtu siç e meriton të adhurohet Allahu i Madhëruar, në jetën e vërtetë që është Ahireti, do të arrijnë lumturinë dhe paqen e vërtetë.

Ditën e Kiametit, askush nuk do të mendojë për askënd në atë situatë të tmerrshme. Nëna jonë Aisha (r.a.) tregon:

“Një herë tek mendoja rreth Xhehenemit fillova të qaj. Kur Profeti (a.s.), më pa në këtë gjendje më pyeti:

«Aisha, çfarë ke?»

«Mu kujtua Xhehenemi dhe nisa të qajë. Ju profetëve, a do t'ju bjerë ndërmend për familjet tuaja ditën e Kiametit?» - iu përgjigja unë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), më dha këtë përgjigje:

«Janë tre momente kur njeriut nuk ka për t'i rënë ndërmend për askënd përveç vetes :

1. Kur të peshohen veprat dhe të jetë duke mësuar nëse peshorja do të jetë e rëndë me vepra, apo e lehtë!

2. Kur t'i jepet libri dhe t'i thuhet **“...Urdhëro dhe lexo librin!”**¹³, (sepse) ende nuk e di nga do t'i vijë ai: djathtas, majtas apo nga pas!

3. Dhe kur të vendoset Ura e Siratit mbi Xhehenem! Në të dy anët e kësaj ure do të ketë shumë kanxha dhe gjemba të fortë. Me ato kanxha, Allahu do të kapë kë të dëshirojë nga krijesat e Tij dhe do ta hedh në Xhehenem. Ja pra, derisa të mësojë nëse do të shpëtojë apo jo nga këto kanxha, njeriut nuk i bie ndërmend për askënd tjetër përveçse për veten e tij!» (Hakim, IV, 622/8722. Shih. Ahmed, VI, 101, 110.)

**“O Aishe!
Ruhu prej veprave
që nënvleftësohen
(edhe prej gjynaheve
më të vogla që nuk u jepet
rëndësi)! Sepse tek Allahu
është një (melek)
që i vëzhgon dhe
i shënon ato.”**



12. shih. Ahmed, I, 402-403; V, 331.

13. shih. Hakka, 19.

Frika ndaj Allahut

“FRIKA NDAJ ALLAHUT ËSHTË THELBI I URTËSISË.”

— Nurten Selma Çevikollu —

Allahu i Lartësuar, mëshira dhe drejtësia e të Cilit ka përfshirë të dy botët, i Cili e ka ndaluar njeriun që ta adhurojë e që t'i bëhet rob njeriut dhe i Cili i ka ndriçuar besimtarët me dritën e besimit dhe ibadetit, në Kuranin Famëlartë, të cilin na e ka dërguar si një mirësi hyjnore thotë:

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Al Imran, 102) Gjithashtu na urdhëron:

“O njerëz, frikësojuni Zotit tuaj, sepse dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe!” (Haxh, 1) Nga këto ajete fisnike kuptohet se Allahu i Madhëruar kërkon nga ne që të kemi frikë prej Tij.

Një gjë duhet ta dimë se jeta e besimit fillon me frikën ndaj Allahut, xhelle xhelaluhu. Rruga e fesë është rruga e atyre që kanë frikë nga Allahu, azze ve xhelle. Të fshehtat e jetës së ahiretit arrihen vetëm me frikën ndaj Allahut, xhelle xhelaluhu. Përderisa zemrat të mos mbushen me frikë ndaj Allahut Teala, jeta ngelet një vend në të cilin përjetohen halle dhe vështirësi të mëdha. Frika ndaj Allahut, xhelle xhelaluhu, e bën njeriun ta marrë në llogari veten, të llogarisë sjelljet e tij dhe t'i bëjë mirë llogaritjet

në lidhje me të dyja jetët. Sa ndjenjë sublime që është frika nga Allahu Teala dhe të kuptuarit se në çdo moment jemi nën kontrollin (vëzhgimin) e Atij në çdo aspekt të jetës sonë! Në një zemër e cila është e privuar nga kjo ndjenjë e lartë, padrejtësia zë vendin e mëshirës, urrejtja zë vendin e butësisë, mashtrimi zë vendin e ndershmërisë dhe armiqësia zë vendin e dashurisë. Për

shkak të kësaj ndodhin të gjitha ngjarjet negative, imorale dhe të tmerrshme, siç ndodhin edhe sot. Vetëdija e frikës ndaj Allahut Teala, i siguron njeriut disiplinën e tij të brendshme. Për të jetuar si një njeri i vërtetë në ditët e sotme, për të mos rënë në gabime dhe për të qëndruar gjithmonë te e vërteta, çdo njeri ka nevojë për këtë disiplinë të brendshme. Nisur nga fakti se çdo njeriu nuk mund t'i vendosim te koka një polic, në mënyrë që njerëzit të mos bien në gjëra të palejuara dhe që t'i bëjnë punët siç duhet, atëherë e kemi kusht që njerëzve t'ua japim patjetër “ndjenjën e frikës ndaj Allahut Teala”, e cila pothuajse kryen funksionin e policit vëzhgues të brendshëm.

Të jetuarit brenda kornizës së dispozitave që ka vendosur Allahu i Madhëruar në këtë botë, e shndërron jetën e besimtarit në parajsë që në këtë dynja. Faktori më influencues në një jetë të tillë është të jetuarit më vetëdijshëm e “frikës ndaj Allahut”. Njeriu që përgatitet për botën e përhershme është njeriu më fitimtar. Frika ndaj Allahut Teala është fitimi më i madh për atë që e kupton. Në jetën e ahiretit, e cila është një e vërtetë që nuk mund t'i mohohet ekzistenca, përsëri është ndjenja e “frikës ndaj Allahut” ajo që do t'i shpëtojë trupat nga djegia, ajo që do t'i bëjë lëkurat të padjegshme nga zjarri i xhehenemit, ajo që do t'i shpëtojë besimtarët dhe që do t'i bëjë miq të Allahut Teala në kopshtet e xhenetit. Allahu i Lartësuar e tregon në Kuranin Fisnik këtë të vërtetë, për të cilën folëm më lart, duke thënë:

“Për atë që i frikësohet paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte!” (Rahman, 46)

Të gjithë besimtarët e pjekur dhe të devotshëm duke filluar me në krye pejgamberët, përgjatë gjithë jetës së tyre janë dridhur nga frika ndaj Allahut Teala. Sahabi i nderuar, Abdullah bin Shihhiri (r.a.), thotë:

“Një ditë shkova te i Dërguari i Allahut (a.s.). Ai po falte namaz duke qarë aq shumë sa nga kraharori

i tij vinte një zë si i kazanit që valon.” (Përkthimi i Rijadu’s-Salihin, vëll. 1, fq. 486.)

Enesi, radijallahu anh, transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“O umeti i Muhamedit! Sikur t’i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë.” (Buhari, Muslim, Bejhaki, Muhtasar Shuabu’l-Iman, fq. 21.) Nisur nga kjo, sahabët e mbuluan fytyrën me duart e tyre dhe filluan të qanin me dënësë.

Një ditë, kur Umeri, radijallahu anh, po kalonte me devenë e tij pranë një çadre, u rrëzua nga deveja prej emocionit dhe frikës kur dëgjoi nga brenda dikë që po lexonte ajetet e ndëshkimit. Përsëri një ditë, kur i thanë:

“A nuk ke frikë nga Allahu, o Umer?”, menjëherë zbriti nga kafsha e tij, bëri sexhde duke e vënë fytyrën në tokë, ngjyra e fytyrës i ndryshoi, u zverdh dhe tha duke iu marrë zëri:

“Kush është Umeri që të mos ketë frikë nga Allahu?..”

Ja, kështu kanë qenë ata.

“Frika ndaj Allahut” ishte aq thellësisht prezente te i Dërguari i Allahut, alejhi’s-salatu ve’s-selam dhe te shokët e tij, sa që kishte prej atyre që nuk dilnin me ditë të tëra nga shtëpia e tyre dhe që qanin derisa u plasnin mushkëritë prej frikës nëse u shikonte syri ndonjë haram. Kjo çështje zgjaste derisa i Dërguari i Allahut (a.s.), të pyeste për atë dhe t’i tregonin për gjendjen. Sapo Pejgamberi (a.s.), ta dëgjonte këtë, pa humbur aspak kohë shkante dhe e vizitonte atë sahab që i digjej zemra. Ndërsa sahabi e përqaftonte të Dërguarin e Allahut, (a.s.) dhe jepte shpirt duke qarë nga frika prej Allahut Teala. Ja, kështu kishin frikë sahabët nga Allahu i Madhëruar.

Po, edhe nëse ne nuk bëhemi dot si ata, prapë se prapë do të kemi frikë dhe duhet të kemi frikë nga Allahu Teala.

Nëse nuk do të kemi frikë nga Ai, atëherë, nga kush do të kemi frikë?

Kush është më i madhi? Kush është më i lartësuar? Kush është më fisniku? Kush është poseduesi absolut i gjithësisë?

A nuk e jehon Atë, të Fuqishmin absolut, çdo përgjigje? Le ta dimë mirë se çdo derë të shpie tek Ai. Ai është vega më e fortë dhe litari i pakëputshëm. A nuk thotë Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik:

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë gremenës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.” (Al Imran, 103) Një

njeri që i frikësohet Allahut Teala, nuk ka frikë nga asgjë tjetër dhe nuk i bëhet rob rob. Ndërsa njeriu që nuk ka frikë siç duhet nga Allahu, ka frikë nga çdo gjë tjetër. Përveç të tjerash, ai që nuk ka frikë nga Allahu, i bën lehtë të gjitha veprat e shëmtuara, ligësitë dhe mëkatet. Për këtë arsye thuhet:

“Ki frikë nga ai që nuk ka frikë nga Allahu!” Sepse njerëzit e tillë mund t’i bëjnë lehtë të gjitha llojet e ligësive, ngaqë nuk njohin asnjë lloj rregulli. Andaj, Allahu na mbroftë prej të keqes së atyre dhe na mbajttë larg prej njerëzve të atillë!

Vallë çfarë mund të themi nëse na bëjnë këtë pyetje: “Si mund të kemi frikë ashtu siç duhet nga Allahu Teala?” Atëherë, le të gjejmë një përgjigje për këtë pyetje:

Për të pasur frikë nga Krijuesi ynë i Lartë, ashtu siç dëshiron Ai, para së gjithash duhet të njohim nefsin, domethënë, veten tonë, sepse njeriu, i cili formohet nga mishi dhe kockat, është nderuar me pozitën më të lartë prej të gjitha krijesave. Këtë pozitë më fisnike prej të gjitha krijesave e ka arritur në sajë të mendjes dhe logjikës. Kështu që, ai i cili ndodhet në këtë pozitë, sigurisht se nuk kaplohet nga dëshirat vetjake dhe nuk mashtrohet nga dredhitë e shejtanit aq sa u bindet urdhrave të edukuesit të tij, aq sa e njuh Zotin e tij dhe aq sa e do Atë.

Një kusht tjetër për të pasur frikë nga Allahu Teala është se ne duhet ta njohim Atë, Krijuesin e Lartë. Ne duhet ta njohim Allahun, azze ve xhelle, në mënyrë që ta kemi frikë siç e meriton dhe ta duam Atë. Njeriu e do atë që e njuh dhe nuk e do atë që nuk e njuh. Andaj duhet ta njohim Zotin (xh.sh.), në mënyrë që ta duam. Kur ta duam Atë, gjithmonë do të digjemi me dëshirën për ta kënaqur Atë dhe për t’i zbatuar të gjitha urdhrat e Tij. Nisur nga parimi: “Ai që do nuk e mërzi atë që e do, nuk e lëndon dhe bën çdo gjë që i thotë.”, edhe ne si robër do të bëjmë me këtë vetëdije çdo gjë që na thotë Zotëruesi i Vetëm i Gjithësisë, Zoti ynë (xh. sh.) dhe do të kemi frikë, do të hezitojmë dhe nuk do të tentojmë t’i bëjmë ato që na urdhëron të mos i bëjmë. Sigurisht se kjo frikë mund të jetë për veten tonë, por mund të jetë edhe për dikë tjetër. Kështu që le ta duam Atë, në mënyrë që ta kemi edhe frikë. Atë le ta duam më shumë se çdo gjë tjetër. Ai, Allahu Teala është krijuesi ynë. Atij i kemi borxh shumë gjëra. Dashuritë më të sinqerta i dedikohen Atij. A nuk është ajo dashuri që e bën çdo krijesë në kohën e seherit (agimit) që të jehojë me zërin: “Allah!.. Allah!..”

Në sajë të atij zëri këndojnë bilbilat dhe bletët bëjnë mjaltë në zgjoin e tyre. Përsëri ai zë i bën dallgët e detit të thonë me gjuhën e tyre: “Ja Xhelil!.. Ja Xhelil. Fryrja e erërave dhe reshjet e dëborës janë thirrjet e të njëjtit zë në këtë botë... Çdo gjë është e

dhënë pas dashurisë për Atë. Pastaj, kjo ndjenjë e thellë sjell frikësimin nga madhështia, sublimja dhe lartësia e ekzistuesit absolut. Frika që besimtari ka nga Allahu Teala është ajo ndjenja që e djeg dhe e përvëlton zemrën, në mënyrë që të mos bëjë diçka që nuk e do Ai.

Krahas të gjithave, frika ndaj Allahut të Lartësuar vjen nga dija, gjendja dhe veprat. Dijen këtu mund ta vlerësojmë si: “Të dish shkakun që të zvarrit për te gjëja që nuk e do.” Të diturit e shkaqeve të rrezikut që mund të ndodhë në të ardhmen, bëhet shkak që zemra të digjet dhe të brengoset. Ja pra, frika nga Allahu është një zjarr i tillë i brendshëm. Njerëzit nganjëherë kanë frikë nga Allahut i Lartësuar dhe nganjëherë kanë frikë nga mëkatet e tyre. Frika e të gjithëve mund të ndryshojë sipas asaj që kanë frikë. Për shembull, kur ndonjë besimtar ka frikë se mos prish pendimin që ka bërë, në mos nuk i zbaton siç duhet detyrat që ka ndaj Allahut të Madhëruar dhe në mos i nxihet e ngurtësohet zemra, dikush tjetër mund të frikësohet se mos bie pre e epsheve që ka pas ndjekur më parë, mund të frikësohet se mos bie në ndonjë gjendje të keqe në të ardhmen dhe në mos vdesë me ndonjë përfundim të keq, mund të frikësohet prej përcaktimit që i është shkruar në pafillimësi, mund të frikësohet në mos nuk do të falet për mëkatet që i ka bërë në të kaluarën apo mund të frikësohet nga fryma e fundit. Ja pra, kjo frikë ia mundëson njeriut që të bëjë një jetë më të rregullt dhe të disiplinuar.

Besimtarët janë të detyruar ta zotërojnë këtë dijë, që të frikësohen në kuptim të vërtetë nga Allahu i Lartësuar. Nisur nga kjo, Ebu Lejisi thotë:

“Shenja e frikës ndaj Allahut shihet qartë në shtatë gjëra. Ato janë: Gjuha, zemra, sytë, stomaku, duart, këmbët dhe bindja.” Nëse myslimani i përdor siç duhet këto që thamë më lart, largohet nga mëkatet dhe nga gjërat e dyshimta. Kjo quhet “vera”. Nëse frika shtohet më shumë dhe formohet gjendja që e largon njeriun edhe nga gjërat më të dyshimta, kjo quhet “takva / devotshmëri”. Nëse devotshmërisë i shtohet edhe shërbimi ndaj fesë dhe ndaj të tjerëve, njeriu arrin në gradën e të “sinqerit”. Të mëdhenjtë kanë thënë: “Në një vend ku gjendet sinqeriteti, gjendet edhe devotshmëria. Në një vend ku gjendet devotshmëria, gjendet edhe veraja. Në një vend ku gjendet veraja, gjendet edhe nderi.” Sa fjalë e vërtetë!

Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë:

**Të gjitha rrugët
që zgjaten drejt botës së
përhershme të ahiretit pa
frikën dhe shpresën ndaj
Allahut Teala, janë qorrrokakë.
Ato rrugë janë të rrezikshme
dhe të mbushura plot
me vështirësi.**

“Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime.” (Dhariat, 15) Nëse nuk duam që fundi ynë të jetë humbje, në këtë botë duhet të jetojmë duke pasur frikë nga Allahu dhe t'i zbatojmë urdhrat e Tij, sepse, Ai thotë:

“O ju që keni besuar! Frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!” (Hashr, 18)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: “Koka e urtësisë është frika ndaj Allahut.” (Bejhaki, Dejlemi, Keshfu'l-Hafa, vëll. 1, fq. 421, Hadithi nr: 1350.) Në këtë hadith bëhet fjalë për besimtarin që e ka frikë Allahun Teala dhe që merr mësim prej ngjarjeve. Përsa i përket frikës, këshillohemi që kjo frikë ndaj Allahut gjithmonë të jetë ndërmjet “Haufit” dhe “Rexhasë”, domethënë, “Frikës” dhe “Shpresës”. Feja jonë nuk është feja e pesimizmit dhe dëshpërimit.

A nuk janë gjithmonë shfaqjet e asaj fuqie hyjnore që mund t'i shndërrojë në grimca të vogla shtëpitë dhe pallatet më të forta, që mund të shpërthejë ujë të vluar nga toka dhe që mund të nxjerrë të vdekurin nga i gjalli e të gjallin nga i vdekuri? A nuk janë shenja të fuqisë hyjnore që na kujtojnë “frikën ndaj Allahut” vullkanet, furtunat, tërmetet, lumenjtë që dalin nga shtrati me tërbim, cunamet, rrufetë dhe bubullimat të cilat i shkatërrojnë dhe i fshijnë nga faqja e dheut malet madhështore dhe qytetet e lashta? Sa i saktë mund të jetë konsiderimi i këtyre si ngjarje natyrore të zakonshme? Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se në këtë botë nuk kemi ardhur pa ndonjë qëllim dhe se çdo moment jemi nën vëzhgimin hyjnor. Andaj, duhet t'i rregullojmë sjelljet dhe gjendjen tonë dhe t'i shikojmë ngjarjet nga dritarja e besimit duke marrë mësim prej tyre.

Të gjitha rrugët që zgjaten drejt botës së përhershme të ahiretit pa frikën dhe shpresën ndaj Allahut Teala, janë qorrrokakë. Ato rrugë janë të rrezikshme dhe të mbushura plot me vështirësi. Ai që e njej Allahun e Madhëruar, frikësohet prej Tij ashtu siç e meriton. Në sajë të kësaj, e percepton edhe ligësinë e nefsit / vetes së tij. Prandaj, gjithmonë strehohet te mbrojtja e Allahut duke thënë: “Nefsi mund të më çojë në humbje.” Frika ndaj Allahut është koka e të gjitha mirësive.

Zoti (xh.sh.), na bëftë ne, të gjithë besimtarët dhe të gjithë njerëzit prej robërve që mbartin “frikën ndaj Allahut” në zemrat e tyre! Amin!...



Dashuria për Profetin (a.s.)

— Prof. dr. Ali Kose —

Një nga të urtët e mëdhenj të kohëve të fundit, M. Es'ad Erbili, e ka shprehur kështu zjarrin përvëlues të dashurisë që ndjente për Profetin:

Nga shfaqja e bukurisë sate, i dashuri im, pranvera digjet flakë!

Trëndafili, bilbili, zymbyli, tokë e gjemba digjen flakë!

Rrezet e bukurisë tënde i djegin tërë të dashuruarit;

Gjuha digjet, gjoksi digjet; këta dy sy të lotuar digjen flakë!

A mund të lahet dëshmori i dashurisë që kaq zjarr?

Kurmi i digjet, qefini i digjet, uji i ëmbël për ta larë digjet flakë!

Sa të bukura janë këto vargje të poetit lirik dhe sentimental të kohëve të vona, të mbiquajtur Jaman Dede i cili, megjithëse i krishterë, pas shijimit të kënaqësisë së njohjes së të vërtetës Muhamedane, qe kthyer në një besimtar sypërlotur dhe në një të dashur të pasionuar të Profetit:

Pa ujë në mbetsha, në shkretëtirë shpirt në dhënça, dhimbje s'ndjej;

Në gjoks më vlojnë vullkane, në oqeane freskim s'ndjej;

Flakë në lëshofshin nga qiejt dhe më prekshin, s'ndjej;

Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulullah!

Ç'fat të mbyll sytë me dashurinë, në rrugën tënde të jap shpirt!

A s'mund të më takojë, mbreti im, në intimitetin tënd të jap shpirt?

Me sytë në të shuar, e lehtë në vëllazërinë tënde të jap shpirt!

Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulullah!

E përkula qafën, i dërrmuar jam, shërimi i këtij mjerimi është tek ti!

M'u përcëlluan buzët nga zjarri, m'i lehtëson kur përmendesh ti!

Kur të ta dojë zemra, përkëdhele këtë Kitmirin!, ti!

Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulullah!

Një kujtim që tregon nivelin e afërsisë dhe dashurisë së poetit të këtij panegjiriku për Profetin, na e përcjell kështu njëri nga nxënësit e tij:

“Një ditë, pasi mbaruan mësimet, dolëm nga shkolla. Ishte kohë dreke dhe unë po shkoja për në Taksim. Afër rezidencës gjermane ndodhej një xhami. Ja, që aty, po shkoja lart i vetëm. Veç kur e pashë Jaman Dedenë! Ishte mbështetur në murin e xhamisë dhe kishte marrë një pamje sikur po jepte frymën e fundit. Po rrinte ashtu, i dobët e i pafuqishëm, me kokën të rënë para, lehtësisht në anë të djathtë, me qafën të përkulur.

Vrapova menjëherë dhe i shkova pranë. E pyeta:

“Të shkuara, mësues, të qoftë për të mirë, çfarë ke, a mos je i sëmurë?”

Ndërkaq, e pashë se po qante! Prandaj e pyeta:

“Pse po qan, o mësues? A mos të ka ndodhur gjë?”

Me një zë shumë të hollë e të dridhur, Jaman Dede më tha:

“Jo, o bir, jo! Kur më vjen ndërmend i Dërguari i Allahut (s.a.s.), e humbas veten, s'më mbetet më fuqi për të qëndruar në këmbë! Ose më duhet të mbështetem diku, ose të ulem!”²

*

Shkurtimisht, mund të themi se ka shembuj të panumërt të shfaqjes së dashurisë së pa matë të umetit ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ne këtu sollëm vetëm disa shembuj si pikat e ujit prej oqeanit.

1. Kitmir: Simbolikisht, qen roje i portës. Në rrëfimin mbi Shokët e Shpellës (As'habi Kehf), Kitmir është emri i përveçëm i qenit besnik që u bëri roje atyre në hyrjen e shpellës. Autori e përdor këtë emër për vete si epitot për të shprehur artistikisht thjeshtësinë dhe modestinë e tij.

2. Mustafa Özdamar, Yaman Dede, s. 191-192, Mârifet Yayınları, İstanbul 1994.



Një gjë e dimë mirë, se e vetmja dashuri e vërtetë që e orienton njeriun tek dashuria për Allahun, është dashuria për Profetin (a.s.). Kjo, sepse dashuria për Profetin, është dashuri për Allahun; bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut dhe kundërshtimi i tij, është kundërshtim i Allahut.

Allahu na e bëftë të mundur që zemrat tona të marrin frymëzim prej botës shpirtërore të Profetit (a.s.), që është udhëzuesi i vetëm në rrugën e drejtë. Qofshin zemrat tona vendi i përjetshëm i dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.). Allahu i Madhëruar na e bëftë të mundur të gjithëve ndërmjetësimin e Profetit (a.s.)!

Amin!..

Përmbyllje

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Njeriu është bashkë me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96.)

Të jesh bashkë me Profetin (a.s.), në botën tjetër, të jesh pranë tij, është dëshira më e madhe e çdo besimtari. Dhe, për të arritur këtë mirësi, duhet ta duam të Dërguarin e Allahut në kuptimin e vërtetë të fjalës. Mirëpo, peshorja e dashurisë, është sakrificat. Për të qenë bashkë me Profetin (a.s.), duhet të zotërojmë ndjenja, mendime, moral dhe vepra të ngjashme me të.

Pra, nuk mjafton të thuash, “Unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.)”! Kjo, sepse tek ai që dashuron dikë me të vërtetë, gjenden edhe cilësitë e atij që dashuron.

Nëse e duam të Dërguarin e Allahut (a.s.), sa prej cilësive të tij, si morali dhe devotshmëria, gjenden edhe tek ne? Nëse e duam atë, në çfarë niveli i kemi mëshirën, butësinë, shërbimin në rrugë të Allahut, përpjekjet dhe sakrificat tona? A kemi mundur të shpëtojmë prej egoizmit, koprracisë dhe paedukatës? Sa na interesojnë hallet e myslimanëve?



Sa e zbatojmë sunnetin e Profetit tonë (a.s.), në jetën tonë? Apo mos vallë në ndonjë pjesë të jetës sonë e harrojmë dhe e anashkalojmë atë?

Ja pra, për të bërë pjesë në hadithin, *“njeriu është bashkë me atë që do!”*, duhet të peshojmë dashurinë tonë me nivelin e të qenit bashkë me Profetin e Zotit (a.s.).

Kadi Ijad ka thënë:

“Një nga kushtet e dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), është edhe kapja pas sunnetit të tij, të mbrosh fenë që ka kumtuar ai, të asgjësosh sulmet e drejtuar ndaj tij dhe nëse është e nevojshme, të sakrifkohesh pasurinë dhe jetën në rrugën e tij.”³

Le të pyesim veten:

Sa kemi mundur të përfitojmë prej botës së zemrës së Profetit tonë (a.s.)?

Për shembull;

Çfarë pjekurie shpirtërore kanë **“adhurimet tona”**?

Pra, a na çojnë adhurimet tona drejt dashurisë dhe thellësisë së ndjenjave? Sa e arrijmë përkushtimin dhe qetësinë e zemrës në adhurime?

Në çfarë niveli është **“delikatesa në sjelljet tona”**?

Sa mëshirë ka në zemra tona? Sa mëshirë përhapet prej tyre? A përfundojnë veprat tona me “Allahu të shpërbleftë”, apo me “E paç haram!”?

Në ç’masë është **“pjekuria e moralit tonë”**?

A është mirësjellja që tregojmë ndaj të tjerëve në të njëjtin nivel me delikatesën që presim prej tyre? A kemi mundur të shpëtojmë prej egoizmit, vetëpëlqimit dhe mendjemadhësisë? A është e sinqertë modestia jonë?

Sa e thellë është **“butësia e zemrave tona”**?

Sa i duam krijesat për hir të Krijuesit? Sa

mëshirë tregojnë zemrat tona për nevojtarët dhe të vetmuarit? Sa përfshirëse dhe sa ndikuese është mëshira jonë?

Sa ndriçon **“drita në fytyrat tona”**?

Në ajetin fisnik ku numërohen cilësitë e besimtarëve që do të jenë bashkë me Profetin (a.s.), urdhërohet: **“...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes...”** (Fet’h, 29.) Pra, sa reflektohet sexhdeja në fytyra tona?

Sa harmonike është **“rrjedhshmëria e gjuhëve tona”**?

Sa qetësi u japin gjuhët tona shpirttrave? Sa i rehatojnë ato njerëzit që kanë përballë?

Në ç’shikallë është **“hollësia e ndjenjave tona”**?

A jemi të vetëdijshëm se të gjitha krijesat na janë lënë neve amanet? Sa të ndjeshëm jemi ndaj shenjave të Allahut, ndaj përgjegjësive tona dhe ndaj vdekjes dhe kiametit që po afrohet? A na dridhen zemrat? A na lotojnë sytë?

Në cilat horizonte është **“thellësia e shikimeve tona”**?

Sa arrijnë zemrat tona t’i shohin manifestimet e fuqisë hyjnore? Sa arrijmë ta zbatojmë urdhrin hyjnor, **“أَفْرَأُ / Lexo!”**? Sa kemi arritur të shpëtojmë prej dijes sipërfaqësore, të thatë dhe të padobishme? Sa jemi thelluar në misteret dhe urtësitë hyjnore?

Shkurtimisht;

Sa kemi përfituar prej moralit të lartë dhe detit të gjerë shpirtëror të Profetit tonë (a.s.), për të cilin ajeti fisnik shprehet duke e lavdëruar: **“(O Muhammed!) Padyshim se ti je me moral të lartë!”** (Kalem, 4.)? Sa gjenden tek ne prej të gjitha bukurive të atij Profeti të lartë, prej zemrës së të cilit rridhte mëshirë për botët?

Lum ata prej ummetit të Muhammedit që arrijnë t’i japin përgjigje pozitive këtyre pyetjeve të nxehta dhe këtyre llogarive të thella! Lum ata që ndahen nga kjo botë dhe shkojnë në botën tjetër si trashëgimtarë të Profetit tonë (a.s.) dhe si dëshmitarë të Allahut të Madhëruar!

Allahu e bëftë dashurinë për Vetën dhe të Dërguarin e Tij të dashur (a.s.), thesarin e pashterueshëm të zemrave tona! Allahu na e bëftë të mundur me bujarinë e Tij, që të nderohemi në këtë botë me cilësinë e të qenit **“vëllezër”** të Profetit (a.s.), të freskohemi në burimin e tij të Keutherit në botën tjetër dhe gëzojmë ndërmjetësimin e tij në flamurin e Hamdit!

Amin!..

3. Muhjiddin Sejdi Çelebi, Bazat e drejtimit tek Buhariu, Haz, Doç. Dr. Mehmet Erdogan, Stamboll 2000, fq 60.



Që shtëpitë të jenë të pastra, ato duhen kthyer në vende ku falet namaz. Po ashtu, duhet shtuar edhe numri i shtëpive ku namazi falet me vetëdije të plotë. Këto shtëpi, janë garancia e mbushjes me aromë të mirë të lagjes që kundërmon erë të keqe...

A pastrohet lagjja pa pastruar shtëpinë?

— Sami Byjkkajnak —

Në kohën tonë, po përjetohen shumë hallakatje dhe shpërbërje. Bukuritë dhe mirësitë që na janë trashëguar nga e kaluara, po lihen pas shpine në mënyrë të pakorrigjueshme. Refuzimi i trashëgimisë është bërë shumë i lehtë. Madje është bërë një lloj filozofie e kësaj jete. Botëkuptimi i të parëve tanë, ka filluar të shihet si një barrë prej së cilës duhet shpëtuar shpejt, sepse ajo nuk përputhet me kohën moderne. Që kur kultura dominuese e kohës, ka imponuar filozofinë e jetës shekullariste, të gjithë kanë humbur diçka prej jetës.

Gjithçka pësoi ndryshime, që prej familjes, lagjes, shtëpisë, marrëdhënieve fafëfisnore, veprimtarive tregtare, e deri tek marrëdhëniet njerëzore. Dhe, ky ndryshim zhduku edhe shumë virtyte të bukura.

Tashmë, familja nuk është më ajo që ka qenë. Pjesëtarët e familjes nuk mblidhen më së bashku

në një vend. Por edhe sikur të mblidhen, të gjithë flasin në kokë më vete. Prandaj edhe nuk realizohet asnjë takim qoftë edhe me pjesëmarrjen më të ulët. Prindërit e kanë të vështirë t'i bëjnë fëmijët t'i dëgjojnë. Ata nuk janë të sigurt se si do të vijë në darkë fëmija i tyre, i cili gjatë gjithë ditës ka qenë jashtë. Ata janë të shqetësuar jashtë mase se me çfarë problemesh do të kthehen fëmijët e tyre të cilët i kanë dërguar në shkollë. Në ato pak momente kur janë të mbledhur në shtëpi, prindërit nuk u zënë besë fëmijë të tyre kur i shohin në sy, sepse gjymtyrët, duart, këmbët, sytë dhe gjuhët e tyre nuk janë në harmoni me njëra-tjetrën dhe nuk janë të qeta. Ata nuk flasin të njëjtën gjuhë dhe nuk kanë të njëjtin botëkuptim për jetën, sepse jashtë ka shumë ndikues të tjerë. Ata gjenden të rrethuar nga një sërë ndikuesish që i japin formë jetëve të tyre.

Shkollat janë nën ndikimin e kulturës dominuese të kohës dhe besueshmëria e tyre është dobësuar shumë. Kur fëmijën e tuaj, të cilin përqipeni ta edukoni sipas natyrës së pastër, e çoni në shkollë, ju nuk jeni të sigurt se me çfarë vesi do të kthehet në shtëpi. Pra, është e pamundur të thuash se, “shkollat janë të sigurta!”.

A mund ta mendoni!? Po flasim për pasigurinë e institucionit të edukimit. Nëse dyshoni në sigurinë e shkollave ku edukohen dhe arsimohen brezat, do të thotë se diçka nuk shkon siç duhet. Nëse fëmija nuk shkon i sigurt në shkollë dhe sytë tanë mbesin pas, atëherë është e pamundur të flasim për një ambient të përshtatshëm dhe të sigurt për ta.

As lagjet ku jetojmë nuk janë më të sigurta. Ata që dalin jashtë, janë gjithmonë të shqetësuar se me çfarë të keqe do të përballen në rrugë, e që do të kthehen në shtëpi me barrën e saj negative. Para 25-30 viteve, fëmijët luanin në rrugë dhe prindërit i lejonin pa asnjë problem. Aty zhvilloheshin lojëra të ndryshme dhe po në atë rrugë realizoheshin edhe marrëdhëniet e para shoqërore. Prindërit nuk kishin frikë se fëmijët e tyre mund të ktheheshin në shtëpi me vese të këqija, sepse ata ndodheshin edhe nën vëzhgimin e fqinjëve përreth. Nëse fëmijët grindeshin dhe nëse prej gojës së tyre dilnin fjalë të pista, ndërhyenin menjëherë fqinjët në lagje.

Siç më ka treguar një shok, ai vet nuk kishte dëgjuar kurrë sharje, deri sa shkoi në shkollë të mesme. “Për herë të parë kam dëgjuar një “sharje” nga një shoku im i shkollës”- thotë ai. Madje, e kishte pyetur shokun e tij, “çfarë do të thotë kjo?”. Domethënë, lagja ku jetonte e luante, kopshti ku ka shkuar etj., kanë qenë kaq të pastër, saqë shoku im, deri në atë kohë është rritur me natyrshmëri të pastër. Shoku im nuk është shumë i vjetër. Moshë e tij është 37 vjeç tani. Pra, 25-30 vite më parë, ka pasur shumë lagje të sigurta dhe të pastra. Ndërsa sot, është e pamundur që fëmija të dalë në oborrin e pallatit dhe të luajë. Prindërit nuk mund ta lejojnë fëmijën të dalë dhe të rrinë në shtëpi të qetë.

Është e lehtë të bësh evidentimin e gjendjes. Por cila është zgjidhja?

Zgjidhja është t'i bëjmë shtëpitë tona që të bartin gjurmët e “Bejtullahut”, sepse çdo shtëpi duhet të

bartë gjurmët e një Bejtullahu në aspektin e adhurimit. Në Kur'anin Fisnik, gjendet një urdhër drejtuar Ibrahimit dhe Ismailit (alejhimesselem): **“Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: “Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrinë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përlurur.”** (Bekare, 125.) Për rrjedhojë, ne duhet ta marrim përsipër këtë detyrë të Ibrahimit dhe Ismailit dhe të bëjmë pastrimin e shtëpisë sonë. Ky pastrim, duhet të jetë si fizik, ashtu edhe shpirtëror. Pastrimi i shtëpisë nga papastërtitë shpirtërore dhe marrja e masave mbrojtëse që ajo të mos ndotet më, është puna më e rëndësishme, në sajë të së cilës mund ta bëjmë shtëpinë të bartë shpirtin e “Bejtullahut”.

Pastrimi i shtëpive, në të njëjtën kohë do të thotë edhe pastrim i lagjes dhe i shoqërisë. Një lagje e përbërë prej shtëpive të pastra, patjetër që do të ndikojë edhe në shoqëri. Si rezultat i kësaj pune për pastrim, do të vijë edhe shpëtimi, edhe pastërtia e shoqërisë.

Në të njëjtën mënyrë, edhe shpëtimi i shoqërisë së Beni Israilëve, të cilët jetonin nën dhunën fizike dhe shpirtërore të faraonit, varej nga shpëtimi i shtëpive. Në lidhje me këtë fakt, në Kur'an gjejmë këtë urdhër të Allahut drejtuar Musait dhe Harunit (alejhimesselem):

“Ne i shpallëm Musait dhe vëllait të tij: «Ndërtoni shtëpi për popullin tuaj në Egjipt, shndërrojini ato në faltore dhe falni namazin! Dhe sillu lajmin e mirë besimtarëve!» (Junus, 87.)

Domethënë se, për të shpëtuar prej prishjes dhe ndikimit të ngushticës sociale, myslimanët duhet t'i rishikojnë shtëpitë e tyre dhe t'i kthejnë ato në vende adhurimi. Lagja e përbërë prej shtëpive ku lidhja me Allahun nuk është e fortë, është e sigurt që shoqëria e saj do të hyjë nën ndikimin e kulturës dominuese. Për rrjedhojë, është e pamundur të presësh një shoqëri të sigurt prej njerëzve që rriten në këto vende. Prandaj, që shtëpitë të jenë të pastra, ato duhen kthyer në vende ku falet namaz. Po ashtu, duhet shtuar edhe numri i shtëpive ku namazi falet me vetëdije të plotë. Këto shtëpi, janë garancia e mbushjes me aromë të mirë të lagjes që kundërmon erë të keqe, sepse shtëpitë e pastra, patjetër do të ndikojnë tek fqinji dhe, familja me probleme, do të ndikohet pozitivisht prej familjes së lumtur.





— Doç. Dr. Mustafa Xhanllë —

Një hadith: “Kur robi ta falënderojë Allahun duke thënë “elhamdulillah” kur Allahu t’i japë një mirësi, ky (falënderim) është më i vlefshëm se ajo mirësi.” (Ibn Maxhe, Edeb, 55)

Një mesazh: Falënderoje Zotin në çdo kohë dhe në çdo gjendje.

O Zot! Falënderimin ndaj Teje e kam bërë kurorë të fjalëve të mia,

Përkujtimin Tënd e kam bërë miraxh për zemrën time... (Elmallëllë M. Hamdi)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në këtë hadith fisnik na tregon vlerën që ka te Allahu Teala shprehja “elhamdulillah”. Me të vërtetë, kjo fjalë është një shprehje sublime që përfshin kuptime të shenjta si falënderimin, lavdërimin dhe madhërimin.

Emri i umetit të Hazreti Muhamedit (s.a.s.), në xhenet do të jetë “Hammadun / Shumë falënderues”. Pejgamberit tonë të dashur, (a.s.), do t’i jepet “makamuhmud / pozita sublime”. Në mahsher do t’i jepet flamuri që do të quhet “livau’l-hamd / flamuri i falënderimit”. Të gjitha këto janë shfaqje të pozitës së falënderimit ndaj Zotit (xh.xh.).

Shprehja elhamdulillah është surja Fatiha.

Surja Fatiha, e cila është surja e parë e Librit tonë të Shenjtë, fillon me elhamdulillah. Kjo të jep përshtypjen sikur e gjithë surja është koment i elhamdulillahit, e cila është shprehja e hapjes. Surja Fatiha dhe elhamdulillah-lahi janë aq të lidhur me njëri-tjetrin, sa që ndërmyjet njerëzve kësaj sureje i thuhet “elham” që do të thotë “el-hamd”.

Shprehja elhamdulillah është namaz.

Përgjatë pesë kohëve të namazit, në të cilat i drejtohem Zotit (xh.xh.), lutjet tona i fillojmë me hamd/lavdërim ndaj Zotit. I Dërguari i Allahut, pa-

qja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të ka thënë: “Nuk ka namaz ai që nuk e këndon suren Fatiha në namaz.” (Buhari, Ezan, 94.) Pastaj na ka këshilluar që në fund të namazit të themi 33 herë “elhamdulillah”. (Ebu Davud, Vitr, 24.) Në fillim të namazit elhamdulillah dhe në fund të tij elhamdulillah. Që nga fillimi e deri në fund të namazit elhamdulillah...

Shprehja elhamdulillah përfshin të gjithë jetën tonë.

Ne, duke ndjekur sunetin e lartë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), e falënderojmë Allahun Teala kur të zgjohemi nga gjumi, kur të shkojmë në shtrat për të fjetur, pasi të hamë ushqim apo pasi të pimë ujë, në hytбет dhe ligjëratat tona, kur të teshtijmë dhe kur të veshim rroba të reja, madje edhe pasi të kryejmë nevojën, shkurtimisht, e falënderojmë Zotin (xh.xh.), në çdo fushë të jetës sonë.

Shprehja elhamdulillah i shton mirësitë.

Sepse Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: “**Nëse më falënderoni, padysim se do t’ju shtoj mirësitë.**” (Ibrahim, 14/7) Domethënë se përderisa besimtari ta falënderojë Zotin (xh.sh.), kundrejt mirësive që i jep dhe të thotë “elhamdulillah”, edhe Allahu i Madhëruar ia shton atij mirësitë.

Shprehja elhamdulillah është mjaftim me atë që ka dhënë Allahu Teala.

Pejgamberi ynë i nderuar (s.a.s.), ka thënë: “Shikoni ata që janë poshtë jush për sa u përket mirësive, sepse, nëse i shikoni ata që janë më poshtë jush, është më e mirë për ju nga aspekti i mosnënvlerësimit të mirësive që ju ka dhënë Allahu.” (Muslim, Zuhd, 9.)

Për këtë arsye, besimtari duhet të mjaftohet me atë që posedon në çdo lloj gjendjeje dhe duhet ta

falënderojë Allahun Teala për mirësitë që i ka dhënë duke thënë “elhamdulillah”.

Shprehja elhamdulillah bëhet shkak për fitimin e pëlqimit të Zotit (xh.xh.).

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “*Allahut Teala i pëlqen që rob i Tij ta falënderojë pasi të hajë apo pasi të pijë diçka.*” (Muslim, Dhikr, 89.) Allahu Teala kënaqet prej robërve të Tij që e falënderojnë.

Shprehja elhamdulillah do të thotë të jesh i kënaqur prej Allahut.

Ne duhet të jemi të kënaqur nga Allahu Teala në çfarëdo situatë... Edhe kur të japë, edhe kur të mos japë... Edhe kur t'i shtojë mirësitë, edhe kur të na privojë prej tyre... Gjithmonë duhet të themi: “O Zot! Çdo gjë që vjen prej teje (edhe shtimi i mirësive, edhe pakësimi i tyre) është e mirë...”

Pejgamberi ynë i dashur (s.a.s.), na transmeton këtë bisedë që ndodh ndërmjet Allahut të Madhëruar dhe engjëjve:

“Kur një rob i t'i vdesë fëmija e tij, Allahu Teala u thotë engjëjve: “Ju ia morët fëmijën nga duart robit Tim, ashtu ë? Engjëjt i thonë: “Po.” Allahu Teala u thotë: “A ia këputët frutin e zemrës robit tim?” Engjëjt i thonë: “Po.” Allahu Teala i pyet: “Mirë, por çfarë tha rob i im në atë moment?” Engjëjt i thonë: “Ai të falënderoi dhe tha: Innalil-lahi ve innailejhirrahiun / Ne kemi ardhur nga Allahu dhe përsëri do të kthehemi te Allahu.” Nisur nga kjo, Allahu Teala u thotë: “Atëherë bëni një shtëpi në xhenet për robin Tim dhe quajeni ‘shtëpia e falënderimit.’” (Tirmidhi, Xhenaiz, 36.)

Shprehja elhamdulillah është falënderim ndaj Zotit (xh.xh.).

Sepse i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një hadith fisnik: “Hamdi është koka e falënderimit ndaj Zotit. Ai që nuk i bën hamd Allahut, do të thotë se nuk e ka falënderuar atë.” (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, IV, 96.)

Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), në kohët e agimit i përgjerohej Zotit (xh.xh.) dhe falte namaz gjatë e gjatë. Përsëri, në një kohë agimi të begatë, e ndërpreu gjumin e tij, fali namaz derisa iu ënjtën këmbët dhe nuk i ngeli më aspak fuqi. Nëna jonë Aishja, radijallahuanha, e cila e pa këtë gjendje të Pejgamberit tonë të nderuar, i tha kështu perlës së njerëzimit:

“Përse e lodh veten kaq shumë, edhe pse Allahu t'i ka falur të gjitha gabimet që ke bërë në të kaluarën dhe që mund t'i bësh në të ardhmen?” Pejgamberi ynë i dashur e ngriti kokën e tij të bekuar dhe iu përgjigj: “O Aishe! A të mos jem një rob që e falënderon shumë Allahun për shkak të këtyre mirësive?” (Buhari, Tehexhjud, 6.)

Shprehja elhamdulillah është mirënjohje ndaj Zotit (xh.sh.).

Mosmirënjohja është një cilësi e keqe që gjendet te çdo njeri si potencial. Besimtari përpiket ta kontrollojë këtë cilësi të keqe me anë të frenave të vullnetit të tij. Te njerëzit që nuk ia dalin mbanë në këtë çështje, shfaqet cilësia e mosmirënjohjes. Si rezultat, njeriu arrin në një gjendje që nuk e falënderon as Krijuesin e tij dhe as njerëzit. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Ai që nuk i falënderon njerëzit, nuk e falënderon as Allahun.” (Tirmidhi, Birr, 35.)

Shprehja elhamdulillah është lutje.

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: “**...lutja e tyre aty do të jetë “Qofsh i lavdëruar, o Zot!” Përhëndetja e tyre do të jetë “Selam” dhe lutja e tyre e fundit “Falënderuar qoftë Allahu, Zoti i botëve!”**” (Junus, 10)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), shpesh herë lutej: “Elhamdulillahiala kul-li hal / Falënderimi qoftë për Allahun në çdo lloj gjendjeje!” (Ibn Maxhe, Edeb, 55.)

Shprehja elhamdulillah është dhikër / përmendje e Zotit (xh.sh.).

Shprehja elhamdulillah është fillimi i çdo lloj pune të mirë siç është edhe fillimi i Librit tonë të Shenjtë dhe namazit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Çdo fjalë apo punë e mirë që fillon pa falënderim ndaj Allahut është e pabereqetshme.” (Ibn Maxhe, Nikah, 19.) Në këtë mënyrë, i ka këshilluar besimtarët që ta fillojnë me falënderim ndaj Allahut Teala çdo fjalë dhe vepër. Gjithashtu ka theksuar se përderisa besimtarët të mos veprojnë në këtë mënyrë, fjalët dhe veprat e tyre nuk do të rezultojnë me sukses.

Besimtari duhet ta shndërrojë “elhamdulillahin” në një dhikër të tillë, saqë ta ndjejë emocionin e këtij dhikri edhe në thellësitë e zemrës së tij kur ta thotë. Pastaj ky dhikri elhamdulillah duhet të reflektojë në sjelljet dhe veprat e tij. Si rezultat, besimtari fillon dhe e ndjen se Zoti e sheh në çdo vend, e ndjen Atë në çdo moment dhe përpiket të bëjë një jetë sipas të fshehtës së ajetit fisnik në të cilin Zoti (xh.xh.), shprehet: “**Lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur! Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!**” (Hixhr, 98-99)

Po, sa lumturi e madhe dhe sa moral i lartë është të qenët një rob që e falënderon Allahun Teala në çdo moment, në çdo gjendje, në çdo kohë, në çdo vend, në vështirësi dhe në rehati! Allahu i Lartësuar na e mundësoftë të gjithëve që të bëjmë një jetë plot falënderim dhe bindje ndaj Tij!..

DETYRAT TONA NDAJ MUHAMEDIT

- SAL-LALLAHU ALEJHI VE SEL-LEM -

— Naim Drijaj —

1. BESIM I VËRTETË NË MUHAMEDIN (A.S.) DHE VËRTETIMI I ASAJ QË KA SJELLË DHE QË KA THËNË

Allahu i Madhëruar thotë: “Besoni në Allahun, në të Dërguarin e Tij dhe në dritën (Kuranin), që ju kemi zbritur. Allahu e di mirë çdo gjë që bëni ju”.¹ “...ruajuni Allahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij (Muhamedin), se Ai do t’ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Vet, do t’ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t’ju falë; Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë”.²

2. BINDJA NDAJ TIJ

Ashtu siç është detyrë besimi në Muhamedin (a.s.) dhe në vërtetësinë e profetësisë së tij, po ashtu është detyrë edhe bindja ndaj Tij. Allahu (xh.sh.) thotë:

“O besimtarë! Binduni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos ia ktheni shpinën, ndërkohë që e dëgjoni (të vërtetën)”³

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj”.⁴ “Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore”.⁵ “Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur”.⁶

Ebu Hurejra (r.a.) tregon se i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “Kush më bindet mua, i është bindur Allahut dhe kush më kundërshton mua, ka kundërshtuar Allahun”.⁷ Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “I gjithë umeti im do të hyjnë në xhenet përveç atyre që refuzojnë! Sahabët pyetën: E kush janë ata që refuzojnë o i Dërguari i Allahut? Ai (a.s.)!, iu përgjigj sahabëve duke iu thënë: “Kush më bindet mua ai do të hyjë në xhenet, ndërsa kush nuk më bindet mua, ai ka refuzuar.”⁸

3. PASIMI DHE MARRJA E TIJ SI MODEL NË TË GJITHA ÇËSHTJET

Allahu i Madhëruar thotë:

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”⁹

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”.¹⁰

“Pasojeni atë (Muhamedin), që të jeni në rrugën e drejtë”!¹¹ Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kush nuk e pranon rrugën time, nuk është prej meje (nuk është mysliman i mirë)”¹²

4. DASHURIA PËR MUHAMEDIN (A.S.)

Allahu (xh.sh) thotë: “Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur”.¹³

Enesi (r.a.) tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Asnjëri prej jush nuk e ka të plotë besimin, derisa të jem më i dashur për të sesa fëmijët, prindërit dhe të gjithë njerëzit”.¹⁴

Një person e pyeti Pejgamberin (a.s.) se kur do të bëhet Kiameti. Pejgamberi (a.s.) i tha: “Çfarë ke përgatitur për atë ditë? Ai iu përgjigj: “ O i Dërguari i Allahut! Nuk kam përgatitur ndonjë agjërim, namaz apo zekat të shumtë (vullnetar), por unë e dua

Allahun dhe të Dërguarin e tij”. Pejgamberi (a.s.) i tha: “Njeriu do të jetë me atë që do”.¹⁵

Enesi (r.a.) ka thënë: “Pas mirësisë së Islamit, gjëja që na ka gëzuar më shumë ka qenë kjo fjalë e të Dërguarit të Allahut: “Njeriu do të jetë me atë që do” Unë e dua Allahun, e dua të Dërguarin e Tij, e dua Ebu Bekrin dhe Umerin”.¹⁶ Po ashtu edhe ne e duam Allahun, e duam të Dërguarin e Tij, e duam Ebu Bekrin (r.a.), e duam Umerin (r.a.), i duam të gjithë sahabët, tabi’inët, dijetarët dhe të gjithë myslimanët.

Abas ibn Abdul Mutalibi (r.a.) tregon se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “E ka provuar shijen e besimit ai person, i cili është i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin si të Dërguar”.¹⁷

Shenjat e dashurisë për të Dërguarin e Allahut janë: pasimi i tij, ndjekja e rrugës së tij, zbatimi i urdhrave të tij, frenimi nga ato që ai ka ndaluar dhe pajisja me moralet e tij, si në rastet e vështira ashtu edhe në rehati. Nuk ka dyshim, se kur një person e do dikë, i jep më shumë përparësi atij dhe mundohet të veprojë sipas dëshirave të tij, përndryshe ai nuk është i sinqertë në atë që pretendon.

5. RESPEKTIMI, NDERIMI DHE MBROJTJA E TIJ

Allahu (xh.sh) thotë:

“...që t’i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që ta ndihmoni e ta nderoni atë (Muhamedin)”.¹⁸

“O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun!...”.¹⁹

Urvete bin Mesud, pasi lidhë marrëveshjen e paqes me myslimanët në luftën e Hudejbijes, në vitin e gjashtë të hixhretit. Kthehet në Mekë dhe i’u tregon shokëve të vet si e respektonin sahabët Muhamedin (a.s) dhe si i zbatonin urdhrat e Tij: “Kam hyrë tek mbretërit e Persisë, romakëve e të Abisinisë, por nuk kam parë asnjërin prej atyre (mbretërve) të respektohet prej shokëve të tij, siç i kam parë shokët e Muhamedit duke e respektuar atë.

Nëse i urdhëronte për diçka shpejt i përgjigjeshin, e kur ai merrte abdes shtyheshin se cili prej tyre të ia marrë ujin e abdesit, për ta përdorur ujin për bereqet. Kur fliste ai ata e ulnin zërin dhe e

përcillnin me shikim nga respekti dhe nderimi që posedonin ndaj tij.”

6. PËRSHËNDETJA E PROFETIT (A.S.) ME SALAVATE DHE SELAME

Imam Ibn Kajimi, në librin e tij²⁰ i ka përmendur 39 përfitime nga dërgimi i salavateve mbi Pejgamberin (a.s.). Allahu i Madhëruar thotë: “Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam””.²¹ Ebu Hurejra (r.a) tregon, se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kush çon një salavat për mua, Allahu e mëshiron dhjetë herë”.²²

Enes ibn Malik transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “ Nëse përmendem në prezencë të dikujt, ai le të bjerë salavatë për mua, sepse kush bie një herë salavatë për mua, Allahu e mëshiron 10 herë”.²³

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “ Kushdo prej Umetit tim, i cili bie salavatë për mua me sinqeritet nga zemra, Allahu e mëshiron 10 herë, e lartëson 10 gradë, i shkruan 10 sevape dhe i fshin 10 të liga”.²⁴

Ibn Mesudi (r.a.) tregon, se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Allahu ka melekë shëtites (lëvizës), të cilët më përcjellin selamet e Umetit tim”.²⁵

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Njeriu më i afërt me mua në ditën e Kiametit është ai, i cili më ka dërguar më shumë salavate”.²⁶

Profeti (a.s.) ka thënë: “Koprrac i vërtetë është ai, i cili e dëgjon emrin tim dhe nuk bie salavate për mua”.²⁷

7. GJYKIMI ME FJALËT E TIJ

Allahu i Madhëruar thotë: “O besimtarë! Binduni Allahut, binduni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, (Pra, drejtojuni Kuranit dhe Sunetit) nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur”.²⁸

Kurse në një ajet tjetër Allahu (xh.sh) thotë: “Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për të gjykuar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht”.²⁹ Gjykimi bëhet nëpërmjet Sunetit dhe Sheriatit të tij (Paqja qoftë mbi të).³⁰

■ **REFERENCAT:** 1) Tegabun, 8. 2) Hadid, 28. 3) Enfal, 20. 4) Hashr, 7. 5) Ahzab, 71. 6) Ahzab, 36. 7) Buhariu nr. 7137, Muslimi nr. 1835. 8) Buhariu nr. 7280. 9) Ali Imran, 31. 10) Ahzab, 21. 11) Araf, 158. 12) Buhariu nr.5063, Muslimi nr. 1401. 13) Teube, 24. 14) Buhariu nr. 15, Muslimi nr. 44. 15) Buhariu nr.6168, Muslimi nr. 2640, Tirmidhiu nr. 2386, Ebu Daudi nr. 5127. 16) Buhariu nr. 3688, Muslimi nr. 2639. 17) Muslimi nr. 34. 18) Fet’h, 9. 19) Huxhurat, 1. 20) Xhelaul-Efham fi Fadlis-Salati ala Hajril-Enam. 21) Ahzab, 56. 22) Muslimi nr.408, Ebu Daudi nr.1530. 23) Nesaiu në Kubra nr. 9806, Ibn Hibani nr. 904, Ahmedi 3/102. 24) Nesaiu në Kubra nr. 9809, Taberaniu në Kebir 22/195. 25) Nesaiu në Muxhtebe nr. 1281, Ibn Hibani nr. 914, Ahmedi 1/387. 26) Tirmidhiu nr. 484. 27) Nesaiu në Kubra nr. 8046, Hakimi nr. 2015, Tirmidhiu nr. 3046. 28) Nisa, 59. 29) Nisa, 65. 30) Rushit Musallari, “Fikhu Praktik”. Vëllimi i parë, f. 56-60.

Për një shoqëri të lumtur duhet një familje e lumtur

— B. Xhahit Ēzdemir —

Familja formohet me qëllimin për të zbatuar urdhrin e Allahut Teala, për të fituar kënaqësinë e Tij dhe për t'i dhënë breza të devotshëm shoqërisë. Qëllimi i këtushëm nuk është joserioz si: “Le të martohemi një herë. Pastaj, nëse nuk shkojmë mirë, mund të divorcohemi.” – siç është i përhapur në ditët e sotme, por është shfaqja e një mendimi të singertë në formën: “Ta fillojmë bashkë edhe jetën e përhershme.” Nisur nga ky aspekt, familja është një shkollë në të cilën edukohen breza të ndryshëm që i japin shoqërisë paqen me flladet e mëshirës. Në lidhje me këtë, në Kuranin Fisnik thuhet:

“O ju që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...” (Tahrim, 6)

“... (Robërit e veçantë të Allahut) thonë: “O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prekje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!” (Furkan, 74)

Fatkeqësia më e madhe që e shkatërron lumturinë e familjes, shëndetin e brezave dhe paqen e shoqërisë është imoraliteti dhe prostitucioni. Në fenë tonë, lerë të vepruarit e këtyre veprave, por është ndaluar edhe afrimi te ato. Ndëshkimet më të rënda dhe të rrepta janë caktuar për këto krime të tilla. Në këtë mënyrë, është theksuar se mbrojtja e nderit dhe dinjitetit të njeriut vjen para çdo gjëje. Për këtë arsye, kalifi i parë, Hazreti Ebu Bekri (r.a.), na ka paralajmëruar në një hytbe të tij duke u shprehur: “Kur të përhapet imoraliteti, fatkeqësitë ndodhin në mënyrë të përgjithshme...” Prandaj është shfaqur kujdes shumë i madh ndaj çështjes së “privatësisë” në shoqëritë islame dhe është synuar mbyllja e plotë e rrugës që të shpie të këto vepra të shëmtuara.

Vendosja në dyert e oborrit të shtëpive e dy tok-

makëve njëri i madh dhe tjetri i vogël që nxirrjnë zëra të ndryshëm në kohën e shoqërisë osmane, është një shembull sublim i ndjeshmërisë së tyre në këtë çështje. Shumë letrarë evropianë kanë kujtime të tyre që i kanë shkruar në lidhje me lumturinë e familjes në kohën e perandorisë osmane. Një kujtim i Dr. A. Brayerit, i cili ishte njëri prej këtyre letrarëve, është si më poshtë:

“Kur fëmijët e osmanëve rriten dhe hyjnë në periudhën e pjekurisë, krenohen duke u gjendur pranë prindërve të tyre. Ndërkohë në vendet tjera, në shumicën e rasteve, fëmijët ndahen nga prindërit e tyre sapo të hyjnë në periudhën e pjekurisë.”

Edhe një autor tjetër, Pierre Loti shkruan si më poshtë:

“Në asnjë shtëpi të kësaj bote një burrë nuk sillet kaq me respekt dhe dashuri ndaj bashkëshortes së tij. E fshehta e kësaj të vërtete gjendet në përgatitjen e shtëpisë turke (myslimane) nga ana e gruas. Gruaja myslimane është aq e dhënë pas shtëpisë së saj, është aq meraklie ndaj pastërtisë dhe ka një zgjuarsisë e edukatë saqë e bën bashkëshortin e saj të përmallohet për shtëpinë. Burri i shtëpisë në muzgun e mbrëmjes hyn brenda me një përmallim të madh. Gruaja myslimane nuk e di çfarë është alkooli, bixhozi dhe bota e jashtme. Gruaja osmane (myslimane) që nuk e njeh botën e jashtme, ka shpëtuar edhe nga sëmundja e kërkimit për të fshehtat e të tjerëve. Si rezultat, bën një jetë të lumtur në shtëpinë e sajë. Ajo nuk e di se çfarë është zënka dhe zhurma. Zemrën e ka të lidhur me Allahun, me bashkëshortin dhe me fëmijët e saj. Për shkak se e mbron mendjen nga gjërat e padobishme, është e qetë dhe nikoqire. Për këtë arsye, është edhe e moralshme.” (M. Oruç, Gazeta e Turqisë, 8. 12. 2001.)

Por edhe kjo është një e vërtetë se bota islame në

shekujt e fundit, për shkak të mposhtjes edhe nga aspekti i gjendjes së saj shpirtërore, siç shprehet edhe Ibn Halduni në opinionin e tij, është kapluar nga sëmundja e “imitimit të mposhtësve!” Rrymat sekulare kanë shkaktuar plagë të thella në mënyrë të jashtëzakonshme në strukturat sociale të shoqërive myslimane si shembulli i shkatërrimit që bëjnë në tokë rrëketë e çmendura. Kjo magjepsje për Evropën i ka shkatërruar vlerat kombëtare aq shumë sa që është tepër e vështirë për t'i rregulluar. Në të vërtetë është fituar pavarësia, por për fat të keq në pah kanë dalë breza që punojnë në emër të perëndimit nëpër pozitat që janë vendosur dhe që mendojnë si perëndimorët. Tashmë, përfaqësuesit e disa shtresave si shoqatat e grave, ndjekësit e partive politike, organizatat civile... nëse flitet për ndonjë ndëshkim simbolik ndaj imoralitetit, nëse mendohet t'i vendoset ndonjë kufizim krimit të abortit, nëse flitet për ndonjë rregullim në standartet perëndimore të përdorimit të alkoolit... dynden nëpër rrugë, bëjnë protesta dhe bëjnë kërkesa për tolerancë edhe ndaj prirjeve seksuale të shfrenuara të tyre. Nëpër filmat dhe telenovelat që transmetohen nëpër kanalet televizive pothuajse imponohet stili i jetës perëndimore. Veçanërisht telenovelat e shkollave që u drejtohen mendjeve të reja, përbëhen nga afrime dhe degradime seksuale.

Ndërsa interneti që është shndërruar në një fuqi të pakontrollueshme këto kohët e fundit, është një tjetër kurth për familjet. Me këtë lloj mjeti komunikimi në të cilin kontaktet bëhen duke i vënë maskë natyrës dhe personalitetit të njeriut, kanë rënë në grackë duke u mashtruar pjesëtarë të shumë familjeve, madje disa persona që kanë lënë takim me njëri-tjetrin, kur kanë shkuar për t'u takuar, përballë tyre kanë gjetur bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre. Këto ndodhi janë prej ngjarjeve që ta ngrijnë gjakun.

Siç ka thënë edhe Zija Pasha: “A mund të shprehet mirësi nga seheri (koha para agimit) i një nate të tillë!” – për shkak të kësaj ecurie negative, edhe institucioni i familjes ka marrë plagë të mëdha. Si rezultat, përqindja e divorceve vazhdimisht sa vjen dhe shtohet, moshja e martesës sa vjen e ngrihet, jeta ilegale që inkurajohet nga disa qarqe të caktuara sa vjen e përhapet, të moshuarit lihen nëpër azile në një kohë kur më së shumti kanë nevojë për dhembshuri e dashuri dhe fatkeqësitë familjare të lidhura me shkaqë të ndryshme zënë më shpesh vend në edicionet e lajmeve...

Për shkak të zbrazëtirës së përshpirtjes, rastet e divorceve në perëndim sigurisht që janë më të larta. Nisur nga kjo mund të themi se në Amerikë janë 52%, ndërsa në Evropë rreth 30-50%. Edhe në vendin tonë rastet e divorceve po shkojnë me shpejtësi drejt këtyre shifrave.

Secili prej pjesëtarëve të familjes që është lënduar dhe plagosur duke ngelur nën gërmadhën e institucionit të familjes që është shembur, merr një drejtim të paditur. Për shkak të kësaj, vitet e vyera të jetës së shkurtër shkojnë dëm krejtësisht. Njerëzit në këtë gjendje e kanë shumë të vështirë që t'i zgjidhin problemet që kanë ndërmjet tyre, ta harrojnë kohën që kanë kaluar bashkë dhe të fillojnë një jetë të re e të lumtur. Veçanërisht fëmijët, të cilët nuk kanë asnjë faj, por që për fat të keq shndërrohen në viktimat më të mëdha të saj... Fëmijët që privohen nga lumturia për ta imagjinuar si një kujtim të këndshëm dashurinë e baballarëve dhe përfaqimin e ngrohtë të nënave... E ardhmja e këtyre është shumë më e rëndësishme për veten dhe shoqërinë e tyre. Për këtë arsye, duhet të shfaqen përpjekje të mëdha për ta parandaluar nxirjen e të ardhmes me probleme të ndryshme.

Pasi në Kuranin Fisnik jepet këshilla “për të kaluar mirë me gratë” (Nisa, 19), në lidhje me çështjen e divorcit thuhet: “**...Nëse ato pranojnë të kalojnë mirë me ju, atëherë mos kërkonin ndonjë gjë kundër tyre dhe mos merrni rrugën e divorcit.**” (Nisa, 34)

Disa dijetarë si Ibnu'l-Humami dhe Ibn Abidini, rahmetull-llahi alejhima, të cilët ishte fakihë hanefi, kanë thënë se “divorci pa ndonjë shkak është gjynah duke e pranuar që baza në divorc është ndalimi i tij, përveç nëse bëhet fjalë në rast nevoje dhe domosdoshmërie, atëherë ai mund të jetë i lejuar”.

Ibn Abidini shprehet se duhet të qëndrojmë larg kësaj vepre duke thënë: “Ndarja pa ndonjë shkak është budallallëk, mungesë largpamësie, mosmirënjohje ndaj mirësisë dhe torturë ndaj pjesëtarëve të familjes.”

Struktura jonë familjare që kërcet në çdo anë, po jep sinjale se ka arritur në dimensionet kërcënuese për të ardhmen e popullit tonë. Mënyra për ta ndaluar këtë tragjedi është të ndaluarit e shkatërrimit të shpejtë që po përjetohet në vlerat kombëtare dhe mbrojtja e këtyre të fundit. Nisur nga këto që thamë, ne duhet ta shpëtojmë zemrën e njerëzve tanë nga rrymat sekulariste duke e parandaluar shkatërrimin e vlerave të larta që ata kanë dhe duke i pajisur ata me virtyte si dashuria, respekti, modestia, durimi, toleranca etj., që i kemi trashëguar nga e kaluara jonë madhështore. Vatrata familjare të lumtura janë garanci për arritjen e lumturisë nga ana e shoqërisë. Për sa i përket kësaj çështjeje, jeta familjare e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, dhe e paraardhësve tanë të devotshëm, gjendet përballë syve tanë si një shembull i vyer me të gjithë madhësinë e tij.

INTERNET I (PA)NDËRGJEGJSHËM

— Fatma Allada —

Janë bërë shumë kërkime në lidhje me dëmet e internetit dhe janë treguar shumë histori të cilat kanë një pjesë të madhe të së vërtetës. Tashmë interneti është pjesëtari i padëshiruar i familjeve.

Në ditët e sotme, blerjet elektronike janë bërë aq të thjeshta sa ne nuk arrijmë që t'i llogarisim shumat që harxhojmë për këto blerje dhe jemi bërë një pre e lehtë e këtij kurthi. Të gjithëve na duket shumë e favorshme sjellja tek dera e shtëpisë e produkteve që porosisim pa qenë nevoja të shëtisim sa në një vend në tjetër...

Kompanitë e duhanit dhe të pijeve alkoolike e përdorin internetin si një mjet për të joshur të rinjtë tanë që janë duke ecur në një rrugë rrëshqitëse... Lojëra, që në pamje të parë janë krejt të pafajshme, kanë përmbajtje të pakëndshme për sytë e fëmijëve tanë... Rrjetet sociale të përdorura me qëllim komunikimi janë kthyer në një mjet shkatërrues të shoqërisë... Këto rrjete nganjëherë bëhen shkak që të lindin mosmarrëveshje të vogla në familje e deri tek ato që mund të përfundojnë me ndarjen e çifteve...

Për faj të internetit, pjesëtarë të familjes që ndodhen në të njëjtën dhomë jetojnë në botë krejt të ndryshme; në të njëjtën kohë rritet mungesa e kujdesit dhe interesit mes çifteve dhe shtohen gjërat negative të jetës në familje.

Në sistemin arsimor interneti ka sjellë më shumë efekte negative se pozitive. Si nxënësit ashtu edhe mësuesit duhet të bëjnë kujdes që ta përdorin me kujdes këtë teknologji të re. Fëmija harxhon kohë të shumtë përpara

kompjuterit në përpjekje për të kryer detyrat shkollore. Gjithashtu është vënë re se një fëmijë që në shkollë nuk është aspak social, në internet është pjesëtar i shumë rrjeteve sociale, në të cilat shumë herë mund të njihet me njerëz të rrezikshëm.

Mos të harrojmë se ky fëmijë çapkën i teknologjisë ka edhe shumë anë pozitive. Në qoftë se ne do të jemi të kujdesshëm dhe do ta përdorim me përgjegjësi atë, pse të mos jetë ai një derë diturie?! Mos të harrojmë se interneti na ofron mënyrën që vetëm me një klikim të gjejmë detaje për çdo temë të fesë sonë. Postat elektronike, në qoftë se lexohen në një kohë të përshtatshme, na sjellin gëzim dhe kënaqësi. Interneti na sjell pranë nesh njerëzit tanë të dashur, por që ndodhen larg nesh fizikisht... Shumë herë ai na bën të mundur të komunikojmë me njerëzit që ndodhen në anët

e tjera të botës. Interneti është mjeti që bën të mundur ndarjen e kënaqësive të jetës me njerëzit tanë të dashur...

Interneti duhet të jetë një mjet për të arritur sukses dhe lumturi. Në qoftë se do të arrijmë që ta shfrytëzojmë internetin për punë të mira, ai do të bëhet një mjet shumë i dobishëm.

Ashtu siç ndodh në shumë fusha të jetës, e mira dhe e keqja janë të fshehura tek ndërgjegjja jonë. Në kemi mundësi që të shfrytëzojmë anët e mira apo të këqija të tij. Interneti është vetëm një mjet. Është karakteri ynë ai i cili përcakton sjelljen tonë në rrjetet sociale. Rrugën që do të zgjedhim, e kemi ne në dorë: ose do të jemi një përdorues i zgjuar i internetit ose do të bëhemi robër të tij, një rob i lidhur me zinxhirët e rrezikshëm të kënaqësive virtuale...



CILI ËSHTË PRIORITETI JUAJ?

Seher Ajdën

Sa shumë jemi gëzuar ditën kur në shtëpinë tonë erdhi kompjuteri... U ulëm të gjithë përreth tij dhe nuk u ngritëm deri në orët e para të mesnatës. Të nesërmen folëm me kamera me të afërmit tanë nëpër botë dhe u gëzuam shumë për kursimet që bënim duke i krahasuar me koston e telefonit. Kompjuteri u bë sendi më i dashur i shtëpisë dhe nuk e linim vetëm asnjë çast. Gjatë paradites isha unë që e përdorja; kur vinin fëmijët nga shkolla e merrnin ata radhën, për t'ia lënë bashkëshortit mbrëmjeve... Babai, që u tregonte fëmijëve foto dhe slajte interesante, filloi të zhytej në një qetësi të çuditshme. Tashmë nuk i mjaftonin pasditet, edhe netët i kalonte para kompjuterit. Netët kalonin dhe miqtë e internetit i ishin bërë më të afërt se pjesëtarët e vet të familjes.

Deri në ditën kur më rrëfeu që kishte marrë një grua të huaj...

Arsimi dhe mësimi kanë bërë hapa gjigante; tashmë nxënësit nuk mësojnë me libra dhe me lapsa, por me kompjuter dhe internet. Duke e ditur këtë gjë ne morëm kompjuter për të lehtësuar fëmijët tonë në shkollë. Në fillim interneti përdorej për mësimet e shkollës pastaj filluan lojërat, filmat e deri tek blerjet nga interneti. Fëmijët na thoshin që blerjet e bëra në internet janë më të favorshme dhe na flisnin për kursimet që mund të bëheshin. Unë i kërkoja burrit të gjente një zgjidhje..

Deri në ditën kur na erdhi urdhri nga gjykata, sepse djali ynë i vogël kishte harxhuar shumën e mëdha me kartën tonë të bankës...

Kur i kërkova burrit që të merrte kompjuter në shtëpi ai m'u përgjigj:

“Në qoftë se kompjuteri do të përdoret nga të gjithë njerëzit e shtëpisë, të gjithë duhet të kontribuojnë në blerjen e tij!..”

Kur dëgjova këto fjalë unë plot krenari, e hoqa byzylykun nga dora dhe ia dhashë burrit.

Në fund të fundit jetojmë në kohën e teknologjisë dhe nuk është mirë që të mbesim larg shoqërisë. Fëmijët e përdornin internetin për të bërë detyrat e shkollës kurse unë e zhvilloja hobin tim të gatimit duke shikuar receta të ndryshme në internet.

Nga ta dija unë që byzylyku i blerë me para hallalli do të bëhej shkak për ta shkatërruar familjen time. Burri im që mori zakone të këqija përmes internetit një ditë na braktisi...



Ka shumë histori të ngjashme, por nuk është e mundur që t'i përmendim të gjitha... Këto janë dhuratat e teknologjisë dhe shkencës së përpunuar...

Ndjehemi pa fat, sepse ai që hyri në jetën tonë si një bekim tashmë është kthyer në shkatërrimin tonë... Kjo ngjason me veprimin e shejtanit, i cili përpëqet të na i shfaqë si të mira dhe të bukura gjërat e dëmshme dhe të shëmtuara...

Të gjithë ne kemi përfituar nga zhvillimi teknologjik për të thjeshtësuar jetët tona. Kompjuteri, makinat, telefonat dhe gjërat e ngjashme na u dukën shumë të mira dhe të favorshme për përdorim. Ne nuk e kuptojmë se sa shpejt kalon koha që ne përpëqemi të ruajmë. Ditët tona të numëruara dhe minutat tona të çmuara i harxhojmë pa kujdes... I kemi harruar gjërat e rëndësishme dhe përpëqemi të gjejmë lumturinë tek gjërat e dorës së dytë...

Sigurisht që duhet të përfitojmë nga anët e mira të teknologjisë, por këto nuk duhet të kalojnë asnjëherë në plan të parë, sepse për një besimtar gjëja më e rëndësishme është dashuria për Allahun dhe Resulullahun, bashkë me to edhe përkushtimi ndaj Kuranit dhe synetit... Njeriu pjesën më të madhe të kohës e kalon me njerëzit dhe gjërat e dashura. Zgjedhjet që bëjmë, vendet ku shkojmë flasin për njerëzit tonë të dashur.

Besimi ynë nuk shpalolet vetëm me anë të adhurimeve që kryejmë. Myslimani e tregon besimin e vet me sakrificat, zgjedhjet dhe dëshirat. Ashtu siç dallohet harami nga hallalli, ashtu dallohet edhe njeriu që do dhe adhuron Allahun prej atij që do dhe ndjek shejtanin... Duhet të theksojmë faktin se ne qëndrojmë në ato vende ku kemi gjëra apo njerëz të dashur...

Myslimanët e kohëve të sotme janë duke u testuar më shumë në këtë temë. Resulullahu sal-lallahu ve sel-lem, na ka këshilluar me fjalët: “*Kapuni me dhëmbë pas synetit.*” (Ebu Davud, Synnet, 5) Ai na ka treguar se mënyra e vetme për t'u ruajtur nga kurthet e shejtanit është që të forcojmë lidhjen tonë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Le të strehohemi nën çadrën e besimit dhe të ushqehemi me Islamin, sepse njeriu është një krijesë e dobët dhe vetëm ai është një liman i sigurt. Në qoftë se duam që të bëhemi pjesëtarë të këtij limani, duhet ta njohim dhe ta duam atë; kjo arrihet vetëm duke shkatërruar pengesat që na mbajnë larg rrugës së drejtë. Mos harroni se njeriu është pranë të dashurit!

Gjethet e ullirit

MËNYRAT E PËRDORIMIT PËR SHËNDETIN E ZEMRËS DHE TË TRURIT

Përdorimet e gjetheve të ullirit në mjekësinë popullore datojnë që në kohën e Egjiptit të lashtë.

Asokohe, besohej se këto gjethe të ishin simbol i një fuqie hyjnore.

Gjethet e ullirit përmbajnë përbërës bioaktivë të fuqishëm dhe antioksidantë, njësoj si vetë ulliri.

Vlerat e këtyre gjetheve i bëjnë ato të dobishme për sistemin imunitar, tensionin e gjakut dhe shëndetin e sistemit kardiovaskular në përgjithësi.

Nga të gjithë përbërësit bioaktivë të gjetheve të ullirit veçohet një substancë që quhet oleuropein.

Në fillim të viteve 1900 u zbulua që ky antioksidant ul në mënyrë natyrale tensionin e gjakut dhe parandalon sëmundjet kardiovaskulare.

VLERAT E PROVUARA TË GJETHEVE TË ULLIRIT

Kur krahasuan efikasitetin e ekstraktit të gjetheve të ullirit me atë të një medikamenti kundër tensionit të lartë, studimet zbuluan se ekstrakti bimor e ulte ndjeshëm tensionin sistolik dhe diastolik.

Kjo ulje u vërejt kur pjesëmarrësit në studim morrën 500 miligramë ekstrakt të gjetheve të ullirit, dy herë në ditë për 8 javë.

Gjethet e ullirit gjithashtu ulin nivelin e kolesterolit të keq dhe shmangin efektet anësore të medikamenteve.

SHËNDETI KARDIOVASKULAR

Antioksidanti oleuropein bashkë me përbërësit të tjerë të gjetheve të ullirit kanë ndikim direkt në uljen e rrezikut të shfaqjes së sëmundjeve të zemrës.

Ato gjithashtu parandalojnë formimin e inflamacionit dhe disa tumoreve.

DIABETI

Një studim zbuloi se ekstrakti i gjetheve të ullirit ka ndikim pengues në zhvillimin e diabetit dhe shumë sëmundjeve të tjera kronike.

Ato mund të ulin nivelin e sheqerit në gjak dhe ta mbajnë atë nën kontroll.

FUNKSIONET E TRURIT

Përbërësit bioaktivë të gjetheve të ullirit zbusin simptomat e sëmundjeve mendore të lidhura me moshën siç është skleroza apo sëmundja e Alzheimerit.

Sipas studimeve, antioksidantët sulmojnë radikalet e lira që dëmtojnë funksionet e trurit duke i rimëkëmbur ato.

KUNDËR ARTRITIT

Gjethet e ullirit pakësojnë enjtjen e kyçeve dhe gjymtyrëve të prekura nga artriti, sepse shënjestrojnë që në fillim inflamacionin.

Për më tepër, substancat e këtyre gjetheve zbusin dhimbjet kronike që shoqërojnë sëmundjen.

KUNDËR BAKTEREVE

Ekstraktet e gjetheve të ullirit mund të eliminojnë një sërë bakteresh dhe mikrobesh përfshirë *Escherichia coli*.

Këto ekstrakte janë efikase edhe kundër hepatitit B, pneumonisë, e të tjerë.

SISTEMI IMUNITAR

Gjethet e ullirit pengojnë të ftohurën dhe janë të dobishëm kundër viruseve të rrezikshëm.

Përbërësit e gjetheve eliminojnë organizmat e dëmshëm dhe nuk lejojnë shumimin e viruseve.

SI TA PËRGATISNI ÇAJIN E GJETHEVE TË ULLIRIT

Për të përgatitur lëngun nga gjethet e ullirit, duhet të përdorni gjethe të thata, ose të njoma në kushtet e shtëpisë.

Merrni një enë metalike, të cilën duhet ta mbushni me 300 ml ujë dhe ta vini të valojë.

Kur arrihet pika e vlimit, hidhni një sasi prej rreth 20 deri 25 gjethe të thara të ullirit.

Uji së bashku me gjethet duhet të valojë sërish për 4-5 minuta dhe më pas hiqeni nga zjarri dhe lëreni të ftohet.

Ju këshillojmë që lëngun ta pini të ngrohtë pasi të shtoni lëng limoni dhe të tresni pak mjaltë.

Lëngu i gjetheve të ullirit ofron një shije mreku-llisht të kënaqshme dhe të ëmbël, e cila e bën një zgjidhje që nuk duhet ta ndani nga vetja në çdo stinë.

SI TA PËRDORNI Vajin e Ullirit PËR SHËNDETIN E LËKURËS

Përveç vlerave shëndetësore shumë të rëndësishme për shëndetin, vaji i ullirit konsiderohet si një eliksir për fytyrën.

Ky lëng i artë është përdorur për bukurinë që në Greqinë dhe Egjiptin e lashtë.

Këto qytetërime, besonin se vaji i ullirit e mban lëkurën të bukur, të butë, të ushqyer dhe të pastër.

Ndërkohë, ekspertët e mjekësisë moderne kanë zbuluar se vlerat e vajit të ullirit i atribuohen pasurisë së antioksidantëve.

SI TË PASTRONI FYTYRËN ME VAJ ULLIRI

Vajin e ullirit mund ta përdorni për pastrimin e fytyrës nga papastërtitë, sepse ai është më efikas se produktet kozmetike të pastrimit.

Ai nuk bllokton poret dhe është i përshtatshëm për të gjitha llojet e lëkurave.

Vajin e ullirit mund ta përzieni me pak lëng të freskët limoni ose me ujë dhe ta vendosni në fytyrë nëpërmjet pambukut.

Vaji i ullirit është më i preferuari nga njerëzit me lëkurë të ndjeshme dhe ata alergjikë ndaj produkteve kozmetike.

VAJI I ULLIRIT KUNDËR AKNEVE

Vaji i ullirit është anti-bakterial nga natyra dhe për pasojë rekomandohet kundër akneve.

Për më tepër ai lufton inflamacionin dhe largon skuqjen përreth puçrave.

VAJI I ULLIRIT PËR USHQYERJEN E LËKURËS

Ju mund të përzieni vajin e ullirit me lëng trëndafili ose vaj esencial të lavandës dhe ta lyeni fytyrën.

Në këtë mënyrë, ju do të keni lëkurë të ushqyer por vaji do ju ndihmojë të luftoni edhe probleme si ekzema.

MASKË ME VAJ ULLIRI

Vajin e ullirit mund ta përdorni edhe për përgatitjen e maskave të ndryshme.

Ekspertët rekomandojnë përzierjen e gjysmë luge gjelle me vaj ulliri, të verdhën e vezës dhe një lugë gjelle me miell.

Këtë maskë mund ta mbani në fytyrë për 10 minuta dhe do të vëreni se lëkura e fytyrës do të jetë më e ushqyer.

KUNDËR RRUDHAVE

Vaji i ullirit përmirëson elasticitetin e lëkurës dhe rrjedhimisht lufton rrudhat, sidomos ato në pjesën e syve.

Këtë pjesë mund ta lyeni me vaj ulliri në mëngjes ose edhe në mbrëmje çdo ditë për të parë përmirësim në paraqitjen e jashtme.



ZBULOHEK ARSYEJA E ZHDUKJES SË FUSHËS MAGNETIKE TË HËNËS

Fusha magnetike mbrojtëse dikur e fortë e Hënës u zhduk rreth një miliard vjet më parë kur dinamoja e saj e brendshme pushoi së funksionuari, ka zbuluar një studim.

Për të përcaktuar forcën e kaluar të fushës magnetike, studiuesit studiuan shkëmbinj nga sipërfaqja e Hënës që u formuan nga shkrirja të krijuara nga një ndikim i madh.

Ndërsa ky shkëmb ftohet, kokrra të vogla brenda rreshtohen me fushën magnetike për të formuar një fotografi të forcës dhe drejtimit të fushës në atë kohë.

Studiuesit zbuluan se fusha një miliardë vjet më parë kishte rënë në 0,1 mikrotësla – rreth 500 herë më e dobët se ajo e Tokës.

Kjo, shtuan ata, sugjeron që dinamoja që mundëson fushën – e nxitur nga kristalizimi i materies në bërthamën hënore – kishte pushuar deri në këtë kohë.

Hëna e Tokës mendohet të jetë formuar rreth 4.5 miliardë vjet më parë.

Ajo u krijua pas një përplasjeje midis Tokës së re dhe një trupi me madhësi Marsi. Studiuesit e kanë quajtur këtë ndikues gjigant ‘Theia’, transmeton KosovaPress.

Mbetjet e hedhura në orbitë nga përplasja përfundimisht u bashkuan nën gravitetin për të formuar Hënën.

Fusha magnetike e Tokës është produkt i rrymave elektrike të krijuara ndërsa metali i lëngshëm

lëviz rreth në bërthamën e planetit tonë, duke na mbrojtur nga rryma e grimcave të ngarkuara që shpërthehen nga Dielli,

Hëna, ndërkohë, kishte një fushë të fortë magnetike – por e tillë ka kohë që është zbehur.

“Një fushë e fortë në Hënë mund të ketë mbrojtur sipërfaqen nga era diellore, plazma supersonike e emetuar nga Dielli,” thotë shkencëtari planetar Benjamin Weiss nga Instituti i Teknologjisë në Massachusetts.

“Kjo mund të ketë penguar që sipërfaqja të ndahet hapësira dhe toka të bëhet e pasur me gaz diellor, siç është sot,” shtoi ai.

“Për më tepër, Hëna ka të ngjarë të jetë rreth dy herë më afër Tokës gjatë kohës kur Hëna u konstatua se kishte një fushë të fortë magnetike krahasuar me sot.”

Hëna është akoma duke u larguar ngadalë nga ne, me një shpejtësi prej 2.5 cm në vit.

Në hulumtimin e tyre të mëparshëm, profesori Weiss dhe kolegët zbuluan se fusha magnetike e Hënës katër miliardë vjet më parë ishte rreth 100 mikrotësla – ose rreth dyfishi i forcës së fushës magnetike të Tokës sot.

Ekipi e përcaktoi këtë duke analizuar mostrat e shkëmbit të Hënës që ishin formuar nga aktiviteti vullkanik në sipërfaqen e saj.

Megjithatë, rreth tre miliardë vjet më parë, aktiviteti vullkanik në Hënë ishte ndalur kryesisht.

“Tre miliardë vjetët e historisë hënore kanë qenë

një mister, pasi nuk ka pothuajse asnjë histori të gurit të tij,” tha Weiss për Newsweek.

Vullkanet nuk janë mënyra e vetme që shkëmbi i shkriret mund të formohet në Hënë, megjithatë – disa shkriret mund të formohen kur trupat ndikojnë në sipërfaqen hënore.

Në vitin 2017, ekipi gjeti shkëmbinj të formuar në një ndikim të tillë 2.5 miliardë vjet më parë – me analizën e tyre duke zbuluar se, në atë kohë, fusha magnetike e Hënës kishte rënë në rreth 10 mikrotlesa.

Në studimin e tyre të fundit, profesori Weiss raportoi të gjente shkëmbinj të ngjashëm që u formuan në vazhden e një ndikimi të madh rreth një miliard vjet më parë – duke zbuluar se fusha magnetike atëherë nuk ishte më e fortë se 0,1 mikrotlesa.

Sipas studiuesve, kjo sugjeron që dinamoja e brendshme e Hënës që mundësonte fushën mag-

netike ishte mbyllur deri në atë kohë.

Ekipi beson se fusha magnetike mund të jetë nxitur nga dy procese të ndryshme.

Në fillim, afërsia e Hënës me Tokën çoi në nxitje gravitacionale të lëngut në bërthamën e saj, duke prodhuar efektin dinamik që mundësonte fushën.

Ndërsa distanca midis Tokës dhe Hënës u rrit, megjithatë, një proces i dytë – i quajtur “kristalizimi bazë” – ka të ngjarë të bëhet më i rëndësishëm.

Në këtë, formimi gradual i bërthamës së dendur të hekurit të Hënës nxiti lëngun përreth në bërthamën e jashtme, duke gjeneruar fushën magnetike.

Kur bërthama e brendshme ishte kristalizuuar plotësisht nga bërthama e jashtme, megjithatë, kjo dinamikë do të kishte pushuar së funksionuari – megjithëse aktualisht është e paqartë nëse kjo ka ndodhur në mënyrë të papritur.

SHKENCËTARËT THONË SE KANË GJETUR NJË “VRIMË TË ZEZË” QË ËSHTË 70 HERË MË E MADHE SE DIELLI

Astronomët kanë zbuluar një vrimë të zezë në Rrugën e Qumështit.

E quajtur LB-1, kjo vrimë e zezë është 15,000 vjet dritë larg nga Toka dhe ka një masë 70 herë më të madhe se Dielli, transmeton Telegrafi.


Rruga e Qumështit vlerësohet të përmbajë 100 milionë vrime yjore, por LB-1 është dy herë më masive sesa që shkencëtarët menduan, tha Liu Jifeng, një astronom nga Kina.

Shkencëtarët në përgjithësi besojnë se ekzistojnë dy lloje të vrimave të zeza.

Vrimat yjore më të zakonshme – deri në 20 herë më masive se Dielli, dhe vrimat e zeza supermasive që janë të paktën një milion herë më të mëdha se Dielli dhe origjina e tyre është e pasigurt.

Vrimat yjore zakonisht formohen pas shpërthimeve të supernovës, një fenomen që ndodh kur yjet jashtëzakonisht të mëdhenj digjen në fund të jetës së tyre.

LB-1 u zbulua nga një ekip ndërkombëtar i shkencëtarëve që përdorin teleskopin e sofistikuar të Kinës LAMOST.



“Përgatisni kundër tyre
kuaj dhe forcë për luftë
sa të mundni,
që të tmerroni armikun
e Allahut dhe armikun tuaj,
si dhe të tjerë, përveç tyre,
të cilët ju nuk i njihni,
por që Allahu i njeh.
Çfarëdo që të shpenzoni
në rrugën e Allahut,
do t’ju shpërblehet
dhe nuk do t’ju bëhet
padrejtësi.”

(Enfal, 60)